



BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i Vlerësimit për Vitin 2018



Projekt i financuar
nga Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME





BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE




REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i Vlerësimit për Vitin 2018

Shtator 2019



- Raporti nxjerr në pah rëndësinë e rolit të pushtetit vendor në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, bazuar në pajtueshmërinë me angazhimet e pranimit dhe kriteret e vitit 2018.

- Raporti është hartuar me kontributin e ekipit të Projektit “Bashkitë për në Evropë” dhe të ekspertes, znj. Albana Dhimitri, e cila përgatiti kapitullin e rekomandimeve.

- Njësitë e Integrimit Evropian në secilën Bashki kanë koordinuar procesin e brendshëm të mbledhjes së të dhënave, ndërsa Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, ka koordinuar mbledhjen e të dhënave nga 61 bashkitë.

SHËNIM

- Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|-----|
| Fjala Përshëndetëse | 6 |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 7 |
| 1.HYRJE | 19 |
| 2.KRITERET POLITIKE | 21 |
| 2.1.Demokracia | 21 |
| 2.1.1.Qeverisja | 21 |
| 2.1.2.Avokati i Popullit | 38 |
| 2.1.3.Shoqëria civile | 40 |
| 2.2.Shteti i së drejtës | 45 |
| 2.2.1.Lufta kundër korrupsionit | 45 |
| 2.3.Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave | 53 |
| 3.KRITERET EKONIMIKE | 59 |
| 3.1.Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale | 59 |
| 4.AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT | 63 |
| 4.1.Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi dhe rural | 63 |
| 4.2.Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare | 70 |
| 4.3.Kapitulli 14: Politika e transportit | 72 |
| 4.4.Kapitulli 15: Energjia | 79 |
| 4.5.Kapitulli 16: Taksat | 82 |
| 4.6.Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi | 85 |
| 4.7.Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore | 95 |
| 4.8.Kapitulli 22: Politikat rajonale | 111 |
| 4.9.Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria | 113 |
| 4.10.Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura | 115 |
| 4.11.Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës | 122 |
| 4.12.Kapitulli 32: Kontrolli financiar | 136 |
| 5.REKOMANDIME | 139 |

SHKURTIME

| | |
|----------|---|
| ADISA | Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri |
| SHBSH | Shoqata e Bashkive të Shqipërisë |
| SHAV | Shoqata për Autonominë Vendore |
| PV | Plan Veprimi |
| RV | Raport Vjetor |
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| AMVV | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| NjA | Njësi Administrative |
| BE | Bashkimi Evropian |
| SNKK | Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 |
| DAP | Departamenti i Administratës Publike |
| DPT | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve |
| KK | Këshilli Konsultativ për vetë-Qeverisjen Vendore |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| SNRAP | Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020 |
| DPPS | Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale |
| ILKPKDKI | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave |
| OSHC | Organizata të Shoqërisë Civile |
| PAK | Person me Aftësi të Kufizuara |
| MFP | Menaxhimi i Financave Publike |
| PPV | Plani i Përgjithshëm Vendor |
| NjQV | Njësi e Vetëqeverisjes Vendore |
| PKVIRE | Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane 2016-2020 |
| PVIRE | Plani Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MTE | Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit |
| PBA | Programi Buxhetor Afatmesëm |
| PKVPAK | Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara |
| PKVEE | Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë |
| SNKDQV | Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020 |
| SKE | Strategjia Kombëtare për Energjinë |
| SKPA | Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2016-2020 |
| ZIN | Qendra e Integruar me një Ndalesë |
| SSC | Sistemi i Sigurimit të Cilësisë |
| AZHR | Agjencia e Zhvillimit Rural |
| ZRP | Zyra Rajonale e Punësimit |
| MFP | Menaxhimi i Financave Publike |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit |
| MIM | Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve |
| RAT | Reforma Administrative Territoriale |
| SZHAP | Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 |
| GP | Grup Pune |

Shqipëria ndodhet në një moment shumë të rëndësishëm të historisë së saj. Teksa Komisioni Evropian, për të dytin vit radhazi, u ka rekomanduar vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, hapjen e negociatave me Shqipërinë, ndonëse rrugëtimi duket i mbushur me sfida, duhet të na imponojë një reflektim më thellë, e mbi të gjitha, një shtim të angazhimit për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky proces.

Jo vetëm qeveria qendrore, por edhe njesitë e pushtetit vendor, kanë shumë për të kontribuar në rrugëtimin e vendit drejt BE-së. Së bashku kemi përgjegjësinë dhe detyrimin të ndërtojmë një përpjekje të kombinuar, për të bërë të mundur realizimin e ëndrrës së qytetarëve shqiptarë.

Sikundër shpreh qartë Komunikata për Politikën e Zgjerimit të BE 2019, vetëm një ekuilibër i duhur mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore, që bën të mundur zbatueshmërinë e reformave, është garancia për një integrim të suksesshëm të Shqipërisë në strukturat e Bashkimit Evropian. Ndaj, pa një angazhim aktiv të strukturave të pushtetit vendor në zbatimin e politikave, legjisllacionit të BE-së, si dhe në ndjekje të axhendës së përgjithshme të Integritimit Evropian, shumë pak mund të bëhet për të avancuar progresin e integritimit.

Raporti i Vlerësimit “Bashkitë në Procesin e Integritimit në BE të Shqipërisë”, është një pasqyrim i mirë i progresit të deritanishëm që është bërë nga qeverisja vendore, si dhe sfidave që ndeshen prej tyre në rrugëtimin e plotësimit të standardeve të kërkuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.

Gjetjet në raport tregojnë se në pjesën dërrmuese, organet e pushtetit vendor po përshkatan fort mirë në ingranazhin e përgjithshëm të “makinerisë” së procesit të integritimit.



Ngritja dhe funksionimi i Njësive të Integritimit Evropian në çdo bashki, puna e përkushtuar për zbatimin e standardeve që përcakton axhenda e integritimit evropian, bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet strukturave qendrore dhe njësive të sapo krijuara, forcimi i tyre për të ofruar informacionin e duhur dhe shërbimet e nevojshme ndaj komunitetit janë sfida të mëdha për t’u realizuar, por në të njëjtën kohë ofrojnë garanci për një sukses edhe më të madh në të ardhmen.

Ky raport vlerësimi, i cili mbështetet nga asistenca e Bashkimit Evropian, do të jetë tashmë një ushtrim i përvitshëm nën koordinimin e Ministrisë së Brendshme dhe strukturave të saj, me qëllim ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme në administratën publike, duke siguruar kështu aftësinë e strukturave të qeverisë për të udhëhequr dhe koordinuar me sukses proceset e integritimit evropian në nivel vendor.

Unë jam i bindur se me më shumë punë, më shumë angazhim, më shumë vendosmëri, ne të gjithë së bashku do t’ia dalim që të përmbushim aspiratën e shumicës dërrmuese të shqiptarëve.

Sandër LLESHAJ

Ministër i Brendshëm

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Roli i vetëqeverisjes vendore në zbatimin e politikave, në zbatimin e Acqui Comunitaire dhe në axhendën e integrimit evropian është shumë i rëndësishëm. Komisioni Evropian e thekson përsëri këtë rol në Komunikimin e vitit 2019 për Politikën e Zgjerimit të BE-së si vijon: **“Roli i autoriteteve rajonale dhe vendore duhet të merret parasysh në procesin e harmonizimit me BE-në dhe në zbatimin eventual të rregullave të BE-së. Duhet gjetur një ekuilibër i përshtatshëm mes qeverisë qendrore, rajonale dhe asaj vendore që mbështet më së miri zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët”**.¹


Integrimi në BE është sfidues dhe kërkon shumë përpjekje nga ana e administratës qendrore dhe asaj vendore. Qeveria shqiptare po shkon drejt një qeverie të hapur në funksion të përmirësimit të politikave kombëtare, transparencës dhe të cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe të qendrave me një ndalesë.

Forcimi i administratës publike, vendosja e dialogut me qytetarët përmes proceseve politikbërëse të hapura dhe me pjesëmarrje dhe rritja e kapacitetit të qeverisë për të zgjedhur politikat më të përshtatshme midis opsioneve të ndryshme kanë të gjitha rëndësi thelbësore në funksion të lidhjes së qeverive me qytetarët e tyre dhe nxitjes së një rritje më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Ky është Raportit i dytë vjetor “Bashkitë në Procesin e Integrimit të Shqipërisë në BE”. Raporti synon të paraqesë progresin e bërë nga bashkitë shqiptare gjatë vitit 2018 në lidhje me përmbushjen e përgjegjësive siç përcaktohet nga kuadri ekzistues strategjik dhe ligjor dhe në lidhje me përafrimin me kriteret e pranimit dhe me standardet e BE-së.

Ky raport është i hartuar në bazë të strukturës së Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020 dhe Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Përmbledhja e gjetjeve kryesore të raportit jepet më poshtë.

¹ Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka udhëhequr udhëheq procesin e rishikimit të Planit të Veprimit Anti-korrupsion, 2018-2020”, fq. 7



KRITERET POLITIKE

Demokracia

Po bëhen përpjekje të vazhdueshme për të rritur kapacitetet e administratës vendore, megjithatë menaxhimi i burimeve njerëzore dhe qëndrueshmëria financiare e trajnimit mbeten një sfidë. Sistemi i trajnimit të administratës vendore është përmirësuar nëpërmjet procesit të rishikimit të kurrikulës (91 kurrikula të rishikuara në 2017-2018) bazuar në sistemin e sigurimit të cilësisë, në përmirësimin e procedurave të certifikimit, ngritjen e bibliotekës elektronike dhe në ngritjen e platformës elektronike E-PAV për menaxhimin e burimeve njerëzore. 764 zyrtarë publikë vendorë u trajnuan në vitin 2018 lidhur me Ligjin për Shërbimin Civil dhe rreth 1,008 zyrtarë vendorë u trajnuan nga ASPA në fusha të ndryshme tematike. Numri mesatar i zyrtarëve vendorë të trajnuar u rrit nga 14 persona për bashki në 18 persona në vitin 2018. 169 trajnime për Kodin e Procedurave Administrative, 169 persona ose, mesatarisht, 3 persona për bashki ndoqën trajnimin për Kodin e Procedurave Administrative, ndërsa 28% e bashkive nuk janë trajnuar. Buxheti vendor për trajnim mbetet shumë i ulët. Vetëm 52% e bashkive kanë dhënë disa fonde për të mbuluar koston e personelit për pjesëmarrje në trajnim (mesatarisht, 1.9% të buxhetit të bashkisë), ndërsa 48% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë pasur buxhet për trajnim në vitin 2018.

Miratimi nga Qeveria i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të Integrimit Evropian, ndërmjet Qeverisë

Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shënoi një arritje të rëndësishme gjatë vitit 2018. Vendimi i Këshillit të Ministrave ka institucionalizuar të ashtuquajturat kënde të BE-së të ngritura në 61 bashki.

Është **bërë progres drejt përmbushjes së detyrimit** për qeverisje të hapur, llogaridhënie dhe **qeverisje elektronike** në nivel vendor. Programi qeveritar për shërbime elektronike në nivel vendor vazhdon. Është shënuar progres në drejtim të ngritjes së Qendrave të Integruara me një Ndalesë. 49% e bashkive kanë ngritur Qendrat e Integruara me një Ndalesë, që do të thotë 20 bashki më shumë se në vitin 2017. Mesatarisht, 50 shërbime administrative ofrohen përmes Qendrave të Integruara me një Ndalesë. Programi për të ngritur Qendrat e Integruara me një Ndalesë në të gjitha bashkitë e tjera është planifikuar të përfundojë në vitin 2019, ndërkohë që duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të rritur numrin e shërbimeve administrative të ofruara përmes Qendrave të Integruara me një Ndalesë dhe për të zgjeruar mbulimin territorial duke përfshirë të gjitha njësitë administrative dhe zona të largëta.

Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për informacion ose **i ankesave** të tyre, **si pjesë e forcimit të llogaridhënies së vetëqeverisjes vendore është përmirësuar, megjithatë, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që kërkesat e qytetarëve të trajtohen sipas rregullave.** Informacioni i dhënë nga bashkitë tregon se ato po i kushtojnë vëmendje trajtimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve. Rreth 82% e qytetarëve kanë marrë përgjigje për kërkesat dhe ankesat e tyre nga shërbimet administrative të bashkisë së tyre në vitin 2018. Kjo tregon një raport në rritje krahasuar me vitin 2017 (75%). 15 (pesëmbëdhjetë) bashki kanë dhënë përgjigje për të gjitha (100%) kërkesat/ankesat e qytetarëve. Megjithatë, nuk ekzistojnë ende sisteme të menaxhimit të performancës së qeverisjes vendore për të mundësuar një vlerësim më cilësor të reagimit të bashkive ndaj qytetarëve.

Është bërë **progres i mirë drejt rritjes së trans-**

parencës së qeverisjes vendore, megjithatë pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje dhe bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC-të) mbetet në nivel të ulët. Në vitin 2018, rreth 92% e bashkive shqiptare kanë hartuar buxhetin e tyre vendor bazuar në metodën me pjesëmarrje. Buxhetet publikohen në faqen e internetit të bashkive dhe në faqen e dedikuar të internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financatvendore.qi. Mesatarisht, 908 qytetarë kanë marrë pjesë në takime publike/dëgjesa publike gjatë procesit përgatitor të buxhetit vendor. Janë organizuar, mesatarisht, 8 takime publike për bashki. Bashkitë e Gramshit, Librazhdit dhe Devollit kanë raportuar një numër më të madh takimesh publike të organizuara (mbi 25 takime), ndërsa bashkitë e Dropullit dhe të Rogozhinës kanë raportuar se në vitin 2018 nuk kanë organizuar takime apo dëgjesa publike gjatë procesit përgatitor të buxhetit. Rreth 79% e bashkive raportojnë se kanë pasqyruar objektivat strategjike të përcaktuara në dokumentet strategjike vendore në programin buxhetor afatmesëm vendor (PBA) duke përfshirë Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), Planin Vendor të Mbrojtjes Sociale, Planin Vendor për Integrimin e Pakicave Etnike (Rome dhe Egjiptiane) dhe dokumente të tjera strategjike të miratuara nga këshilli bashkiak. Megjithatë, cilësia e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) mbetet problematike dhe orientimi drejt prioritetëve strategjike mbetet për t'u testuar kur bashkitë të zbatojnë buxhetin e bazuar në programe. Vendimet e këshillit bashkiak janë publikuar në faqen e internetit të bashkisë në vitin 2018 nga pothuajse të gjitha bashkitë.

Vëmendje po i kushtohet shqyrtimit dhe trajtimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve të Avokatit të Popullit. Gjatë vitit 2018, vetëm një raport me rekomandime ka mbetur në proces shqyrtimi (ndërsa, mesatarisht, 10 nga 11 rekomandimet janë shqyrtuar nga shërbimet e bashkisë). Rreth 62% e bashkive nuk kanë marrë ndonjë rekomandim nga Avokati i Popullit.

Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor

mbetet një sfidë. Rreth 46% (më pak se gjysma) e bashkive kanë konfirmuar bashkëpunimin me Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC) për çështje të ndryshme vendore kryesisht në lidhje me hartimin dhe rishikimin e politikave në nivel vendor dhe në lidhje me procesin e hartimit të buxhetit dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm. Kjo përqindje konfirmon edhe faktin se Organizatat e Shoqërisë Civile nuk janë krijuar në të gjithë Shqipërinë. Në veçanti, bashkitë e vogla nuk kanë prezencë të organizatave të shoqërisë civile. Nga 252 rekomandimet e dhëna nga Organizatat e Shoqërisë Civile në vitin 2018, 204 rekomandime (ose 93%) janë marrë parasysh nga këshillat bashkiakë dhe administrata vendore gjatë procesit të shqyrtimit. Ekziston nevoja për të zhvilluar një sistem me qëllim që të regjistrohen rekomandimet e dhëna nga Organizatat e Shoqërisë Civile për proceset e ndryshme vendimmarrëse dhe numrin e atyre që janë marrë parasysh. Kapacitetet financiare të bashkive për të mbështetur aktivitetet e Organizatave të Shoqërisë Civile në fushat e tyre administrative mbeten shumë të kufizuara. Vetëm 18 bashki arritën të jepnin grante në vitin 2018. Numri i përgjithshëm i granteve ishte 67. Bashkia e Shkodrës ka raportuar dhënien e 23 granteve për Organizatat e Shoqërisë Civile, e ndjekur nga Bashkia e Hasit me 6 grante. 69% e bashkive nuk kanë dhënë grante për Organizatat vendore të Shoqërisë Civile.

Zbatimi i ligjeve / Shteti së Drejtës

Zbatimi i rregullave të deklarimit të pasurive dhe të kontrollit të konfliktit të interesit po tregon progres. 58 nga 61 kryetarët e bashkive kanë dorëzuar deklaratën e pasurisë në vitin 2018 sipas legjislacionit. Kjo shënon përmirësim krahasuar me vitin 2017 ku deklaratat e pasurive janë dorëzuar nga 87% ose 53 kryetarë bashkiakë. Rreth 31% e bashkive deklaruan raste të shkeljeve të procedurave administrative përfshirë prokurimin publik. Administrata vendore mori masa për të zbutur rreziqet dhe i trajtoi ato sipas rregullave. Rreth 90% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë pasur raste të konfliktit të interesit në procesin e vendimmarrjes. Vetëm bashkitë e Divjakës, Tropojës dhe

Kurbinit kanë raportuar raste ku është identifikuar konflikti i interesave. Rrjeti i koordinatorëve vendorë kundër korrupsionit është ngritur në 53% të bashkive, duke shënuar kështu progres krahasuar me 36% në vitin 2017.

Masat për të futur mekanizma sistematik anti-korrupsion mbeten një çështje shqetësuese. Vetëm 15% e bashkive kanë miratuar planin e integritetit vendor sipas Planit të Veprim-it Anti-Korrupsion 2018-2020, ndërkohë që Plani i Integritetit ishte në proces hartimi në dy bashki. Rreth 8% e bashkive kanë paraqitur të dhëna të pasakta ose nuk kanë paraqitur fare të dhëna lidhur me këtë tregues. Vetëm 44% e bashkive, të cilat kanë miratuar Planin e Integritetit, kanë akorduar një zë të veçantë buxhetor për ta zbatuar atë në vitin 2018. Mesatarisht, 47% e bashkive kanë marrë pjesë në 2 (dy) trajnime lidhur me luftën kundër korrupsionit, ndërsa 53% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet trajnimi në vitin 2018.

Të drejtat e njeriut

Janë bërë disa përpjekje në drejtim të rritjes së kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut, ndërkohë që është raportuar një bashkëpunim i mirë me Organizatat e Shoqërisë Civile. Në vitin 2018, ASPA dhe disa ofrues të tjerë shërbimesh organizuan një numër trajnimesh për standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për zyrtarët publikë vendorë. U realizuan, mesatarisht, 4 trajnime për 22 bashki (ose 39% të bashkive); 61% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim për standardet e të drejtave të njeriut. Rreth 31% e bashkive kanë raportuar se është krijuar bashkëpunim i mirë me Organizatat vendore të Shoqërisë Civile në drejtim të trajtimit dhe shqyrtimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut në vitin 2018. Rreth 95% e 319 rasteve të identifikuar/referuara në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut janë trajtuar sipas protokolleve nga grupi ndërinstitucional i kryesuar nga shërbimet e bashkisë.

KRITERET EKONOMIKE

Ekzistenca e një ekonomie

tregu funksionale

Mbështetja e NVM-ve ka shënuar njëfarë progresi dhe janë krijuar një numër praktikash të mira, megjithatë, të gjitha bashkitë duhet të japin një mbështetje të tillë. Zhvillimi ekonomik është një nga funksionet kryesore të qeverisjes vendore sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Rreth 67% e bashkive kanë hartuar, të paktën, një Plan Strategjik të Zhvillimit Vendor, duke përmirësuar kështu mjedisin e biznesit; 26% e bashkive nuk kanë hartuar ende një plan të tillë strategjik dhe miratuar nga këshilli bashkiak. Në vitin 2018 u krijuan rreth 8,245 NVM të reja (ose, mesatarisht, 142);

Rreth 33% e bashkive nuk kanë ofruar shërbime të veçanta për zhvillimin e NVM-ve. Disa bashki kanë krijuar lehtësira tatimore për të mbështetur, në mënyrë të veçantë, NVM-të e drejtuara nga gratë.

AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Është bërë njëfarë **progresi drejt rritjes** së kapaciteteve të **qeverisjes vendore** në lidhje me sistemin e informacionit dhe këshillimit rural dhe bujqësor, si dhe në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës rurale. Zyrat e Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB) janë ngritur në 56% të bashkive. Vetëm 58% e bashkive kanë marrë pjesë në programet e rritjes së kapaciteteve. Pavarësisht progresit të arritur në lidhje me realizimin e funksioneve të reja të decentralizuara në vitin 2016, përqindja mesatare e rrjetit të përmirësuar të kullimit nga shërbimet bashkiake ishte 38% në vitin 2018, ndërsa ajo e rrjetit të ujitjes ishte 44%.

Zbatimi i metodës LEADER dhe regjistrimi i Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) po përparon shumë ngadalë. Rreth 64% e bashkive nuk i kishin krijuar Grupet Vendore të Veprimit deri në fund të vitit 2018. Regjistrimi i AMTP-ve është mesatarisht rreth 49% në nivel kombëtar; 3 bashki kanë regjistruar 61% deri në 80% të numrit të përgjithshëm të AMTP-ve, ndërsa 14 bashki kanë një nivel regjistrimi nga 81% në 100%.

Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Përmirësimi i kushteve sanitare dhe veterinarë për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve mbetet ende një shqetësim. Në vitin 2018, rreth 43% e bashkive nuk kishin veteriner; 23% e bashkive kanë licencuar tregjet e tregtimit të kafshëve, ndërsa 69% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë një treg të licencuar; 28% e bashkive kanë raportuar raste të shkeljeve të sigurisë ushqimore dhe veterinarë. Sa i përket zbatimit të standardeve, rreth 43% e bashkive nuk kanë përmbushur standardet e tregjeve ushqimore me pakicë; 25% e bashkive kanë raportuar se të gjitha

tregjet e tyre me pakicë janë në përputhje me standardet e kërkuara.

Politikat e transportit

Rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor po tregon njëfarë progresi, megjithëse bëhen pak përpjekje për të nxitur ecjen në këmbë dhe përdorimin e biçikletave. Në vitin 2018, vetëm 52% e rrjetit urban ekzistues në territorin e bashkive plotësonte standardet rrugore, 33% e rrjetit rural ekzistues të bashkive plotësonte standardet rrugore dhe, mesatarisht, 35% e sinjalistikës rrugore plotësonte standardet. Mesatarisht, rreth 8.6% e buxhetit të përgjithshëm bashkiak është dhënë për mirëmbajtjen e rrugëve ndërkohë që për sigurinë rrugore është dhënë 6.82% e buxhetit bashkiak për sektorin e transportit. Vetëm 26% e bashkive kanë ndërtuar korsi biçikletash, ndërkohë që përqindja mesatare për korsi biçikletash ishte 4.1% e gjatësisë së rrjetit urban në vitin 2018, gjë që përbën një përqindje të vogël. 48% e bashkive nuk kanë korsi biçikletash në zonat e tyre urbane.

Përmirësimi i transportit publik dhe ofrimi i shërbimeve dhe mjediseve cilësore për qytetarët mbetet një problem. Rreth 66% e bashkive publikuan orarin e transportit publik në territorin e tyre. 15% e bashkive dhanë buxhet për mirëmbajtjen e automjeteve të transportit publik me një mesatare prej 7% të buxhetit vendor për sektorin e transportit në vitin 2018; rreth 66% e bashkive kanë siguruar mirëmbajtjen e automjeteve publike përmes nënkontraktimit të subjekteve private.

Energjia

Shumë pak progres është bërë në drejtim të rritjes së efikasitetit të përdorimit të energjisë, ndërkohë që janë bërë disa përpjekje për të rritur vetëdijësimin e qytetarëve për përdorimin më efikas të energjisë. Në vitin 2018, rreth 24% e bashkive kanë emëruar drejtuesin e efikasitetit të energjisë. 66% e bashkive nuk kishin emëruar drejtuesin e efikasitetit të energjisë deri në fund të vitit 2018. 23% e bashkive kanë bërë trajnimin dhe certifikimin e drejtuesit të efikasitetit të energjisë në nivel

vendor; 67% e bashkive nuk kishin hartuar Plan Veprimi Vendor për efikasitetin e energjisë deri në fund të vitit 2018. 61% e bashkive kanë organizuar fushata këshillimore me institucionet publike dhe komunitetin e biznesit për efikasitetin e energjisë në nivel vendor - në vitin 2018 është organizuar, mesatarisht, 1 fushatë për efikasitetin e energjisë; 24% e bashkive nuk kanë organizuar ndonjë fushatë këshillimore. Nuk është raportuar ndonjë progres i veçantë lidhur me rritjen e kapaciteteve institucionale për efikasitetin e energjisë: 64% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim. Shërbimet bashkiake kryen, mesatarisht, 1 inspeksion lidhur me kërkesat që i përkasin efikasitetit të energjisë.

Taksat

Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tatimeve vendore synon nxitjen e Ekonomisë formale. Rreth 77% e bashkive kanë miratuar politikën e taksave vendore për të nxitur ekonominë formale (ky tregues përbën përmirësim krahasuar me vitin 2017 kur ishte në nivelin 51%); shërbimet tatimore bashkiake kryen një numër mesatar prej 858 inspeksionesh në terren në vitin 2018 (ose më shumë se dyfishi krahasuar me numrin e inspeksioneve të realizuara në vitin 2017) për të luftuar informalitetin në ekonomi. Rreth 88% e bashkive kanë krijuar dhe përditësuar rregullisht bazën e të dhënave të debitorëve bashkiak. Në funksion të rritjes së transparencës dhe konsultimit me publikun, bashkitë organizuan, mesatarisht, 5 dëgjesa publike për informim dhe konsultim publik në lidhje me politikën tatimore vendore në vitin 2018 (25% më e lartë krahasuar me vitin 2017).

Politika sociale dhe punësimi

Është bërë progres i kufizuar në aspektin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Numri mesatar i zyrtarëve shtesë të qeverisjes vendore që janë përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki ishte 2 (dy) në vitin 2018; rreth 50% e bashkive nuk patën ndonjë staf shtesë në vitin 2018. 234 zyrtarë publikë ven-

dorë u trajnuan për aspekte të ndryshme të fushave të mbrojtjes sociale në vitin 2018 – mesatarisht, 4 pjesëtarë të stafit vendor janë trajnuar nga të gjitha bashkitë (ky tregues është më e ulët krahasuar me 6 pjesëtarë të stafit vendor që ishin trajnuar në vitin 2017); rreth 28% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë program të rritjes së kapaciteteve në vitin 2018. 51% e bashkive nuk kanë krijuar ende Sektorin e Vlerësimit të Nevojave dhe të Referimit brenda Drejtorisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë. 54% e bashkive kanë hartuar Raportin e Vlerësimit të Mbrojtjes Sociale në nivel vendor. 46% e bashkive kanë hartuar planin vendor të përfshirjes sociale. 53% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në vitin 2018 në ndonjë program trajnimi në lidhje me metodologjinë e mbrojtjes dhe të përfshirjes sociale.

Bashkëpunimi në drejtim të mbështetjes së programeve aktive të punës ka treguar njëfarë progresi. Në vitin 2018, rreth 23% e bashkive bashkëpunuan me shërbimet e punësimit (Zyrat Rajonale të Punësimit/Zyrat Lokale të Punësimit) për të rritur mundësitë e punësimit dhe të zhvillimit të aftësive, gjë që tregon përmirësim krahasuar me 10% të raportuar në vitin 2017. Megjithatë, 66% e bashkive nuk raportuan ndonjë bashkëpunim. Rreth 15% e bashkive kanë përkrahur persona të rinj të arsimuar për ngritjen e një biznesi të ri, ose janë mbështetur, mesatarisht, 5 raste. Rreth 15% e bashkive kanë raportuar se ka një nivel shumë të mirë/të mirë të vetëdijesimit rreth NEET (Persona që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim), ndërsa 69% e bashkive kanë raportuar nivel të ulët ose shumë të ulët i vetëdijesimit për NEET.

Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Është bërë progres shumë i mirë në drejtim të forcimit të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ndërkohë që buxheti i caktuar për masat e mbrojtjes së fëmijëve mbetet i ulët. Rreth 90% e bashkive kanë ngritur në vitin 2018 Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve brenda Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale (krahasuar me 61% në vitin 2017). Rreth 80% e bash-

kive kanë krijuar sistemin e monitorimit të rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në territorin e bashkisë (krahasuar me 49% në vitin 2017). 85% e bashkive organizuan në vitin 2018 gjithsej 620 takime të grupeve ndërdisiplinore për rastet e abuzimit me fëmijët, rastet e dhunës, rastet e shfrytëzimit ekonomik ose format e tjera të shkeljeve, me një numër mesatar prej 11 takimesh. Rreth 1.064 raste janë identifikuar dhe trajtuar nga grupi ndërdisiplinor për mbrojtjen e fëmijëve në vitin 2018, me një mesatare prej 24 raste në vitin 2018 (19 raste të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve të identifikuar në vitin 2017). Janë 175 punonjës socialë, në nivel kombëtar, të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve (mesatarisht 3 punonjës për bashki). 25% e bashkive kanë dhënë buxhet të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve, me një mesatare prej 4.5% të buxhetit të sektorit social; rreth 54% e bashkive nuk raportuan buxhet të dedikuar për vitin 2018;

Në funksion të zbatimit efikas të Ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rreth 69% e bashkive kanë marrë pjesë në programet e rritjes së kapaciteteve për mbrojtjen nga diskriminimi, ose janë trajnuar, mesatarisht, 6 pjesëtarë të personelit; rreth 48% e të gjitha bashkive kanë ngritur sistemin e monitorimit të rasteve të diskriminimit, të cilat identifikohen në territorin e Bashkisë; 7% e bashkive (ose 4 bashki) kanë raportuar bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (krahasuar me 13% në vitin 2017); 93% e bashkive nuk kanë pasur bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2018; rreth 49% e bashkive nuk organizuan ndonjë fushatë vetëdijesimi për mbrojtjen nga të gjitha format diskriminimit.

Në funksion të zbatimit efikas të Ligjit 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave etnike”, rreth 47% e bashkive kanë organizuar aktivitete sociale dhe kulturore dhe fushata ndërgjegjësimit për të drejtat dhe mbrojtjen e pakicave etnike; 7% e bashkive (N = 57) ofrojnë shërbime publike në dy gjuhë.

Është raportuar **progres në lidhje me rritjen e kapaciteteve të administratës vendore në funksion të integritit të pakicave Rome dhe Egjiptiane;** rreth 28% e stafit të bashkive morën pjesë në programet e trajnimit për angazhimet vendore në lidhje me Planin Vendor të Integritit të Pakicave Rome dhe Egjiptiane PVIPIRE; 72% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë program trajnimi për zbatimin e Planit Vendor të Integritit të Pakicave Rome dhe Egjiptiane. Plani Vendor i Integritit të Romëve dhe Egjiptianëve është hartuar nga bashkitë dhe miratuar nga këshillat bashkiak në rreth 30% të bashkive; 45% e bashkive kanë marrë pjesë në trajnime për sistemin ROMALB duke përfshirë mbledhjen, përditësimin dhe raportimin e të dhënave (N = 55), me një mesatare prej 2 trajnimesh në vitin 2018. Rreth 51% e bashkive (N = 57) kanë mbështetur komunitetet Egjiptiane me projekte investimi, të cilat financohen nga buxheti qendror në kuadër të programit të strehimit social në vitin 2018.

Masat për forcimin e barazisë gjinore dhe hartimin e buxhetit me ndjeshmëri gjinore kanë vazhduar. Rreth 72% e bashkive kanë ngritur Sektorin e Barazisë Gjinore si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale; rreth 83% të bashkive kanë emëruar koordinatorin vendor që është përgjegjës për çështjet gjinore. Në total, janë trajnuar 146 anëtarë të stafit ose, mesatarisht, 4 anëtarë të stafit për çështjet gjinore; rreth 82% e bashkive kanë ofruar shërbime të specializuara (gjithsej 99 shërbime) për gratë që kanë qenë viktime të dhunës në familje; 25% e bashkive kanë përgatitur buxhet/Program Buxhetor Afatmesëm të ndjeshëm gjinor; duke iu referuar menaxhimit të rasteve, 59% e bashkive kanë raportuar shërbime të ofruara për 156 menaxhime rastesh në vitin 2018; rreth 52% e bashkive kanë bashkëpunuar me shoqërinë civile në lidhje me çështjet e barazisë gjinore përmes aktiviteteve të përbashkëta dhe partneriteteve.

Është bërë **progres i ngadaltë lidhur me sigurimin e zbatimit efikas të Ligjit 93/2014**

“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Sektori për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin është ngritur në 36% të bashkive. Rreth 66% e njësive të shërbimit në bashki kanë marrë pjesë në fushatën e promovimit dhe të vetëdijesimit për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe kanë ndjekur trajnimet mbi standardet e aksesueshmërisë. Infrastruktura shkollore, e cila përmbush standardet për Personat me Aftësi të Kufizuara, është e disponueshme mesatarisht në nivelin e 34% të bashkive, ndërsa rreth 23% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë infrastrukturë rrugore, e cila ka aksesueshmëri për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Drejhtësia, liria dhe siguria

Është bërë **progres i vogël** në drejtim të avancimit të luftës kundër krimit të organizuar. Rreth 46% e bashkive kanë ngritur grupin e punës në përputhje me Planin e Veprimit për luftën kundër krimit të organizuar në funksion të përfshirjes dhe të avancimit të veprimeve të bashkive së bashku me aktivitetet e institucioneve të qeverisjes qendrore në luftën kundër krimit të organizuar. 49% e bashkive kishin hartuar dokumentin strategjik për sigurinë publike në fund të vitit 2018. Ka nevojë për më shumë përpjekje në drejtim të koordinimit institucional ndërmjet Ministrive përkatëse të linjës, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe bashkive. Rreth 51% e bashkive nuk e kishin ngritur Këshillin e Komunitetit deri në fund të vitit 2018.

Arsimi dhe kultura

Pjesëmarrja e fëmijëve në klasat përgatitore për arsimin parashkollor ka rënë. Numri mesatar i kopshteve në nivel kombëtar është 28 kopshte për bashki. Raporti i regjistrimit të fëmijëve që i përkasin grup-moshës 3-5 vjeç në këtë nivel të sistemit arsimor ka rënë nga 79% në vitin 2017 në 70% në vitin 2018, por ky numër mund të jetë më i lartë për shkak të faktit se 13% nuk kanë paraqitur të

dhëna. Mesatarisht, 232 fëmijë nga grupet e marginalizuara, përfshirë pakicat Rome dhe Egjiptiane, ndoqën arsimin parashkollor në vitin 2018. Fondi i dhënë për zhvillimin e infrastrukturës së kopshteve përbën mesatarisht 2.9% të buxhetit bashkiak.

Përpjekjet kanë vazhduar për të siguruar përfshirjen sasiore dhe cilësore të grupeve të marginalizuara në sistemin e arsimit parauniversitar. Mesatarisht, rreth 0, 42% e buxhetit bashkiak të vitit 2018 u përdor për regjistrimin të fëmijëve Romë dhe Egjiptianë dhe grupeve të tjera të marginalizuara në arsimin e detyrueshëm; numri mesatar i braktisjes së shkollës nga fëmijët që u përkasin këtyre grupeve ishte rreth 7.

Për përmirësimin e infrastrukturës shkollore të sistemit arsimor parauniversitar, në vitin 2018 është alokuar, mesatarisht, rreth 3.48% e buxhetit bashkiak. Rreth 20% e bashkive nuk kanë raportuar alokim të buxhetit vendor për investime në infrastrukturën shkollore. Planifikimi i infrastrukturës shkollore që mundëson aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara është realizuar me rreth 89% të bashkive.

Përfaqësuesi i bashkisë në bordet e shkollave ka qenë i pranishëm në rreth 87% të bashkive. Rreth 56% e bashkive kanë mbështetur iniciativat në lidhje me ngritjen e komunikimit shkollë-prindër-qeveri, ndërsa 36% e bashkive kanë mbetur prapa në lidhje me zbatimin e një initiative të tillë.

Është bërë progres i mirë në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, ndërkohë që burimet financiare janë ende të kufizuara për të investuar më shumë në këtë fushë të rëndësishme për turizmin dhe zhvillimin ekonomik. Rreth 74% e bashkive nuk kanë raportuar raste të shkeljeve dhe të ndërtimeve të paligjshëm në zonat e trashëgimisë kulturore; 6 bashki (ose 10%) kanë raportuar 1 deri në 5 raste të shkeljeve. Shërbimet bashkiake morën masa – mesatarisht, 1,99% e buxhetit bashkiak të vitit 2018 u caktua për mbrojtjen e pasurive kulturore. Rreth 36% e

bashkive nuk dhanë buxhet specifik për këtë funksion. 11 aktivitete kulturore, mesatarisht, janë planifikuar dhe organizuar nga bashkitë në vitin 2018.

Politikat rajonale

Për sa i përket forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe vendor në mënyrë që **ai të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë rajonale, bashkëpunimi ndërbashkiak mbetet në një nivel modest ndërsa bashkëpunimi ndërkufitar po rritet.** Vetëm 56% e bashkive raportojnë për bashkëpunim me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, ndërsa 34% e bashkive kanë ndërmarrë iniciativa të përbashkëta për të reduktuar pabarazitë rajonale. 45% e bashkive janë të përfshira në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar, të cilat financohen nga programet ndërkufitare të IPA-s.

Mjedisi dhe ndryshimet

klimatike

Sa i përket rritjes së vetëdijesimit dhe rritjes së kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për rolin e **saj në lidhje me mbrojtjen e mjedisit**, 107 pjesëtarë të stafit vendor u trajnuan në vitin 2018; rreth 20% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në programin e rritjes së kapaciteteve për çështjet e mjedisit; 75% e bashkive kanë organizuar gjithsej 241 aktivitete për sensibilizimin dhe edukimin e brezave të rinj; rreth 25% e bashkive nuk paraqitur të dhëna të sakta ose nuk kanë paraqitur fare të dhëna për aktivitetet vetëdijësuese në lidhje me mjedisin dhe mbrojtjen e natyrës.

Është bërë **progres i ngadaltë** në drejtim të hartimit të planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit në nivel **vendor**; 25% e bashkive kanë miratuar Planin Vendor të Veprimit (PVV) për përmirësimin e cilësisë së ajrit, ndërsa 67% e bashkive nuk kanë hartuar akoma PVV-në; 28% e bashkive kanë integruar masat vendore për përmirësimin e cilësisë së ajrit në dokumentin strategjik bashkiak përfshirë edhe Programin Buxhetor Afatmesëm.

Është **raportuar progres në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve**; rreth 49% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar Planin e Menaxhimit të Mbetjeve, i cili është pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm (përqindja e këtij treguesi është më e lartë krahasuar me vitin 2017), ndërsa 46% e bashkive nuk kanë një Plan të tillë të Menaxhimit të Mbetjeve; 64% e bashkive kanë menaxhuar grumbullimin e mbetjeve të ngurta dhe depozitimin e tyre në vend-depozitime sipas planit vendor të menaxhimit (kjo tregon përmirësim krahasuar me vitin 2017 - në rangun e 43%); rreth 85% e bashkive nuk riciklojnë mbeturinat bashkiake dhe rreth 95% e bashkive nuk kanë qenë në gjendje të menaxhojnë mbeturinat e bashkisë në dy rryma të ndara; bashkitë kanë raportuar për rreth 71 vend-depozitime të autorizuar, ose mesatarisht 1 vend-depozitim, për vitin 2018.

Asnjë progres i veçantë nuk është bërë në drejtim të forcimit të zbatimit të vendimit të grupit të punës për ndotjen akustike në zonat urbane dhe zonat turistike bregdetare. 44% e bashkive nuk e kishin krijuar task forcën për ndotjen akustike deri në fund të vitit 2018; në total, ekzistojnë 88 inspektorë ose një numër mesatar prej 1-2 inspektorësh për bashki; janë organizuar 7 trajnime për inspektorët bashkiakë për ndotjen akustike, për kuadrin ligjor dhe masat në nivel vendor.

Duhen më shumë përpjekje në drejtim të integritetit të rreziqeve të ndryshimeve klimatike në planet **vendore** në harmoni me prioritetet dhe objektivat kombëtare. 66% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar planin vendor të masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshimeve klimatike në përputhje me prioritetet dhe objektivat kombëtare, por rreth 75% e bashkive ende nuk kanë mbledhur dhe regjistruar të dhëna për ndryshimet klimatike; 61% e bashkive nuk morën pjesë në asnjë trajnim për ndryshimet klimatike.

Është bërë **progres i ngadaltë në drejtim të rritjes së kapaciteteve vendore në funksion të menaxhimit efikas** të fondit të pyjeve dhe kullotave dhe


pyllëzimit të zonave të degraduara përmes riciklimit në destinacion të të ardhurave nga burimet pyjore. Rreth 33% e bashkive nuk kanë hartuar asnjë plan veprimi për menaxhimin e fondit të pyjeve dhe kullotave. Punësimi i bashkive për këtë funksion ishte mesatarisht 65% në vitin 2018 krahasuar me standardin për specialistin e pyjeve. Lidhur me bazën e të dhënave për subjektet private që kanë aktivitete që lidhen me menaxhimin e fondit pyjor dhe të kullotave të bashkisë, rreth 25% e bashkive ende nuk kishin krijuar asnjë bazë të dhënash deri në fund të vitit 2018.

Kontrolli financiar

Kapacitetet njerëzore dhe teknike të adminis-

tratës vendore janë përmirësuar në lidhje me menaxhimin e shpenzimeve publike duke përfshirë kapacitetet e planifikimit dhe të zbatimit të buxhetit. Të ardhurat e vetëqeverisjes vendore nga taksat dhe tatimet vendore u rritën me 19% në nivel kombëtar krahasuar me vitin 2017, por ka dallime në performancën individuale të bashkive.

Rreth një e treta e bashkive kanë mbledhur më pak të ardhura në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017; dy të tretat e bashkive kanë mbledhur më shumë të ardhura në 2018 krahasuar me vitin 2017, duke filluar nga 10% deri në 79%. Shpenzimet e qeverisjes vendore në vitin 2018 janë rritur me 7% krahasuar me vitin 2017.



1. HYRJE

Ky është raporti i dytë kombëtar për përpjekjet dhe llogaridhënien e vetëqeverisjes vendore në funksion të procesit të pranimit në BE duke përfshirë demokracinë vendore, shtetin e së drejtës, administratën publike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, të drejtat e njeriut dhe punën e vetëqeverisjes vendore, siç parashikohet në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Qëllimi i veçantë i raportit është të japë një vlerësim të bashkive në raport me një sërë treguesish në fushat kryesore që lidhen me kriteret politike dhe ekonomike, si dhe me standardet e përcaktuara në kuadrin aktual të kapitujve përkatës të *Acqui Com-munitaire* mbi funksionet e vetëqeverisjes vendore siç parashikohet në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.² Raporti analizon informacionin për vitin 2018, duke bërë kështu një krahasim, sipas rastit, me vlerësimin e bashkive të realizuar në vitin 2017.

Gjetjet e raportit dhe të dhënat përkatëse për tema dhe parime të veçanta do të japin informacion të dobishëm që mund të çojë në zhvillimin e politikave dhe masave të reja, si nga qeveria qendrore ashtu edhe nga strukturat e pushtetit vendor, për të përmirësuar situatën.

Metodologjia e këtij raporti ndjek metodologjinë e hartimit dhe të mbledhjes së të dhënave të raportit të parë (2018) me disa përmirësime në kuptimin e ripërcaktimit të tregueseve të vlerësimit bazuar në konsulti-

met që janë realizuar gjatë periudhës korrik-gusht 2018 me të gjitha ministritë përkatëse të linjës dhe me institucionet e tjera qendrore publike. Treguesit e rishikuar janë diskutuar me Koordinatorët Vendor të BE-së dhe me bashkitë në tetor të vitit 2018.

Treguesit e vlerësimit janë organizuar sipas tre komponentëve të Komisionit Evropian në Raportin e Progresit për Shqipërinë si më poshtë vijon: (i) kriteret politike, (ii) kriteret ekonomike dhe (iii) aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Meqenëse institucionet e qeverisë qendrore kanë detyrë të ndjekin dhe të avancojnë kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në dokumentet strategjike dhe politike kombëtare dhe në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2017-2020, edhe bashkitë kanë gjithashtu përgjegjësi për zbatimin e politikave dhe ligjeve përkatëse, të cilat janë pjesë e së njëjtës axhendë kombëtare të integritimit evropian.

Treguesit e vlerësimit janë grupuar në bazë të tre kriterëve dhe kapitujve të sipërpërmendur. Përveç kësaj, përkufizimi i treguesve të vlerësimit mori parasysh sa më poshtë vijon:

- Objektivat e përgjithshme dhe specifike të politikave strategjike kombëtare dhe dokumenteve kombëtare, për të cilat bashkitë duhet të bëjnë përparime dhe të kenë përgjegjësi për marrjen e masave;

2

Grupi i treguesëve është përcaktuar në matricën «Bashkitë në procesin e integritimit në BE»

- Objektivat e reformës së decentralizimit dhe të vetëqeverisjes vendore në drejtim të rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të shërbimeve publike të ofruara nga vetëqeverisja vendore në bazë të standardeve të BE-së, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e vetëqeverisjes vendore ndaj komunitetit dhe duke rritur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të palëve të interesuara në proceset vendimarrëse të vetëqeverisjes vendore.

Kufizimet dhe problemet me të dhënat

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga bashkitë është një shqetësim i madh. Nuk ka të dhëna përkatëse të disponueshme nga INSTAT për fushat e mbuluara nga raporti.

Sistemi statistikor në nivel bashkiak pothuajse nuk ekziston. Kjo e bën të vështirë që bashkitë të raportojnë mbi të gjithë treguesit. Cilësia e të dhënave dytësore nga bashkitë është e diskutueshme dhe kërkon kontrole të mëtejshme. Të gjitha matricat e dorëzuara brenda afatit të parë u kontrolluan dhe u kthyen në bashki për rishikimin e mëtejshëm të të dhënave dhe për qartësim të informacionit.

Të gjitha të dhënat e analizuara, të cilat i përmban ky raport, janë paraqitur nga bashkitë, prandaj përgjegjësia për saktësinë dhe shifrat përkatëse të të dhënave është përgjegjësi e secilës administrate bashkiake.

2. KRITERET POLITIKE

Qëndrueshmëria e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave

2.1. Demokracia


2.1.1. Qeverisja

Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të qeverisë qendrore dhe vendore nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit efektiv të Këshillit Konsultativ (KK).

Progresi në arritjen e objektivit do të vlerësohet bazuar në disa tregues përformance, si: (i) Këshilli Konsultativ ndërmjet QQ dhe QV i ngritur sipas një baze ligjore përkatëse (tregues i përbushur), (ii) KK funksional: numri i takimeve të KK brenda 1 viti, (iii) Shkalla mesatare e pjesëmarrjes së Kryetarëve të bashkive në takimet e KK, (iv) Shkalla mesatare e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Qeverisë Qendrore

në takimet e KK, dhe (v) Numri i akteve ligjore që kanë kaluar procedurën e konsultimit në KK.

Në vitin 2018, progres është bërë në funksionimin e KK³ - gjithsej, shtatë (7) takime të Këshillit Konsultativ janë organizuar me mbështetje të AMVV dhe Ministrisë së Brendshme. Është institucionalizuar procesi i konsultimit ndërmjet Qeverisë Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore për përfshirjen aktive të të gjitha palëve në procesin e hartimit dhe konsultimit mbi projekt-vendime/projekt-ligje të ndryshme dhe projekt-strategji të propozuara nga Qeveria Qendrore. Është rritur transparenca duke siguruar përfshirjen e shoqatave të vetëqeverisjes vendore në procesin e hartimit dhe konsultimit të projekt-akteve ose projekt-ligjeve, si dhe nëpërmjet informimit të plotë të Bashkive mbi çështje të rëndësishme në proces diskutimi e konsultimi, si dhe mbi masat shoqeruese që Bashkitë duhet të ndërmerrnin lidhur me zbatimin e ligjeve dhe vendimeve të reja (VKV-ve).



3 Këshilli Konsultativ është krijuar me VKM Nr. 910, datë 21.12.2016 mbi "Mbi mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, çështjet, objekt i konsultimit, struktura, procedurat dhe forma.

Shkalla mesatare e pjesëmarrjes së Kryetarëve të Bashkivë në takimet e KK ka qënë 72%; niveli i pjesëmarrjes varion nga 65% deri në 90%.

Pjesëmarrja e përfaqësueve të qeverisë qëndrore ka qënë me e larte kundrejt Kryetarëve të Bashkivë: shkalla mesatare ka qënë 85% në vitin 2018, duke variuar nga 70% deri në 95%.

Shkalla e pjesëmarrjes totale duke përfshire qeverinë qëndrore dhe vendore ka qënë 79%.

Këshilli Konsultativ ka marrë në shqyrtim 38 akte ligjore nga 40 në total të paraqitura gjatë vitit 2018, nga të cilat 8 Projekt-ligje dhe 19 projekt-vendime të miratura.

Janë tërhequr për rishikim 3 VKM⁴

Prezantuar dhe miratuar në parim 2 studime mbi “Vlerësimi Afatmesëm i Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore (MTR) dhe “Programi për Transparencën, Komisioneri për Informim dhe IDM”.

timin e projekt ligjeve/vendimeve si dhe në analiza mbi impaktin e zbatimit të ligjeve dhe VKM tek qeverisja vendore, si dhe në hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e qeverisjes vendore në kuadër të axhendës për integrimin evropian.

- Monitorimi i zbatimit të Plan Veprimit (PV) të Strategjisë Ndërsektoriale për decentralizimin dhe QV dhe marrja e masave për adresimin e çështjeve kritike që pengojnë zbatimin efektive të PV
- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të studimeve të kryera lidhur me vetëqeverisjen vendore me mbështetje të projekteve nga donatorë të ndryshëm.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (Objektivi 16) për Paqen, Drejtësinë dhe Institucionet e Forta kanë theksuar forcimin e institucioneve publike dhe të qeverisjes. Ky objektivi shprehet në dokumentet strategjike kombëtare sa më poshtë vijon: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI),

Tabela 1: Akte nënligjore të trajtuar nga KK në vitin 2018

| | Paraqitur | Shqyrtuar | Miratuar | Kthyer për Shqyrtim | Në proces | Pa kaluar për 2018 |
|---------------------------------|-----------|-----------|----------|---------------------|-----------|--------------------|
| Projektligje | 10 | 10 | 8 | 1 | 1 | - |
| Projektligje | 22 | 22 | 19 | 3 | 3 | - |
| Prezantime | 8 | 6 | 6 | - | - | 2 |
| TOTAL 7 Mbledhje për vitin 2018 | 40 | 38 | 33 | 4 | 5 | 2 |

Konkluzione:

Në vitin 2018 është përmirësuar funksionimi dhe roli i Këshillit Konsultativ si një mekanizëm efektiv i bashkëbisedimit midis qeverisë vendore dhe qëndrore, si dhe është përmirësuar transparenca, informimi për NJQV dhe përfshirja e shoqatave të vetëqeverisjes vendore.

Sfida:

- Rritja e pjesëmarrjes së Kryetarëve të Bashkivë në takimet e KK.
- Fuqizimi i mëtejshëm i rolit këshillues dhe konsultativ të KK në hartimin dhe konsul-

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës së Administratës Publike 2016-2020 (SNRAP) dhe Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020 (SNKDQV). Sipas këtyre dokumenteve strategjike, objektivi specifik që lidhet me qeverisjen është rritja e kapaciteteve të administratës publike duke përfshirë institucionin e vetëqeverisjes vendore (NJQV) nëpërmjet krijimit në nivel vendor të një shërbimi civil të bazuar në meritë dhe të qëndrueshëm, nëpërmjet përmirësimit të stabilitetit dhe profesionalizimit të administratës publike me anë të

4 Projekt-vendimi “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”; Projekt-vendimi “Për Funksionet e Deleguara dhe Përdorimin e Fondeve për këto Funksione”; Projekt-vendimi “Për shërbimet e decentralizuara arsimore dhe bashkëpunimi me MASR- infrastruktura shkollore, financimi i arsimit parashkollor dhe transporti në zonat rurale”.

trajnimin të thelluar dhe të vazhdueshëm të nëpunësve civilë të administratës publike qendrore dhe vendore dhe nëpërmjet forcimit të aftësive drejtuese dhe udhëheqëse. Pavarësisht përpjekjeve, zbatimi i ligjit të shërbimit civil ende mbetet larg garantimit të ngritjes së një shërbimi civil⁵ të bazuar në meritë në nivel vendor.

Parimi i 7^{te} i qeverisjes së mirë⁶ në nivel vendor thekson rëndësinë e aftësive dhe të kapaciteteve të administratës vendore bazuar në tre koncepte kryesore:

- (i) Aftësitë profesionale të atyre që realizojnë qeverisjen ruhen dhe forcohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që të përmirësohet rezultati dhe ndikimi i tyre;
- (ii) Zyrtarët publikë janë të motivuar për të përmirësuar performancën e tyre në mënyrë të vazhdueshme;

Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) kanë përmirësuar sistemin e trajnimit për administratën publike vendore përmes një procesi të rishikimit të kurrikulës (91 kurrikula të rishikuara) bazuar në kriteret e sigurimit të cilësisë; procedurat e certifikimit të pjesëmarrësve në trajnimet e ASPA-s janë përmirësuar nëpërmjet ngritjes së bibliotekës elektronike, e cila bën të mundur që kurrikulat e trajnimit të jenë të aksesueshme nga zyrtarët publikë; për administratën vendore është funksionale platforma elektronike E-PAV në funksion të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në vitin 2018, ASPA realizoi trajnime të detyrueshme për nëpunësit e rinj civilë të bashkive dhe trajnime specifike në fusha të ndryshme si më poshtë vijon: integrimi në BE, menaxhimi i burimeve njerëzore, financimi vendor, planifikimi strategjik dhe operativ, udhëheqësia, Kodi i Procedurave Administrative, administrimi i fondeve IPA, dhe fusha të tjera tematike.

ASPA ka përshtatur kurrikulën e Programit të Akademisë së Liderit (PAL) dhe ka ofruar trajnime në tre faza për përfaqë-

suesit e vetëqeverisje vendore dhe trajnim me një fazë për trupën e lartë drejtuese të shërbimit civil në nivel qendror. Janë përfunduar dy cikle trajnime për 24 pjesëmarrës duke përfshirë kryetarët e bashkive, nënkryetarët e bashkive dhe zyrtarët e nivelit të lartë të bashkive. Kursi është organizuar duke u bazuar në 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë.

Në vitin 2018, ASPA organizoi një numër mesatar prej rreth 7 trajnimesh për Ligjin

Kutia 1: Raporti i Progresit i KE-së për Shqipërinë, 2019


Për sa i përket vetëqeverisjes vendore, reforma administrative territoriale (RAT) duhet të konsolidohet më tej si pjesë e agjendës më të gjerë të decentralizimit. Qeveria ndërmori një rishikim afatmesëm të Strategjisë Ndërsëktoriale Kombëtare të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020. Edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit ka bërë gjithashtu një vlerësim të RAT-it dhe ka nxjerrë një raport për të në tetor të vitit 2018. Legjislacioni i ri që prek vetëqeverisjen vendore ende nuk është harmonizuar dhe zbatuar plotësisht.

e Shërbimit Civil (N=59) për zyrtarët vendorë publikë në krahasim me një mesatarë prej 3 trajnimesh të parashikuara në vitin 2017; mesatarisht, 13 zyrtarë publikë u trajnuan për legjislacionin e shërbimit civil (N=60) krahasuar me 12 zyrtarë të trajnuar në vitin 2017). Në total, 764 zyrtarë publikë vendorë (N=60) u trajnuan në vitin 2018 për Ligjin e Shërbimit Civil dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij. Vetëm 3 bashki, Hasi, Klosi dhe Vau i Dejës kanë raportuar se asnjë pjesëtarë i stafit nuk ka marrë pjesë në këto trajnime. Duhet përmendur se numri i bashkive, personeli i të cilave nuk ka përfutuar nga trajnimet e ASPA-s, ka rënë nga 29% në vitin 2017 (17 bashki) në vetëm 3 bashki në vitin 2018; Bashki e Lezhës nuk ka paraqitur të dhëna për këtë tregues.

5 KE, Dokument Pune për progresin e Shqipërisë, (17.04.2018)

6 Këshilli i Evropës - Përfshirja e 12 parimeve të qeverisjes së mirë në administratën vendore.


Grafiku 2



Trajnimet e organizuara nga ASPA për fushat tematike; mesatarisht, 17 zyrtarë publikë janë trajnuar në fusha të ndryshme tematike të administruara nga ASPA në vitin 2018 krahasuar me 14 zyrtarë të trajnuar në vitin

2017 (N=60). 3 (tre) bashki (ose 5%) nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim në fushat tematike në vitin 2018 (4% në vitin 2017); 1 bashki nuk ka paraqitur të dhëna për këtë tregues.

Grafiku 3



Rreth 71 zyrtarë publikë vendorë morën pjesë në trajnimet për Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me një mesatare prej 1 (një) personi (3 në vitin 2017); 169 persona u trajnuan për Kodin e Procedurave Administrative (N=59) ose, mesatarisht, 3 persona për bashki. 28% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në trajnime për Kodin e Procedurave Administrative; 3% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna për këtë tregues. Mesatarisht, 21 zyrtarë publikë janë trajnuar në fusha të ndryshme tematike nga ofruesit e tjerë të shërbimeve, që përbën gjithsej 1.316 persona. Rezultatet e një sondazhi të udhëhequr nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendorë/dldp (2018) kanë treguar se kontributi më i rëndësishëm i DAP-it dhe i ASPA-s në drejtim të rritjes së kapaciteteve për

administratën vendore përfshin sa më poshtë vijon: (i) përmirësimin e kurrikulave - 91 kurrikula të rishikuara përmes Sistemit të Sigurimit të Cilësisë; (ii) përmirësimin e sistemit të certifikimit të pjesëmarrësve; (iii) ngritjen e bibliotekës elektronike ose të e-bibliotekës; (iv) platformën elektronike operacionale E-PAV (DAP-i).

Buxheti vendor që jepet për rritjen e kapaciteteve të administratës vendore mbetet shumë i ulët. Rreth 52% e bashkive (N=54) kanë dhënë një buxhet të veçantë për trajnimet e stafit vendor, me një mesatare prej 1.9% të buxhetit të bashkisë; 48% e bashkive nuk kishin planifikuar asnjë buxhet për trajnime; bashkia mbulon vetëm shpenzimet e vogla (koston e transportit dhe dietat); rreth 11% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna për këtë tregues.

2. KRITERET POLITIKE

Tabela 2

2.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës së qeverisë vendore

| Bashkitë | Numri gjithsej i nëpunësve vendorë | Numri i trajnimeve mbi legjislacionin | Numri i nëpunësve vendorë të trajnuar mbi legjislacionin e NC | Numri i programeve të trajnimeve profesionale nga ASPA në të cilat bashkia ka marrë pjesë | Numri i nëpunësve vendorë që kanë marrë pjesë në trajnimet nga ASPA | Numri i nëpunësve vendorë që kanë marrë pjesë në trajnimet nga ofruer të tjerë | Numri i nëpunësve vendorë të trajnuar mbi Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) | Numri i nëpunësve vendorë të trajnuar mbi Kodin e Ri të Procedurave Administrative |
|----------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|---|---|--|---|--|
| Belsh | 189 | 0 | 3 | 3 | 3 | 15 | 1 | 1 |
| Berat | 128 | 3 | 12 | 20 | 20 | 30 | 2 | 0 |
| Bulqize | 398 | 4 | 14 | 2 | 16 | 20 | 0 | 3 |
| Cerrik | 112 | 10 | 8 | 5 | 20 | 10 | 1 | 1 |
| Delvine | 29 | 1 | 1 | 2 | 4 | 5 | 0 | 0 |
| Devoll | 297 | 30 | 35 | 10 | 50 | 50 | 1 | 4 |
| Diber | 194 | 1 | 36 | 5 | 50 | 6 | 0 | 0 |
| Divjake | 249 | 4 | 2 | 5 | 12 | 1 | 2 | 3 |
| Dropull | 50 | 18 | 2 | 2 | 4 | 16 | 1 | 0 |
| Durres | 345 | 3 | 19 | 4 | 40 | 32 | 4 | 5 |
| Elbasan | 458 | 96 | 96 | 6 | 6 | 9 | 2 | 3 |
| Fier | 366 | 2 | 10 | 3 | 10 | 0 | 1 | Nuk ka të dhëna |
| Finiq | 200 | 0 | 0 | 10 | 10 | 7 | 1 | 3 |
| Fushe Arrez | 65 | Nuk ka të dhëna | 2 | 2 | 15 | 30 | 0 | 1 |
| Gjirokaster | 83 | 1 | 8 | 4 | 15 | 21 | 2 | 4 |
| Gramsh | 313 | 3 | 3 | 9 | 12 | 18 | 1 | 5 |
| Has | 36 | 2 | 8 | 4 | 0 | 4 | 0 | 0 |
| Himare | 192 | 5 | 3 | 13 | 8 | 3 | 1 | 3 |
| Kamez | 175 | 1 | 1 | 18 | 38 | 32 | 1 | 5 |
| Kavaje | 604 | 7 | 9 | 3 | 12 | 0 | 0 | 9 |
| Kelcyre | 67 | 0 | 3 | 4 | 9 | 5 | 0 | 0 |
| Klos | 237 | 4 | 12 | 0 | 0 | 20 | 2 | 2 |
| Kolonje | 53 | 3 | 9 | 9 | 17 | 21 | 0 | 0 |
| Konispol | 136 | 4 | 3 | 6 | 11 | 6 | 1 | 2 |
| Korce | 162 | 0 | 0 | 4 | 6 | 10 | 1 | 0 |
| Kruje | 114 | 5 | 4 | 2 | 2 | 39 | 1 | 4 |
| Kucove | 124 | 4 | 4 | 2 | 15 | 10 | 0 | 8 |
| Kukes | 669 | 13 | 27 | 7 | 48 | 35 | 2 | 11 |
| Kurbin | 145 | 15 | 10 | 1 | 1 | 20 | 2 | 2 |
| Lezhe | 630 | 1 | 1 | 5 | Nuk ka të dhëna | 17 | 2 | 3 |
| Libohove | 83 | 21 | 20 | 13 | 14 | 40 | 3 | 1 |
| Librazhd | 119 | 1 | 14 | 4 | 16 | 10 | 1 | 14 |
| Lushnje | 277 | 10 | 15 | 105 | 20 | 23 | 0 | 4 |
| Malesi e Madhe | 380 | 4 | 10 | 2 | 10 | 6 | 2 | 3 |
| Maliq | 96 | 3 | 3 | 1 | 23 | 3 | 0 | 0 |
| Mallakaster | 60 | 1 | 1 | 6 | 12 | 23 | 1 | 0 |
| Mat | 147 | 35 | 46 | 8 | 21 | 25 | 2 | 2 |
| Memaliaj | 32 | 2 | 2 | 2 | 2 | 7 | 2 | Nuk ka të dhëna |
| Mirdite | 58 | 9 | 9 | 3 | 12 | 18 | 2 | 3 |
| Patos | 99 | 1 | 1 | 15 | 25 | 30 | 0 | 4 |
| Peqin | 264 | 0 | 6 | 1 | 15 | 9 | 2 | 0 |
| Permet | 82 | 2 | 7 | 4 | 9 | 4 | 0 | 0 |
| Pogradec | 680 | Nuk ka të dhëna | 72 | 10 | 78 | 50 | 2 | 4 |
| Polican | 70 | 3 | 11 | 1 | 15 | 8 | 0 | 2 |
| Prrenjas | 290 | 1 | 1 | 3 | 6 | 7 | 0 | 0 |
| Puke | 283 | 9 | 2 | 4 | 20 | 30 | 3 | 3 |
| Pustec | 8 | 0 | Nuk ka të dhëna | 2 | 4 | 10 | 1 | Jo |
| Roskovec | 321 | 1 | 2 | 1 | 2 | 18 | 2 | 4 |
| Rrogozhine | 100 | 2 | 1 | 7 | 3 | 14 | 0 | 2 |
| Sarande | 104 | 1 | 1 | 2 | 1 | 5 | 1 | 0 |
| Selenice | 150 | 1 | 20 | 1 | 20 | 30 | 3 | 20 |
| Shijak | 185 | 1 | 11 | 4 | 7 | 42 | 2 | 6 |
| Shkoder | 271 | 15 | 15 | 10 | 25 | 12 | 0 | 2 |
| Skrapar | 352 | 2 | 2 | 3 | 3 | 10 | 0 | 2 |
| Tepelene | 115 | 5 | 3 | 4 | 7 | 2 | 2 | 3 |
| Tirane | 6200 | 4 | 125 | 14 | 109 | 306 | 3 | 0 |
| Tropoje | 95 | 2 | 8 | 10 | 30 | 15 | 0 | 4 |
| Ura Vajgurore | 100 | 12 | 0 | 12 | 12 | 12 | 2 | 0 |
| Vau i Dejes | 215 | 6 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vlore | 354 | 2 | 3 | 3 | 5 | 19 | 1 | 2 |
| Vore | 211 | 2 | 2 | 7 | 28 | 36 | 2 | 2 |

Problemet dhe sfidat

- Buxheti i kufizuar i ASPA-s për të mbuluar të gjitha nevojat e njësisë të vetëqeverisjes vendore në lidhje me rritjen e kapaciteteve;
- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm vendor për qëllime trajnimi;
- Kërkesat e bashkive të paraqitura pranë ASPA-s për trajnime nuk janë bërë përmes analizave gjithëpërfshirëse të nevojave institucionale dhe prioriteteve dhe kërkesave të performancës në nivel vendor;
- Biblioteka elektronike duhet të jetë funksionale dhe e aksesueshme nga administrata vendore;
- Mjaftueshmëria e kompetencave, roleve dhe përgjegjësive administrative në lidhje me ushtrimin e funksioneve dhe realizimin e politikave të personelit;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe rritja e kapaciteteve: ngritja në kuadër të bashkisë e strukturave, të cilat do të jenë përgjegjëse për të garantuar ushtrimin e saktë të funksioneve dhe kompetencave që rrjedhin nga Planet e Zhvillimit të Përgjithshëm (planifikimi urban dhe zhvillimi strategjik);
- Shqyrtimi dhe unifikimi i strukturave administrative vendore; ekziston nevoja për të përcaktuar një raport të qartë midis numrit të administratës dhe numrit të popullsisë, së cilës do t'i ofrojë shërbime administrata;
- Rritja e kapaciteteve të administratës publike në fushën e statistikave, zhvillimin ekonomik, kapacitetet për monitorimin dhe raportimin në nivel vendor.

Objektivi specifik: rritja e transparencës së vetëqeverisjes vendore

Angazhimi dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara shton mundësitë që arrihen rezultatet e politikave për të gjithë dhe jo vetëm për disa (OECD, 2017d). Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i qytetarëve mishërohet në Parimin 2 të Qeverisjes së Mirë në nivel vendor, i cili përfshin: (i) qytetarët janë në qendër të veprimtarisë publike dhe përfshihen në jetën publike në nivel vendor në mënyra të përcaktuara qartë; (ii) të gjithë burrat dhe gratë mund të thonë fjalën e tyre në vendimmarrje, duke përfshirë edhe personat më pak të privilegjuar dhe më të rrezikuar, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve legjitime të ndërmjetme që përfaqësojnë interesat e tyre. Një pjesëmarrje e tillë e gjerë ndërtohet bazuar në lirinë e shprehjes, në të drejtën e tubimit paqësor dhe në të drejtën për t'u organizuar kolektivisht.⁷

Bashkitë shqiptare janë të detyruara me ligj⁸ që të garantojnë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes. Bashkitë kanë caktuar një koordinator i cili është përgjegjës për njoftimin dhe konsultimin publik. Konsultimi publik nuk kufizohet vetëm në konsultimin për buxhetin vjetor dhe buxhetin afatmesëm, por përfshin planin zhvillimor strategjik vendor dhe planin e mbrojtjes sociale. Shërbimet bashkiake kanë ftuar grupet e komunitetit, qytetarët individualë, OJQ-të, bizneset, mediat vendore për të mbledhur mendime dhe kontribute lidhur planet vendore të zhvillimit, me Programim Buxhetor Afatmesëm/programin vendor buxhetor.

7 Integrimi i 12 Parimeve të Qeverisjes së Mirë. Faqja e internetit: www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope

8 Ligji nr. 139/2015, Neni 16, "Për konsultimin publik".


92% e bashkive shqiptare kanë hartuar buxhetin e tyre vendor bazuar në metodën me pjesëmarrje; pasi të miratohet nga këshilli bashkiak, buxheti vendor publikohet në faqen e internetit, të cilën e ka zhvilluar Ministria e Ekonomisë dhe Financave: www.financatvendore.al. Pesë kategori qytetarësh kanë marrë pjesë dhe janë përfaqësuar nga Organizatat e Shoqërisë Civile vendore duke përfshirë gratë, të rinjtë, grupet vulnerabël, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat kombëtare etnike në procesin e hartimit të buxhetit dhe planifikimit buxhetor afatmesëm.

Mesatarisht, 908 qytetarë vendorë morën pjesë në takimet/dëgjesa publike për përgatitjen e buxhetit vendor në vitin 2018; janë organizuar, mesatarisht, 8 takime publike në nivel kombëtar për zbatimin e buxhetit (N=60).

79% e bashkive kanë përfshirë dokumentet e miratuara strategjike vendore në Programin Buxhetor Afatmesëm vendor (PBA) siç është Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), Plani Vendor i Mbrojtjes Sociale, Plani Vendor i Integritimit të Pakicave Kombëtare (Romët dhe Egjiptianët) dhe dokumente të tjera strategjike.

Grafiku 4


Buxheti lokal vjetor publikuar në faqen e internetit të bashkisë dhe www.financatvendore.al



Duhet të bëhet më shumë punë për edukimin qytetar dhe për mënyrën se si të angazhohen qytetarët për të bashkëvepruar më mirë dhe në mënyrë më efektive me njësitë e vetëqeverisjes vendore për të rritur mundësitë që zëri i tyre të dëgjohet.

Kjo mund të arrihet duke siguruar informacion se kur dhe pse ata kanë mundësi të ndikojnë në vendimet e qeverive. Forcimi i edukimit civil në moshë të re mund të ndihmojë në forcimin e angazhimit dhe të pjesëmarrjes në procesin e hartimit të politikave⁹.

Grafiku 5



2. KRITERET POLITIKE

Tabela 3

Rritja e transparencës së financave vendore


| Bashkitë | Buxheti vjetor vendor i bashkive i publikuar në faqen e internetit të bashkisë dhe në www.financatvendore.al | Numri i dëgjësave publike me qytetarët të organizuar nga bashkia gjatë periudhës së përgatitjes së buxhetit | Numri total i qytetarëve pjesëmarrës në dëgjesat publike mbi diskutimin e buxhetit | Numri i dëgjësave publike të organizuara mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve (ekzekutimi i buxhetit) | Numri i kategorive të grupeve vulnerabel të përfaqësuar nga OSHC-të në dëgjesat publike mbi planifikimin e buxhetit dhe monitorimin e tij |
|----------------|--|---|--|--|---|
| Belsh | Jo | 5 | 858 | 0 | Nuk ka të dhëna |
| Berat | Po | 9 | 100 | 9 | 5 |
| Bulqize | Po | 1 | 20,000 | 0 | 3 |
| Cerrik | Po | 14 | 1272 | 2 | 3 |
| Delvine | Po | 22 | 1500 | 2 | 0 |
| Devoll | Po | 45 | 2250 | 45 | 4 |
| Diber | Po | 1 | 125 | 1 | 2 |
| Divjake | Po | 5 | 700 | 5 | 5 |
| Dropull | Jo | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Durrës | Po | 10 | 395 | 1 | 5 |
| Elbasan | Po | 24 | 4456 | 3 | 7 |
| Fier | Po | 14 | 1390 | 11 | Nuk ka të dhëna |
| Finiq | Jo | 12 | 500 | 5 | 0 |
| Fushe Arrez | Po | 3 | 15 | 1 | 2 |
| Gjirokaster | Po | 9 | 30 | 4 | 1 |
| Gramsh | Po | 56 | 2072 | 56 | 2 |
| Has | Po | 2 | 22 | 1 | 2 |
| Himare | Po | 15 | 975 | 11 | 5 |
| Kamez | Po | 10 | 800 | 10 | 4 |
| Kavaje | Po | 3 | 85 | 3 | 2 |
| Kelcyre | Po | 3 | 37 | 1 | 2 |
| Klos | Po | 4 | 600 | 2 | 2 |
| Kolonje | Po | 4 | 30 | 2 | 2 |
| Konispol | Po | 11 | 500 | 6 | 0 |
| Korce | Po | 6 | 600 | 6 | 0 |
| Kruje | Po | 8 | 750 | 6 | 6 |
| Kucove | Po | 3 | 96 | 1 | 5 |
| Kukes | Po | 2 | 180 | 2 | 3 |
| Kurbin | Po | 4 | 250 | 3 | 0 |
| Lezhe | Po | 3 | 320 | 3 | Nuk ka të dhëna |
| Libohove | Jo | 2 | 0 | 2 | 0 |
| Librazhd | Po | 56 | 2500 | 56 | 4 |
| Lushnje | Po | 15 | 567 | 15 | 6 |
| Malesi e Madhe | Jo | 1 | 120 | 3 | 3 |
| Maliq | Po | 6 | 3000 | 7 | 70% |
| Mallakaster | Po | 4 | 600 | 4 | 3 |
| Mat | Po | 5 | 200 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Memaliaj | Po | 1 | 76 | 1 | 1 |
| Mirdite | Po | 7 | 930 | 7 | 4 |
| Patos | Po | 15 | 500 | 15 | 100 |
| Peqin | Po | 1 | 0 | 1 | Nuk ka të dhëna |
| Permet | Po | 4 | 34 | 1 | 2 |
| Pogradec | Po | 9 | 300 | 10 | 5 |
| Polican | Po | 2 | 35 | 1 | 3 |
| Prrenjas | Po | 9 | 635 | 9 | 0 |
| Puke | Po | 5 | 300 | 1 | 3 |
| Pustec | Po | 3 | 30 | 3 | 0 |
| Roskovec | Po | 16 | 110 | 16 | 0 |
| Rrogozhine | Po | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sarandë | Po | 7 | 300 | 3 | 5 |
| Selenice | Po | 6 | 200 | 6 | 5 |
| Shijak | Po | 1 | 40 | 1 | 5 |
| Shkoder | Po | 21 | 650 | 37 | 6 |
| Skrapar | Po | 3 | 650 | 3 | 2 |
| Tepelene | Po | 4 | 800 | 4 | Nuk ka të dhëna |
| Tirane | Po | 24 | 1,727 | 7 | 1,147 |
| Tropoje | Po | 10 | 74 | 2 | 3 |
| Ura Vajgurore | Po | 4 | 100 | 30 | 5 |
| Vau i Dejes | Po | 6 | 215 | 3 | 6 |
| Vlore | Po | 9 | 1500 | 6 | 5 |
| Vore | Po | 3 | 35 | 1 | 0 |

Objektivi specifik: qeverisja e hapur, llogaridhënia dhe qeverisja elektronike në nivel vendor

Digjitalizimi i shërbimeve publike ka qenë një nga objektivat e Qeverisë së Shqipërisë, gjë e cila ka pasur një ndikim pozitiv në shërbimet e shumta. Sistemi i integruar i TIK-ut (Qendrat e Integruara me një Ndalesë) është zhvilluar dhe është vënë në punë me mbështetjen e disa agjencive donatore në disa bashki për një sërë shërbimesh administrative. Ky sistem ka përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike dhe administrative (cilësia, shpejtësia dhe aksesin në

shërbime, infrastruktura fizike e përmirësuar dhe përmirësimi i efikasitetit të administratës vendore).

Qendrat e Integruara me një Ndalesë janë ngritur në rreth 49% të bashkive, të cilat kanë raportuar se në territoret e tyre është funksionale, të paktën, një zyrë e integruar me një ndalesë. Mesatarisht, 50 shërbime administrative ofrohen nëpërmjet Qendrave të Integruara me një Ndalesë. Bashkia e Tiranës ofron 262 shërbime, Bashkia Elbasan 100 shërbime, dhe Bashkia e Shkodrës 83 shërbime.




Ngritja e qendrave me një ndalesë në të gjitha bashkitë e tjera është në vazhdim (e planifikuar për vitin 2019).

Tabela 4

Ngritja e zyrave me një ndalesë për shërbime publike

| Bashkitë | Ka ngritur Bashkia zyra me një Ndalesë (OSSH)? | Numri i Njesive Administrative të Bashkisë që kanë funksionale Zyrë me Një Ndalesë (OSSH) në raport me numrin total të NJA të Bashkisë | Numri i shërbimeve të ofruara nga zyrat me një Ndalesë (nëse Bashkia ka OSSH) |
|----------------|--|--|---|
| Belsh | Po | 5/5 | 2 |
| Berat | Po | 5/5 | 65 |
| Bulqizë | Jo | 0 | 0 |
| Cerrik | Po | 5 | 30 |
| Delvine | Jo | 0 | 0 |
| Devoll | Po | 3 | 10 |
| Diber | Jo | 0 | 0 |
| Divjake | Jo | 0 | 0 |
| Dropull | Po | 1 | 28 |
| Durrës | Jo | 0 | 0 |
| Elbasan | Po | 18/18 | 100 |
| Fier | Po | 10/13 | 71 |
| Finiq | Jo | 0 | 0 |
| Fushë Arrez | Po | 0 | 0 |
| Gjirokastër | Jo | 0 | 0 |
| Gramsh | Jo | 0 | 0 |
| Has | Jo | 0 | 0 |
| Himare | Jo | 0 | 0 |
| Kamez | Po | 1 | 35 |
| Kavajë | Jo | 1 | 0 |
| Kelcyre | Jo | 3 | 0 |
| Klos | Po | 3/3 | 73 |
| Kolonjë | Jo | 1/7 | 0 |
| Konispol | Jo | 0 | 0 |
| Korçë | Po | 4 | 64 |
| Krujë | Po | 1/6 | 15 |
| Kuçovë | Jo | 0 | 0 |
| Kukës | Jo | 0 | 0 |
| Kurbin | Jo | 0 | 0 |
| Lezhë | Po | 5 | 71 |
| Libohovë | Po | 1 | 1 |
| Librazhd | Po | 1 | 5 |
| Lushnjë | Jo | 0 | 0 |
| Malesi e Madhe | Po | 1/5 | 4 |
| Maliq | Po | 1/6 | 60 |
| Mallakastër | Po | 1 | 15 |
| Mat | Po | 8 | 76 |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Mirditë | Jo | 0 | 0 |
| Patos | Jo | 0 | 0 |
| Peqin | Jo | 5 | 0 |
| Permet | Po | 1/5 | 34 |
| Pogradec | Po | 7/7 | 63 |
| Polican | Po | 1/3 | 79 |
| Prrenjas | Jo | 0 | 0 |
| Pukë | Jo | 0 | 0 |
| Pustec | Po | 0 | 20 |
| Roskovec | Jo | 0 | 0 |
| Rrogozhinë | Jo | 0 | 0 |
| Sarandë | Po | 0 | 55 |
| Selenice | Po | 5 | 5 |
| Shijak | Jo | 0 | 0 |
| Shkoder | Po | 16 | 83 |
| Skrapar | Jo | 0 | 0 |
| Tepelenë | Po | 1/4 | 60 |
| Tiranë | Po | 27 | 262 |
| Tropojë | Jo | 0 | 0 |
| Ura Vajgurore | Po | 4 | Nuk ka të dhëna |
| Vau i Dejës | Po | 50.00% | 75 |
| Vlorë | Po | 0 | 55 |
| Vorë | Jo | 0 | 0 |



Numri i aplikimeve të paraqitura nga qytetarët për të përfituar shërbime administrative është rritur (deri në dyfishin e numrit të aplikimeve për shërbime në disa bashki). 39% e bashkive, në të cilat janë ngritur qendrat me një ndalesë, bëjnë sondazhe për të mësuar se sa të kënaqur janë qytetarët me shërbimet. Të dhënat e sondazheve tregojnë se qytetarët janë të kënaqur me shpejtësinë e shërbimeve dhe profesionalizmin e stafit. Disa bashki kanë pranuar se nevojitet ende shumë punë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

Problemet dhe sfidat

- Ngritja e Qendrave të Integruara me një Ndalesën të gjitha bashkitë;
- Qendra e Integruar me një Ndalesë duhet të mbulojë të gjithë territorin e bashkisë duke përfshirë edhe zonat e largëta;
- Rritja e numrit të shërbimeve administrative/publike të administruara përmes Qendrave të Integruara me një Ndalesë.

Objektivi specifik: përmirësimi i llogaridhënies së qeverisjes vendore (2.3)

Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia janë të përfshira në Parimin 2 të Qeverisjes së Mirë¹⁰ në nivel vendor, që do të thotë se shërbimet publike realizohen dhe kërkesat dhe ankesat marrin përgjigje brenda një afati të arspohëm kohor dhe në Parimin 12: Llogaridhënia bazohet në tre koncepte kryesore:

- Të gjithë vendimmarrësit, kolegjalë dhe individualë, marrin përgjegjësinë për vendimet e tyre.

- Vendimet raportohen, shpjegohen dhe mund të ndëshkohen.
- Ekzistojnë mjete efikase kundër keqadministrimit dhe kundër veprimeve të autoriteteve vendore që shkelin të drejtat civile.

Sipas legjislacionit kombëtar, bashkitë shqiptare kanë përgjegjësinë që të ofrojnë shërbime publike dhe administrative në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera nënligjore.¹¹ Një individ ose grup qytetarësh ka të drejtë të ankohen për çështjet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e bashkisë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.¹²

Bashkitë duhet të zhvillojnë procedura dhe sisteme që janë në gjendje të regjistrojnë të dhënat dhe të monitorojnë informacionet në lidhje me ankesat e qytetarëve dhe trajtimin e ankesave të tyre në mënyrë të mjaftueshme. Strategjia Ndërsëktoriale Kombëtare e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore (SNKDQV) përcakton ngritjen e sistemit të menaxhimit të performancës për ankesat e qytetarëve. Ky informacion duhet të vihet në dispozicion të punonjësve, këshillit bashkiak (KB) dhe qytetarëve. Të dhënat duhet të mbahen jo vetëm për numrin e përgjigjeve që u jepen qytetarëve, por edhe për cilësinë e procesit dhe numrin e ankesave të qytetarëve, të cilat janë trajtuar plotësisht. Duhet më shumë trajnime për bashkitë në drejtim të kujdesit etik dhe të konsumatorëve në mënyrë që të ofrojnë shërbim të mirë për qytetarët.

Siç paraqitet në grafikun më poshtë, raporti i përgjigjeve të shërbimeve bashkiake ndaj kërkesave të qytetarëve në vitin 2018 ishte mesatarisht 82%. Shumica e bashkive, të cilat kanë paraqitur të dhënat, janë mbi nivelin mesatar, ndërsa niveli më i lartë i përgjigjeve (100%) raportohet nga 16 bashki.¹³ Niveli më i ulët i përgjigjeve raportohet nga bashkitë Sarandë (0%), Prrrenjas (20.53%), Kukës (14.13%) dhe Fier (5.77%).


10 Integrimi i 12 Parimeve të Qeverisjes së Mirë. Faqja e internetit: www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles-and-elope

11 Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

12 Ligji nr. 139/2015, Neni 19 - E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

13 Bashkitë: Bulqizë, Devoll, Dibër, Durrës, Gramsh, Kurbin, Librazhd, Lushnjë, Mallakastër, Patos, Pogradec, Roskovec, Rogozhinë, Shijak, Shkodër, Skrapar

Grafiku 8



Ndonëse përgjigjia ndaj ankesave të qytetarëve ose kërkesave të tyre për informacion është e rëndësishme, shkalla e trajtimit të ankesave dhe e zgjidhjes së problemeve të qytetarëve është thelbësore. Prandaj, është e

domosdoshme të ndërtohet një mekanizëm që regjistron ankesat që trajtohen nga administrata bashkiake në mënyrë të drejtë dhe efikase, së bashku me ndryshimin e kulturës së menaxhimit drejt “vendosjes së qytetarëve të parët”.

Grafiku 9



Transparenca e politikëbërjes është e nevojshme për të parandaluar dhe trajtuar rreziqet e kapjes së politikave¹⁴.

Të gjitha bashkitë kanë raportuar se vendimet e Këshillit Bashkiak janë publikuar në faqen e internetit të bashkisë. Raporti i publikimit të vendimeve të këshillit bashkiak luhatej nga 33% deri në 100% të numrit

të përgjithshëm (N=41). Norma e publikimit në internet është, mesatarisht, 56%. Rreth 32% e bashkive ose kanë paraqitur të dhëna të pasakta ose nuk kanë paraqitur fare të dhëna. Përveç publikimit të vendimeve në faqen e internetit, disa bashki sigurojnë transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të këshillit bashkiak (p.sh., Tirana, Shkodra).

2. KRITERET POLITIKE


Tabela 5

2.3 Komisioneri per Informimin dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale (IDP) (IDP)

| Përmirësimi i llogaridhënies së administratës vendore | | | |
|---|---|---|--|
| Bashkitë | Numri i përgjigjeve të dhëna për kërkesat e qytetarëve ndaj numrit të përgjithshëm të dorëzuar pranë bashkisë | Numri i akteve të vendimmarrësve vendor të publikuar në regjistrin elektronik së bashkisë, mbi numrin total të akteve të miratuar nga bashkia gjatë vitit të raportimit | Numri i raporteve mbi konstatimet/ rekomandimet nga Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit të cilat bashkia i ka refuzuar kundrejt numrit të përgjithshëm të raporteve të dorëzuara në bashki nga KMDDHP |
| Belsh | 405 | 0 | 0 |
| Berat | 78.70% | Po | 0 |
| Bulqize | 150/150 | 120/120 | 20 |
| Cerrik | 705/1230 | 118 | 0 |
| Delvine | 120 | 0 | 0 |
| Devoll | 16/16 | 0 | 0 |
| Dibër | 100% | 100% | 0 |
| Divjake | 400/720 | 106/106 | 0 |
| Dropull | 707/746 | 90/100 | 0 |
| Durrës | 8468/8468 | 91/91 | 0 |
| Elbasan | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Fier | 117/2027 | 1/126 | 0 |
| Finiq | 856/1020 | 40/122 | 0 |
| Fushe Arrez | 37 | 130 | 0 |
| Gjirokastrë | 80/150 | 91/128 | 0 |
| Gramsh | 81/81 | 101/101 | 0% |
| Has | 331/364 | 57/70 | 0/0 |
| Himare | 1158/1298 | 51/51 | 0 |
| Kamëz | 45 | 158 | 0 |
| Kavajë | 1135/1362 | 8 | 0 |
| Kelcyre | 260/340 | 0 | 0 |
| Klos | 220/355 | 124 | 0 |
| Kolonjë | 302/542 | 90/90 | 0/0 |
| Konispol | 603/659 | 40/122 | 0 |
| Korçë | 400/451 | 138 | 0 |
| Krujë | 330/350 | 351/1014 | 0 |
| Kuovë | 350/430 | 0 | 0 |
| Kukës | 31/217 | 76 | 3 |
| Kurbin | 37/37 | 66/66 | 0 |
| Lezhë | 41 | 1 | 2 |
| Libohovë | 260 | 0 | 0 |
| Librazhd | 1108/1108 | 133/136 | 0 |
| Lushnjë | 20/20 | 105 / 105 | 0 |
| Malesi e Madhe | 516 | 0 | 0 |
| Maliq | 0 | 0 | 0 |
| Mallakastër | 33/33 | 96/96 | 1 |
| Mat | 5100/5190 | 112/112 | 0 |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Mirditë | 112 | 333 | 0 |
| Patos | 14/14 | 83/83 | 0 |
| Peqin | 81.63% | 0 | 0 |
| Permet | 401/423 | 68/74 | 0/0 |
| Pogradec | 100.00% | 77/77 | 0 |
| Polican | 28/46 | 0 | 0 |
| Prrenjas | 340/1656 | 80/113 | 0 |
| Pukë | 250 | 0 | 0 |
| Pustec | 30 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Roskovec | 100% | 107 | 0 |
| Rrogozhinë | 100% | 0 | 0 |
| Sarandë | 0% | 75 | 0 |
| Selenice | 93,75% | Nuk ka të dhëna | 0 |
| Shijak | 100% | 0 | 0 |
| Shkodër | 110/110 | 82/82 | 1/3 |
| Skrapar | 50/50 | 45/45 | 0 |
| Tepelenë | 95% | Nuk ka të dhëna | 0 |
| Tiranë | 306/321 | 23/26 | 0 |
| Tropojë | 20 | 170 | 0 |
| Ura Vajguore | 1 | 90.91% | 100.00% |
| Vau i Dejës | 99.91% | Nuk ka të dhëna | 0 |
| Vlorë | 322 | Nuk ka të dhëna | 0 |
| Vorë | 1460 | 0 | 0 |

Të drejtat e njeriut respektohen, mbrohen dhe zbatohen ndërkohë që diskriminimi mbi çfarëdo baze luftohet në sferën e juridiksionit të vetëqeverisjes vendore. Diversiteti kulturor duhet të trajtohet si një pasuri dhe të gjithë pjesëtarët e komunitetit vendor kanë pjesë në të, identifikohen me të dhe nuk ndihen të përjashtuar¹⁵.

Ekziston një fakt pozitiv që numri i raporteve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që i janë paraqitur bashkive shqiptare është i kufizuar. Vetëm 5 bashki (nga 54 që japin informacione)¹⁶ kanë marrë raporte për rastet e diskriminimit të raportuara tek Komisioneri nga qytetarët.



15 Këshilli i Evropës, Zbatimi i 12 parimeve të qeverisjes së mirë

16 7 bashki (12%) e bashkive nuk kanë raportuar të dhëna në mënyrë korrekte për këtë tregues.

Problemet dhe sfidat

- Niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve vendorë në vendimmarrje është ende relativisht i ulët.
- Bashkitë kanë filluar të përdorin mediat sociale për të informuar qytetarët për dëgjesat publike, në veçanti, gjatë diskutimeve për buxhetin; megjithatë, ata duhet të përdorin zgjidhje më inovative që mund të zvogëlojnë koston e angazhimit të qytetarëve në jetën publike përmes prezantimit të informacionit miqësor për përdoruesit nëpërmjet rrjeteve sociale.
- Bashkitë nuk realizojnë një sondazhe vjetore mbi kënaqësinë e qytetarëve dhe reagimet e tyre ndaj çështjeve të qeverisjes vendore.
- Për shkak të burimeve të kufizuara financiare, bashkitë e kanë të vështirë të krijojnë një sistem të integruar të menaxhimit të informacionit për të ndjekur kërkesat e qytetarëve dhe ankesat e tyre për çështjet që lidhen me funksionet dhe shërbimet bashkiake,
- Programet e trajnimit dhe të rritjes së kapaciteteve të zyrtarëve vendorë në lidhje me ofrimin e shërbimeve, komunikimin dhe raportimin e ankesave janë ose të kufizuara ose nuk ekzistojnë.

2.1.2. Avokati i Popullit

Avokati i Popullit luan një rol vendimtar në drejtim të nxitjes së llogaridhënies nëpërmjet rolit mbikëqyrës dhe kontrollit të institucioneve publike duke përfshirë njësitë e vetëqeverisjes vendore në fusha të ndryshme të veprimtarisë dhe të kompetencave të tyre bazuar në kërkesat e qytetarëve, shoqatave ose Organizatave Jofitimprurëse të veçanta që përfaqësojnë qytetarët vendorë dhe interesat e tyre legjitime.

Objektivi specifik: përmirësimi i shqyrtimit të kapaciteteve të bashkive lidhur me raportet mbi vërejtjet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Ky objektivi vlerësohet nëpërmjet tre treguesve: (i) numri i raporteve me gjetjet dhe rekomandimet që Avokati i Popullit i ka paraqitur bashkive në vitin 2018; (ii) numri i raporteve të pranuar nga bashkitë; (iii) numri i raporteve me gjetje dhe rekomandime, të cilat janë refuzuar nga bashkitë ose janë ende në proces shqyrtimi.

Avokati i Popullit i ka paraqitur bashkive, në nivel kombëtar, një numër mesatar prej 11 rekomandimesh në vitin 2018 (N=21), që është numër më i lartë krahasuar me vitin 2017 (7 rekomandime); 35% e bashkive morën raporte me rekomandime, ndërsa 62% e bashkive nuk morën ndonjë raport nga Avokati i Popullit në vitin 2018; 3% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna për këtë tregues.





Tabela 6

3.1 Përmirësimi i shqyrtimit nga bashkia i raporteve të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit

| Bashkitë | Numri i raporteve dhe rekomandimeve nga Avokati i Popullit të paraqitura pranë Bashkisë Gjatë vitit të fundit | Numri i raporteve dhe rekomandimeve nga Avokati i Popullit të cilat Bashkia i ka pranuar dhe ka planifikuar masa për adresimin e tyre | Numri i raporteve dhe rekomandimeve nga Avokati i Popullit të cilat janë në proces shqyrtimi nga Bashkia sipas afatit kohor të përcaktuar me ligj |
|----------------|---|---|---|
| Belsh | 0 | 0 | 0 |
| Berat | 5 | 5 | 0 |
| Bulqize | 0 | 0 | 0 |
| Cerrik | 0 | 0 | 0 |
| Delvine | 0 | 0 | 0 |
| Devoll | 0 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Dibër | 0 | 0 | 0 |
| Divjake | 0 | 0 | 0 |
| Dropull | 0 | 0 | 0 |
| Durrës | 13 | 12 | 1 |
| Elbasan | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Fier | 38 | 30 | 8 |
| Finiq | 0 | 0 | 0 |
| Fushë Arrez | 0 | 0 | 0 |
| Gjirokaster | 7 | 7 | 0 |
| Gramsh | 0 | 0 | 0 |
| Has | 2 | 2/2 | 0 |
| Himare | 0 | 0 | 0 |
| Kamez | 0 | 0 | 0 |
| Kavajë | 0 | 0 | 0 |
| Kelcyre | 4 | 4 | 0 |
| Klos | 4 | 1 | 3 |
| Kolonjë | 4 | 4 | 0 |
| Konispol | 0 | 0 | 0 |
| Korçë | 0 | 0 | 0 |
| Krujë | 2 | 2 | 1 |
| Kuçovë | 0 | 0 | 0 |
| Kukës | 36 | 36/36 | 0 |
| Kurbin | 3 | 3/3 | 0 |
| Lezhë | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Libohovë | 0 | 0 | 0 |
| Librazhd | 4 | 0 | 0 |
| Lushnjë | 0 | 0 | 0 |
| Malesi e Madhe | 0 | 0 | 0 |
| Maliq | 0 | 0 | 0 |
| Mallakastër | 0 | 0 | 0 |
| Mat | 0 | 0 | 0 |
| Memaliaj | 0 | 0 | 0 |
| Mirditë | 0 | 0 | 0 |
| Patos | 17 | 16 | 1 |
| Peqin | 0 | 0 | 0 |
| Permet | 4 | 4/4 | 0 |
| Pogradec | 2 | 2 | 0 |
| Polican | 1 | 1 | 0 |
| Prrenjas | 0 | 0 | 0 |
| Pukë | 0 | 0 | 0 |
| Pustec | 0 | 0 | 0 |
| Roskovec | 5 | 5 | 0 |
| Rrogozhinë | 0 | 0 | 0 |
| Sarandë | 35 | 25 | 10 |
| Selenicë | 0 | 0 | 0 |
| Shijak | 0 | 0 | 0 |
| Shkoder | 0 | 0 | 0 |
| Skrapar | 0 | 0 | 0 |
| Tepelene | 1 | 1 | 0 |
| Tiranë | 21 | 21 | 0 |
| Tropojë | 0 | 0 | 0 |
| Ura Vajgurore | 0 | 0 | 0 |
| Vau i Dejes | 0 | 0 | 0 |
| Vlorë | 30 | 100,00% | 5 |
| Vorë | 0 | 1 | 0 |

21 bashki kanë raportuar se kanë marrë raporte nga Avokati i Popullit. Në vitin 2018 (N = 21) u trajtuan 10 gjetje dhe rekomandime të Avokatit të Popullit. Shtatë (7) bashki kanë raportuar se procesi i shqyrtimit



Grafiku 12

të rekomandimeve të Avokatit të Popullit ishte ende në vazhdim në fund të vitit 2018.

Siç tregohet në grafikun e mësipërm, bashkitë po i kushtojnë vëmendje trajtimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Problemet dhe sfidat

- Bashkitë duhet të angazhohen më aktivisht në shqyrtimin dhe trajtimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në konsultim të plotë me qytetarët e interesuar dhe shoqatat që i përfaqësojnë ata;
- Hartimi i udhëzimeve nga ana e bashkive për të lehtësuar procesin e shqyrtimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

- (ii) Promovimi i rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile në zbatimin e projekteve në territoret e bashkisë. Rreth 46% e bashkive kanë konfirmuar bashkëpunimin me Organizatat e Shoqërisë Civile në lidhje me çështje të ndryshme vendore


2.1.3. Shoqëria civile

Një shoqëri civile e fuqizuar përbën një komponent të rëndësishëm të çdo sistemi demokratik dhe duhet të njihet dhe trajtohet si i tillë nga institucionet shtetërore. Janë bërë disa përparime drejt përmirësimit të funksionimit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe nëpërmjet miratimit të Ligjit për Ndërmarrjet Sociale. Nevojiten përpjekje të mëdha për të siguruar konsultime kuptimplote me aktorët e shoqërisë civile si pjesë e dialogut gjithëpërfshirës të politikave.¹⁷

Objektivi specifik: forcimi i rolit të shoqërisë civile dhe rritja e bashkëpunimit në nivel vendor

Objektivi vlerësohet nëpërmjet pesë treguesve të performancës në dy nivele kryesore:

- (i) Angazhimi i Organizatave të Shoqërisë Civile në procesin e vendimmarrjes së pushtetit vendor;



Grafiku 13

kryesisht në lidhje me hartimin dhe rishikimin e politikave në nivel vendor dhe gjatë hartimit të planeve vendore, pjesëmarrjen në dëgjesa publike dhe konsultimet me grupet vulnerabil dhe etnike gjatë procesit të hartimit të buxhetit dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm. Janë dhënë rreth 252 rekomandime në nivel kombëtar për NJQV-të; janë dhënë, mesatarisht, 4 rekomandime nga Organizatat e Shoqërisë Civile për vendimmarrjen bashkiake në vitin 2018; bashkitë kanë shqyrtuar rreth 204 rekomandime të paraqitura (ose, mesatarisht 3).


Organizatave të Shoqërisë Civile dhanë një numër të përgjithshëm prej 259 rekomandimesh në 28 bashki (46%), të cilat raportuan se kanë marrë rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes. 208, ose 80% të këtij numri, janë shqyrtuar, ndërsa 151 (ose 73% e numrit të rekomandimeve të propozuara) janë marrë parasysh.

Tabela 7

4. Bashkepunimi me shoqerine civile

| Bashkitë | Numri i përgjithshëm i rekomandimeve/kërkesave të dhëna nga OSHC gjatë procesit të vendimmarrjes vendore dhe çështje të tjera mbi mirë qeverisjen vendore | Numri i përgjithshëm i rekomandimeve nga OSHC të marra në shqyrtim nga Bashkia gjatë procesit të vendimmarrjes vendore | Numri i përgjithshëm i rekomandimeve nga OSHC të pranuar nga bashkia gjatë procesit të vendimmarrjes vendore | Numri i granteve të dhëna nga Bashkia për projekte të përbashkëta në partneritet me OSHC | Vlera (në total në leke) i granteve të dhëna nga Bashkia për projekte në partneritet me OSHC |
|----------------|---|--|--|--|--|
| Belsh | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Berat | 6 | 6 | 6 | 0 | 0 |
| Bulqize | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Cerrik | 30 | 15 | 10 | Nuk ka të dhëna | 120,000 |
| Delvine | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Devoll | 13 | 13 | 8 | 2 | 4 300 000 |
| Diber | 4 | 4 | 3 | 3 | 8,296,000 |
| Divjake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dropull | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,185,687 |
| Durrës | 7 | 7 | 7 | 1 | 120700 |
| Elbasan | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | 4 | 1,700,000 |
| Fier | 15 | 4 | 11 | 0 | 0 |
| Finiq | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Fushë Arrez | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| Gjirokastrë | 15 | 15 | 10 | 0 | 0 |
| Gramsh | 24 | 24 | 18 | 0 | 0 |
| Has | 2 | 2/2 | 0 | 6 | 2,200,000 |
| Himare | 15 | 6 | 6 | 0 | 0 |
| Kamëz | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kavajë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kelcyre | 15 | 15 | 7 | 0 | 0 |
| Klos | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kolonjë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Konispol | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Korçë | 0 | 0 | 0 | 2 | 1.161.178 |
| Krujë | 18 | 18 | 10 | 2 | 800,000 |
| Kuçovë | 3 | 3 | 2 | 0 | 0 |
| Kukës | 0 | 0 | 0 | 1 | 648,000 |
| Kurbini | 2 | 1 | 1 | 3 | 40,156,218 |
| Lezhë | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | 1 | Nuk ka të dhëna |
| Libohovë | 2 | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Librazhd | 2 | 1 | 0 | 2 | 3,368,756 |
| Lushnjë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Malesi e Madhe | 3 | 3 | 3 | 0 | 0 |
| Maliq | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mallakastër | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mat | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Memaliaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mirditë | 3 | 3 | 2 | 0 | 0 |
| Patos | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Peqin | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Permet | 20 | 20 | 14 | 4 | 1,185,687 |
| Pogradec | 2 | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Polican | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Prrenjas | 0 | 0 | 0 | 3 | 892,416 |
| Pukë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pustec | 0 | 0 | Nuk ka të dhëna | 0 | Nuk ka të dhëna |
| Roskovec | 0 | 0 | 0 | 2 | 826.048 |
| Rrogozhinë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sharandë | 8 | 5 | 5 | 0 | 0 |
| Selenicë | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Shijak | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shkoder | 16 | 16 | 16 | 23 | 20,895,022 |
| Skrapar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Tepelene | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Tiranë | 3 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | 3 | 69.069.545 |
| Tropojë | 3 | 7 | 3 | 3 | 2,430.0 |
| Ura Vajgurore | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vau i Dejës | 3 | 10 | 3 | 0 | 0 |
| Vlorë | 12 | 100% | 67% | 2 | 0 |
| Vorë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Grafiku 14



29% e bashkive (N=60) kanë dhënë grante për Organizatat vendore të Shoqërisë Civile në partneritet me agjencitë e financuara nga donatorët për zbatimin e projekteve të ndryshme në mbështetje të angazhimit të rinjve në jetën publike dhe të punësimit, të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe për integrimin e grupeve vendore vulnerabël duke përfshirë pakicat etnike. Në total, 18 bashki kanë dhënë 67 grante ose, mesatarisht, 1 grant (N=60), gjë e cila përbën një kontribut të vogël;

69% e bashkive nuk kanë dhënë grante për Organizatat vendore të Shoqërisë Civile.

Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë qeverisjen vendore përdorin modele të ngjashme për financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) nga buxheti. Sfidat e përbashkëta lidhen me burime financiare të pamjaftueshme, mungesa e transparencës ose kritere të paqarta në proceset e përzgjedhjes dhe kapacitete të vogla të OSHC. Për adresimin e këtyre sfidave, Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), 2017-2021, me financim nga BE synon forcimin e partneritetit midis NJQV dhe shoqërisë civile nëpërmjet zbatimit dhe zgjerimit të një modeli të suksesshëm të financimit mbi baza projekti të OSHC. Në Shqipëri, 30 projekte janë zbatuar në 12 Bashki¹⁸ partnere nga OSHC, në fazën e parë për 2018-2019, dhe 40 projekte të tjera në fazën e dytë (Qershor 2019- Janar 2020). Projektet e përzgjedhura adresojnë prioritetet kryesore të dokumentave dhe politikave strategjike të cdo bashki partnere që synojnë ofrimin e shërbimeve

publike cilësore për qytetarët në sektore si te drejtat e njeriut, përfshirja sociale, punësimi i të rinjve, turizmi, mjedisi, dhe demokracia vendore.

Problemet dhe sfidat

- Mungesa e të dhënave për Organizatat e Shoqërisë Civile të regjistruara në territoret e bashkive.
- Kapacitete të ulëta të Organizatave vendore të Shoqërisë Civile në fushën e qeverisjes së mirë dhe të kompetencave e funksioneve të vetëqeverisjes vendore, duke përbërë, rrjedhimisht, një zë të dobët për të ndikuar në mënyrë efektive në vendimmarrjen në nivel vendor.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet shërbieme bashkiake dhe Organizatave vendore të Shoqërisë Civile për të përmirësuar vetëqeverisjen vendore në funksion të mirëqenies së të gjithë qytetarëve.
- Promovimi i Organizatave vendore të Shoqërisë Civile nga bashkitë përmes granteve për të zbatuar projekte me interes të përbashkët.

KONKLUZIONE MBI DEMOKRACINË

Vazhdojnë përpjekjet për të forcuar kapacitetet e administratës vendore, ndërkohë që menaxhimi i burimeve njerëzore dhe qëndrueshmëria financiare e trajnimit mbeten një sfidë. Sistemi i trajnimit të administratës vendore është përmirësuar përmes procesit të rishikimit të kurrikulave (91 kurrikula të rishikuara në vitin 2017-2018) bazuar në sistemin e sigurimit të cilësisë, përmirësimin e procedurave të certifikimit, ngritjen e bibliotekës elektronike dhe të platformës elektronike E-PAV për menaxhimin e burimeve njerëzore. ASPA trajnoi 764 zyrtarë publikë vendorë në vitin 2018 për Ligjin e Shërbimit Civil dhe rreth 1,008 zyrtarë vendorë në fusha të ndryshme tematike. Numri mesatar i zyrtarëve vendorë të trajnuar u rrit nga 14 në 18 persona për bashki në vitin 2018. Trajnimi për Kodin e Procedurave Administrative u ndoq nga 169 persona

ose, mesatarisht, 3 persona për çdo bashki; megjithatë, 28% e bashkive nuk kanë janë trajnuar. Alokimi i buxhetit vendor për trajnim mbetet shumë i ulët. Vetëm 52% e bashkive kanë dhënë disa fonde për të mbuluar koston e stafit për pjesëmarrje në trajnim (mesatarisht, 1.9% të buxhetit të bashkisë), ndërsa 48% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë dhënë buxhet për trajnime në vitin 2018 .

Është **bërë progres drejt përmbushjes së detyrimit** për qeverisje të hapur, llogaridhënie dhe qeverisje **elektronike** në nivel **vendor**. Programi qeveritar për shërbime elektronike në nivel vendor vazhdon. Është bërë progres në drejtim të ngritjes së Qendrave të Integruara me një Ndalesë, ku 49% të bashkive kanë ngritur Qendrat e Integruara me një Ndalesë, ose 20 bashki më shumë krahasuar me vitin 2017. Janë ofruar, mesatarisht, 50 shërbime administrative përmes Qendrave të Integruara me një Ndalesë. Ndonëse programi për ngritjen e Qendrave të Integruara me një Ndalesë në të gjitha bashkitë e tjera është planifikuar të përfundojë deri në vitin 2019, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të rritur numrin e shërbimeve administrative të ofruara përmes Qendrave të Integruara me një Ndalesë dhe për të rritur mbulimin territorial duke përfshirë të gjitha njësitë administrative dhe zonat e largëta.

Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për informacion apo i ankesave të tyre si pjesë e forcimit të llogaridhënies së pushtetit vendor është përmirësuar, ndërkohë që duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të garantuar që kërkesat e qytetarëve trajtohen sipas rregullave. Informacionet e dhëna nga bashkitë tregojnë se ato po i kushtojnë vëmendje trajtimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve. Mesatarisht, 82% e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve kanë marrë përgjigje në vitin 2018 nga shërbimet administrative të bashkisë së tyre. Kjo tregon një përqindje në rritje në krahasim me vitin 2017 (që ishte 75%). 15 bashki kanë dhënë përgjigje për të gjitha (100%) kërkesat/ankesat e qytetarëve. Megjithatë, nuk ekziston akoma një sistem i menaxhimit të performancës së qeverisjes

vendorë për të mundësuar një vlerësim më cilësor të përgjigjes së bashkive ndaj qytetarëve.

Është bërë **progres i mirë drejt rritjes së transparencës së qeverisjes vendore, ndërkohë që pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje dhe bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile mbetet në nivel të ulët**. Rreth 92% e bashkive shqiptare kanë hartuar buxhetin e tyre vendor në vitin 2018 bazuar në metodën me pjesëmarrje. Buxhetet publikohen në faqen e internetit të bashkive dhe në faqen e dedikuar të internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financatvendore.al Mesatarisht, 908 qytetarë kanë marrë pjesë në takime ose dëgjesa publike gjatë procesit përgatitor të buxhetit vendor. Janë organizuar, mesatarisht, 8 mbledhje publike për bashki. Bashkitë Gramsh, Librazhd dhe Devoll raportuan numrin më të madh të takimeve publike të organizuara (mbi 25 takime) ndërsa bashkitë Dropull dhe Rogozhinë raportuan se gjatë procesit të hartimit të buxhetit në vitin 2018 nuk kanë organizuar takime apo dëgjesa publike. Rreth 79% e bashkive kanë raportuar se kanë pasqyruar objektivat strategjike, të cilat janë të përcaktuara në dokumentet strategjike vendore dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), duke përfshirë Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), Planin Vendor të Mbrojtjes Sociale, Planin Vendor të Integritit të Pakicave Etnike (Romët dhe Egjiptianët), dhe dokumentet e tjera strategjike të miratuara nga këshilli bashkiak. Megjithatë, cilësia e Programit Buxhetor Afatmesëm mbetet problematike dhe orientimi i tij drejt prioriteteve strategjike mbetet për t'u testuar kur bashkitë do të zbatojnë buxhetin e ri bazuar në programe. Pothuajse të gjitha bashkitë kanë publikuar vendimet e këshillit bashkiak në faqen e tyre të internetit në vitin 2018. Numri i publikimeve në internet ishte, mesatarisht, 56%.

Vëmendje i kushtohet shqyrtimit dhe trajtimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve të Avokatit të Popullit. Vetëm 1 raport me rekomandime, mesatarisht, ka mbetur në proces shqyrtimi në vitin 2018 (mesatarisht, 10 nga

11 rekomandimet janë shqyrtuar nga shërbimet bashkiake). Rreth 62% e bashkive nuk kanë marrë ndonjë rekomandim nga Avokati i Popullit.

Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor mbetet një sfidë. Rreth 46% (më pak se gjysma) e bashkive kanë konfirmuar bashkëpunimin me Organizatat e Shoqërisë Civile për çështje të ndryshme vendore kërpoisht në lidhje me hartimin dhe shqyrtimin e politikave në nivel vendor dhe në aspektin e procesit të hartimit të buxhetit/Programit Buxhetor Afatmesëm. Kjo përqindje konfirmon edhe faktin se Organizatat e Shoqërisë Civile nuk janë krijuar në të gjithë Shqipërinë. Në veçanti, bashkitë e vogla nuk kanë prezencë të Organizatave të Shoqërisë Civile. Nga 252 rekomandime të dhëna nga Organizatat e Shoqërisë Civile në vitin 2018, 204 prej tyre (ose 93%) janë marrë parasysh nga këshillat bashkiakë dhe nga administrata vendore gjatë procesit të shqyrtimit. Ekziston nevoja për të ngritur një sistem që të regjistrohen rekomandimet e dhëna nga Organizatat e Shoqërisë Civile për proceset e ndryshme vendimmarrëse dhe numri i reko-

mandimeve që merren parasysh. Kapacitetet e Organizatave vendore të Shoqërisë Civile në fushën e qeverisjes së mirë dhe të kompetencave e funksioneve të vetëqeverisjes vendore mbeten ende të dobëta, prandaj Organizatat e Shoqërisë Civile mbeten një zë i dobët për të ndikuar në mënyrë efektive në vendimmarrjen në nivel vendor. Kapacitetet financiare të bashkive për të mbështetur aktivitetet e Organizatave të Shoqërisë Civile në fushat e tyre administrative mbeten shumë të kufizuara. Vetëm 18 bashki arritën të japin grante në vitin 2018. Numri i përgjithshëm i granteve ishte 67. Bashkia e Shkodrës raportoi dhënien e 23 granteve për Organizatat e Shoqërisë Civile, e ndjekur nga Bashkia e Hasit me 6 grante. 69% e bashkive nuk kanë dhënë grante për Organizatat vendore të Shoqërisë Civile. Rritja e bashkëpunimit në mes të administratës bashkiake dhe Organizatave vendore të Shoqërisë Civile është e rëndësishme për përmirësimin e vetëqeverisjes vendore një funksion të mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

2.2. SHETI I SË DREJTËS

2.2.1. Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit përbën një nga pesë prioritetet dhe rekomandimet kryesore të Bashkimit Evropian për të hapur negociatat e anëtarësimit me vendin tonë. Një nga masat për të trajtuar këtë prioritet është miratimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit Anti-Korrupsion 2018-2020¹⁹, ndërkohë që një nga masat e Planit të Veprimit është ngritja e rrjetit të koordinatorëve anti-korrupsion në nivel vendor. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) janë institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase.

Objektivi specifik: forcimi i regjimit të zbulimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe menaxhimit të konfliktit të interesit. (5.1)


Ky objektivi specifik vlerësohet përmes katër treguesve. Rreth 31% e bashkive deklaruan raste shkeljesh të procedurës administrative dhe të korrupsionit (N=60) në vitin 2018; 67% e bashkive nuk kanë pasur raste shkeljesh të procedurave administrative përfshirë prokurimin publik, ndërsa 2% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna për këtë tregues.

Sipas legjislacionit kombëtar, kryetari i bashkisë i nënshtrohet deklarimit të pasurisë tek ILDKPKI-ja. 95% e bashkive kanë raportuar se kryetari i bashkisë ka dorëzuar deklaratën e pasurisë sipas legjislacionit. 5% e bashkive kanë paraqitur të dhëna të pasakta ose nuk kanë paraqitur fare të dhëna.

Tabela 8

5.1. Përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsion

| Bashkitë | Numri i rasteve (ankimeve) për shkelje të procedurave administrative dhe korrupsioni (përfshire prokurimin publik) | Numri i nëpunësve të administratës vendore që kanë/nuk kanë deklaruar pasurinë, sipas mënyrës së kërkuar me ligj | Numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga nëpunësit vendorë dhe Këshilli Bashkiak gjatë marrjes së vendimeve. | Ngritja e një rrjeti të koordinuarë vendorë anti-korrupsion në bashki /pika kontakti |
|----------------|--|--|---|--|
| Belsh | 18 | 1 | 0 | Jo |
| Berat | 5 | 1 | 0 | Jo |
| Bulqize | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Cerrik | 0 | 1 | 0 | Po |
| Delvine | 0 | 1 | 0 | Po |
| Devoll | 10 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Diber | 8 | 1 | 0 | Po |
| Divjake | 4 | 1 | 32 | Po |
| Dropull | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Durrës | 0 | 1 | 0 | Po |
| Elbasan | 0 | 1 | 0 | Po |
| Fier | 0 | 1 | 0 | Po |
| Finiq | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Fushe Arrez | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Gjirokaster | 2 | 1 | 0 | Po |
| Gramsh | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Has | 2 | 1 | 0 | Po |
| Himare | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Kamez | 0 | 1 | 0 | Po |
| Kavaje | 0 | 1 | 0 | Po |
| Kelcyre | 3 | 1 | 0 | Jo |
| Klos | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Kolonje | 1 | 1 | 0 | Po |
| Konispol | 1 | 1 | 0 | Jo |
| Korçe | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Krujë | 0 | 1 | 0 | Po |
| Kucovë | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Kukës | 9 | 1 | 0 | Jo |
| Kurbin | 0 | 1 | 20 | Jo |
| Lezhë | Nuk ka të dhëna | 1 | 0 | Po |
| Libohovë | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Librazhd | 0 | 2 | 0 | Po |
| Lushnjë | 0 | 1 | 0 | Po |
| Malesi e Madhe | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Maliq | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Mallakaster | 0 | 1 | 0 | Po |
| Mat | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Memaliaj | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Mirditë | 15 | 1 | 0 | Po |
| Patos | 0 | 1 | 0 | Po |
| Peqin | 0 | 1 | 0 | Po |
| Permet | 7 | 1 | 0 | Po |
| Pogradec | 0 | 1 | 0 | Po |
| Polican | 0 | 1 | 0 | Po |
| Prrenjas | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Pukë | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Pustec | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Roskovec | 0 | 1 | 0 | Po |
| Rrogozhinë | 0 | 4 | 0 | Jo |
| Sarandë | 0 | 1 | 0 | Jo |
| Selenice | 1 | 1 | 0 | Po |
| Shijak | 2 | 1 | 0 | Po |
| Shkoder | 0 | 1 | 0 | Po |
| Skrapar | 4 | 1 | 0 | Po |
| Tepelene | 0 | 1 | 0 | Po |
| Tirane | 0 | 1 | 0 | Nuk ka të dhëna |
| Tropojë | 2 | 1 | 4 | Po |
| Ura Vajgurore | 0 | 1 | 0 | Po |
| Vau i Dejes | 5 | 1 | 0 | Jo |
| Vlorë | 0 | 1 | 0 | Po |
| Vorë | 1 | 1 | 100% | Jo |



Meqenëse vazhdojnë të zhvillohen rregullat dhe mekanizmat e monitorimit dhe Shtetet Anëtare të BE-së kanë dallime për sa i përket deklarimeve të pasurisë, nevoja për të ruajtur ekuilibrin e drejtë midis transparencës publike dhe të drejtës së zyrtarëve publikë për privatësi do të bëhet gjithnjë e më e spikatur²⁰.

- 90% e bashkive nuk kanë pasur raste të konfliktit të interesit (KI) në procesin e vendimmarrjes që përfshin anëtarët e këshillit bashkiak në vitin 2018; 10% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna të sakta;
- 4 bashki²¹ kanë pasur raste të deklarimeve të konfliktit të interesit që kanë pasur të bëjnë me anëtarët e Këshillit Bashkiak, ndërsa administrata vendore ka marrë masa për ta parandaluar konfliktin e interesit;
- 53% e bashkive kanë emëruar koordinatorin vendor kundër korrupsionit në vitin 2018; 44% e bashkive nuk e kanë emëruar ende koordinatorin vendor kundër korrupsionit; rreth 3% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna për këtë tregues.

Tabela 9

5.3. Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e Qeverisjes Vendore

| Bashkitë | Plan Integriteti per Bashkine i miratuar | Planifikimi në buxhet i fondit për të zbatuar politikën lokale antikorrupsion |
|----------------|--|---|
| Belsh | Po | Jo |
| Berat | Po | Jo |
| Bulqize | Jo | Jo |
| Cerrik | Jo | Jo |
| Delvine | Jo | Jo |
| Devoll | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Diber | Jo | Jo |
| Divjake | Jo | Jo |
| Dropull | Jo | Jo |
| Durres | Jo | Jo |
| Elbasan | Po | Jo |
| Fier | Nuk ka të dhëna | 0 |
| Finiq | Jo | Jo |
| Fushe Arrez | Jo | Jo |
| Gjirokaster | Jo | Jo |
| Gramsh | Jo | 0 |
| Has | Jo | Jo |
| Himare | Jo | 0 |
| Kamez | Jo | Jo |
| Kavaje | Jo | 2.70% |
| Kelcyre | Jo | Jo |
| Klos | Jo | 0 |
| Kolonje | Jo | Jo |
| Konispol | Jo | Jo |
| Korce | Ne process | Jo |
| Kruje | Po | 0 |
| Kucove | Jo | Jo |
| Kukes | Jo | Jo |
| Kurbin | Jo | 0 |
| Lezhe | Nuk ka të dhëna | Po |
| Libohove | Jo | Jo |
| Librazhd | Jo | Jo |
| Lushnje | Jo | Jo |
| Malesi e Madhe | Jo | Jo |
| Maliq | Jo | Jo |
| Mallakaster | Jo | Jo |
| Mat | Jo | Jo |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Mirdite | Jo | Jo |
| Patos | Jo | Jo |
| Peqin | Jo | Jo |
| Permet | Jo | Jo |
| Pogradec | Po | 0 |
| Polican | Po | Jo |
| Prrenjas | Jo | Jo |
| Puke | Jo | Jo |
| Pustec | Jo | Jo |
| Roskovec | Jo | Jo |
| Rrogozhine | Jo | Jo |
| Sarande | Jo | Jo |
| Selenice | Jo | Jo |
| Shijak | Jo | Jo |
| Shkoder | Po | Po |
| Skrapar | Po | Jo |
| Tepelene | Jo | Jo |
| Tirane | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Tropoje | Jo | Po |
| Ura Vajgurore | Po | Jo |
| Vau i Dejes | Jo | 0 |
| Vlore | Jo | Jo |
| Vore | Jo | 0% |

20 OECD, 2017 - Përfaqimi i ndryshimeve të vazhdueshme në qeveri, pika 3.2 "Transparenca në politikbërje".

21 Tropoja, Divjaka, Vora dhe Kurbin.


5.2 Objektiv i specifik: ngritja e kapaciteteve të administratës së qeverisjes vendore për të luftuar korrupsionin

Ky objektiv specifik vlerësohet me anë të tre treguesve: (i) numri i trajnimeve për luftën kundër korrupsionit; (ii) niveli i përditësimit të regjistrit elektronik të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve sipas afateve ligjore; (iii) ngritja e një mekanizmi monitorues dhe vlerësues (M & V) për ofrimin e shërbimeve publike dhe ndihmën ekonomike në nivel vendor (në bashki).

- Mesatarisht, 47% e bashkive kanë marrë pjesë në 2 (dy) trajnime për luftën kundër korrupsionit (N=57) - kjo tregon përmirësim krahasuar me vitin 2017 (1 trajnim), ku janë trajnuar gjithsej 61 persona; 53% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim në vitin 2018;
- Rreth 6% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna për këtë tregues.

Grafiku 16

Numri i trajnimeve mbi luftën kundër korrupsionit në të cilën bashkia ka marrë pjesë




Sipas legjislacionit²² bashkitë janë përgjegjëse për përditësimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve çdo 3 muaj. Informacioni duhet të publikohet në faqen e internetit të bashkisë, si dhe të afishohen në një vend publik në bashki. Regjistri nuk përfshin identitetin e personit që bën kërkesë për informacion.

- 57% e bashkive kanë përditësuar rregullisht regjistrin elektronik të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve sipas afateve ligjore; bashkitë e tjera ose kanë paraqitur të dhëna të pasakta ose nuk kanë paraqitur fare të dhëna.
- 45% e bashkive (N=55) kanë krijuar në vitin 2018 mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit M&V të cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike në fushën e kompetencave të bashkisë në përgjithësi dhe të dhënies së ndihmës ekonomike; 10% e bashkive nuk kanë paraqitur të dhëna për këtë tregues.

5.3 Objektivi specifik: miratimi i politikave anti-korrupsion në nivel vendor

Ky objektivi specifik do të vlerësohet me anë të dy treguesve të performancës. Sipas Planit të Veprimit Anti-Korrupsion 2018-2020,²³ bashkitë duhet të hartojnë dhe miratojnë Planin e Integritetit, qëllimi i të cilit është parandalimi i korrupsionit gjatë ofrimit të shërbimeve publike nga ana e tyre (në nivel vendor). Për këtë qëllim, bashkitë do të ndihmohen nga Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Korrupsionit dhe Ministria e Punëve të Brendshme, duke ndjekur udhëzimet e Ministrisë së Drejtësisë.



- Vetëm 15% e bashkive kanë miratuar Planin vendor të Integritetit sipas Planit të Veprimit Anti-Korrupsion 2018-2020; 2% e bashkive e kishin Planin e Integritetit në procesin e hartimit; rreth 8% e bashkive kanë paraqitur të dhëna të pasakta ose nuk kanë paraqitur fare të dhëna në lidhje me këtë tregues.

Edhe në rastet kur bashkia ka miratuar Planin e saj Vendor të Integritetit në lidhje me luftën kundër korrupsionit, ai nuk zbatohet në mënyrë efektive nëse nuk është pjesë e planifikimit buxhetor të bashkisë.

²² Ligji nr. 199/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 8 "Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve". Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton standardet në lidhje me formatin dhe përmbajtjen e regjistrit.

Tabela 10

5.2. Forcimi i kapaciteteve të administratës së qeverisë vendore në luftën kundër korrupsionit

| Bashkitë | Numri i trajnimeve nga KKK mbi luftën kundër korrupsionit në të cilën bashkia ka marrë pjesë | Shkalla e përditësimit të rregjistrit elektronik të bashkisë të kërkesave dhe ankesave sipas afateve të përcaktuara në legjislacion. | Ngritja e një mekanizmi i M&V të ofrimit të shërbimeve publike dhe ndihmës ekonomike në bashki |
|----------------|--|--|--|
| Belsh | 0 | 0 | Jo |
| Berat | 3 | Po | Po |
| Bulqize | 0 | Jo | Jo |
| Cerrik | 2 | Periodike | Po |
| Delvine | 0 | Jo | Jo |
| Devoll | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Diber | 2 | Po | Po |
| Divjake | Nuk ka të dhëna | 0 | Jo |
| Dropull | 0 | 0 | Jo |
| Durrës | 0 | 4 | Jo |
| Elbasan | 7 | 0 | Po |
| Fier | 6 | 50 | Nuk ka të dhëna |
| Finiq | 0 | Periodike | Po |
| Fushe Arrez | 1 | 0 | Po |
| Gjirokaster | 0 | Po | Jo |
| Gramsh | 0 | 4 | Jo |
| Has | 2 | Monthly | Po |
| Himare | 0 | Always | Po |
| Kamez | 1 | 100% | Po |
| Kavaje | 0 | 0 | Po |
| Kelcyre | 2 | 0 | Po |
| Klos | 0 | 0 | Po |
| Kolonje | 4 | Monthly | Po |
| Konispol | 0 | Po | Po |
| Korçë | 1 | Daily | Jo |
| Krujë | 2 | 1 | Nuk ka të dhëna |
| Kuçovë | 0 | Jo | Jo |
| Kukës | 0 | 4 | Po |
| Kurbín | 0 | Jo | Jo |
| Lezhë | Nuk ka të dhëna | Po | Nuk ka të dhëna |
| Libohovë | 2 | 0 | Jo |
| Librazhd | 0 | 30% | Jo |
| Lushnjë | 0 | 0 | Jo |
| Malesi e Madhe | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Jo |
| Maliq | 0 | 4 | Jo |
| Mallakaster | 1 | Jo | Jo |
| Mat | 1 | Po | Jo |
| Memaliaj | 3 | 0 | Po |
| Mirditë | 2 | Po | Jo |
| Patos | 0 | Jo | Jo |
| Peqin | 2 | Po | Po |
| Permet | 4 | Monthly | Po |
| Pogradec | 0 | 3 | Po |
| Polican | 1 | Jo | Po |
| Prrenjas | 1 | 4 | Jo |
| Pukë | 0 | 0 | Jo |
| Pustec | 0 | Periodike | Jo |
| Roskovec | 0 | 100% | Jo |
| Rrogozhinë | 1 | 0% | Jo |
| Sarandë | 0 | 75% | Jo |
| Selenice | 1 | 100% | Po |
| Shijak | 0 | 0% | Jo |
| Shkoder | 3 | Periodike | Po |
| Skrapar | 0 | Po | Jo |
| Tepelene | 1 | 4 | Nuk ka të dhëna |
| Tiranë | 0 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Tropojë | 0 | Periodike | Jo |
| Ura Vajgurore | 0 | 12 | Po |
| Vau i Dejës | 0 | Po | Po |
| Vlorë | 2 | Nuk ka të dhëna | Po |
| Vorë | 3 | 0 | Jo |

4 nga 9 bashkitë, të cilat kanë miratuar Planin e Integritetit lidhur me luftën kundër korrupsionit, kishin bërë në 2018 një alokim të veçantë buxhetor për zbatimin e tij.

Problemet dhe sfidat

- Përpjekje të kufizuara koordinuese nga ana e institucioneve qendrore për të mbështetur bashkitë gjatë hartimit të Planit të tyre të Integritetit për luftën kundër korrupsionit në funksion të Planit Kombëtar të Veprimit kundër Korrupsionit 2018-2020.
- Kapacitete të kufizuara teknike dhe njerëzore të bashkive në drejtim të miratimit të politikave vendore që kanë lidhje me politikën e Qeverisë së Shqipërisë dhe në drejtim të miratimit të instrumenteve në luftën kundër korrupsionit.
- Burime financiare të kufizuara vendore për zbatimin e Planit vendor të Integritetit.
- Mungesa e trajnimit të mjaftueshëm të zyrtarëve vendorë në luftën kundër korrupsionit. Trajnimi i zyrtarëve e tjerë vendorë nuk është efikas nëse ata nuk janë emëruar zyrtarisht nga bashkia si koordinatorë vendorë kundër korrupsionit,

KONKLUZIONE MBI SHETIN E SË DREJTËS

Zbatimi i rregullave të deklarimit të pasurive dhe të kontrollit të konfliktit të interesit po tregon progres. 58 nga 61 kryetarët e bash-

kive kanë dorëzuar në vitin 2018 deklaratën e pasurive sipas legjislacionit. Kjo tregon përmirësim krahasuar me vitin 2017 ku deklaratat e pasurive u dorëzuan nga 87% ose 53 kryetarë bashkish. Rreth 31% e bashkive deklaruan raste të shkeljeve të procedurave administrative përfshirë prokurimin publik. Administrata vendore mori masa për të zbutur rreziqet dhe i trajtoi ato sipas rregullave. Rreth 90% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë pasur raste të konfliktit të interesit në procesin e vendimmarrjes. Vetëm bashkitë e Divjakës, Tropojës dhe të Kurbinit kanë raportuar për rastet ku është identifikuar konflikti i interesit. Rrjeti i koordinatorëve vendor kundër korrupsionit është ngritur në 53% të bashkive, duke bërë kështu progres krahasuar me 36% në vitin 2017.

Masat për të ngritur mekanizma sistematik anti-korrupsion mbetet një çështje shqetësuese. Vetëm 15% e bashkive kanë miratuar Planin Vendor të Integritetit sipas Planit të Veprimit Anti-Korrupsion 2018-2020, ndërsa Plani i Integritetit ishte në procesin e hartimit në dy (2) bashki. Rreth 8% e bashkive kanë paraqitur të dhëna të pasakta ose nuk kanë paraqitur fare të dhëna për këtë tregues. Vetëm 44% e bashkive, të cilat kanë miratuar Planin e Integritetit, kanë bërë një alokim të veçantë buxhetor për zbatimin e tij në vitin 2018. Mesatarisht, 47% e bashkive kanë marrë pjesë në 2 (dy) trajnime lidhur me luftën kundër korrupsionit, ndërsa 53 % e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim në vitin 2018.



2.3. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E PAKICAVE

Objektivi specifik: ngritja e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Shqipëria ka bërë përpjekje dhe është e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të të drejtave të njeriut. Kuadri ligjor kombëtar garanton respektimin e të drejtave të pakicave. Ai është në përputhje me konventat ndërkombëtare, ligjet dhe standardet.

Dokumenti kryesor është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligje të tjera të rëndësishme.²⁴ Ligji nr. 10221 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe Ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare” janë dy aktet kryesore ligjore të miratuara nga Parlamenti. Shqipëria është anëtare e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale dhe ka ratifikuar një numër konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duke përfshirë Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës.


24 Ligji (8454/1999) “Për Avokatin e Popullit”, Ligji (9887/2008) “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligji (9970/2008) “Për barazinë gjinore”, Kodi zgjedhor (2008), Ligji (10039/2008) “Për ndihmën juridike”, Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (2010), Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet”, i ndryshuar (Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 726/12, datë 2018), Plani Kombëtar për Stabilizimin dhe Asociimin, i ndryshuar, Ligji nr. 96/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e pakicave etnike”, PKVIRE 2016-2020, Ligji nr. 22/2018) “Për strehimin social”.

Tabela 11

6.1. Forcimi i kapacitetit të pushtetit vendor për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

| Bashkitë | Numri i trajnimeve nga autoritetet qendrore / OSHC-të mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut | Numri i nëpunësve të administratës vendore të trajnuar mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut | Numri i OSHC të licencuara që trajtojnë rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Bashkinë | Numri i rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut të referuara | Numri i rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut të trajtuar nga grupet ndërinstitucionale/Bashkia |
|----------------|--|---|--|--|---|
| Belsh | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Berat | 3 | 10 | 2 | 2 | 2 |
| Bulqize | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Cerrik | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Delvine | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| Devoll | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Diber | Nuk ka të dhëna | 5 | 2 | 0 | 0 |
| Divjake | 0 | 1 | 0 | 2 | 0 |
| Dropull | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Durres | 0 | 0 | 3 | 78 | 78 |
| Elbasan | 5 | 150 | 3 | 61 | 61 |
| Fier | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| Finiq | 0 | 0 | 0 | 17 | 17 |
| Fushe Arrez | 8 | 2 | 2 | 0 | 0 |
| Gjirokaster | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gramsh | 0 | 0 | 2 | 35 | 35 |
| Has | 3 | 8 | 0 | 4 | 5 |
| Himare | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Kamez | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kavcje | 4 | 4 | 1 | 1 | 1 |
| Kelcyre | 3 | 12 | 0 | 0 | 0 |
| Klos | 0 | 1 | 0 | 4 | 4 |
| Kolonje | 6 | 10 | 0 | 11 | 5 |
| Konispol | 0 | 0 | 0 | 0 | 13 |
| Korce | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kruje | 2 | 2 | 1 | 1 | 1 |
| Kucove | 0 | 0 | 9 | 24 | 24 |
| Kukes | 5 | 6 | 0 | 0 | 0 |
| Kurbin | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| Lezhe | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Libohove | 3 | 4 | 0 | 0 | 0 |
| Librazhd | 1 | 3 | 3 | 0 | 1 |
| Lushnje | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Malesi e Madhe | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Maliq | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mallakaster | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mat | 0 | 0 | 0 | 16 | 0 |
| Memaliaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mirdite | 3 | 12 | 2 | 2 | 2 |
| Patos | 0 | 1 | 0 | 0 | 12 |
| Peqin | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| Permet | 6 | 12 | 0 | 6 | 6 |
| Pogradec | 4 | 4 | Nuk ka të dhëna | 0 | 0 |
| Polican | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| Prrenjas | 0 | 0 | 1 | 25 | 10 |
| Puke | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pustec | 0 | 0 | 0 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Raskovec | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Rrogozhine | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sarande | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Selenice | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shijak | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shkoder | 20 | 18 | 23 | 18 | 20 |
| Skrapar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Tepelene | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| Tirane | 2 | 3 | 24 | 2 | 2 |
| Tropoje | 3 | 1 | 1 | 0 | 0 |
| Ura Vajgurore | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Vau i Dejes | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vlore | 6 | 4 | 1 | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Vore | 0 | 0 | 0 | 9 | 1 |

nënshkruar një marrëveshje, por edhe me Organizatat e Shoqërisë Civile tjera, me të cilat nuk është nënshkruar domosdoshmërisht ndonjë marrëveshje bashkëpunimi.




Një numër bashkish kanë raportuar se kanë marrë mbështetje të mirë nga UNDP, UNICEF, Save the Children, World Vision, etj., kur kanë pasur të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe me komunitetin Rom.

Pranë shërbimeve bashkiake janë raportuar në vitin 2018 në total, 318 raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ndërsa 95% e këtyre rasteve janë trajtuar sipas protokolleve nga grupi ndërinstitucional i krpouar nga shërbimet bashkiake. Shumica e rasteve të raportuara janë ato që lidhen me dhunën në familje, dhunën kundër fëmijëve. Bashkia e Fiqit raportoi për rastet e dhunës në lidhje me të drejtat e pronësisë, ndërsa Bashkia e Tiranës është më e shqetësuar në lidhje me trajtimin e komunitetit Rom duke specifikuar kushtet e jetesës dhe traditat e këtij komuniteti. Është

krijuar bashkëpunim mes Bashkisë së Tiranës dhe Këshillit të Evropës për të diskutuar mbi standardet evropiane për të drejtat e njeriut.

Problemet dhe sfidat

- Mungesa e vetëdijesimit për të drejtat e njeriut në shoqëri dhe në administratën vendore.
- Shumë pak Organizata vendore të Shoqërisë Civile të specializuara.
- Mungesa e traditës së shërbimeve bashkiake për të kërkuar mbështetjen e Organizatave të Shoqërisë Civile gjatë trajtimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.
- Kapacitetet e kufizuara profesionale të sektorit të të drejtave të njeriut në administratën vendore, të shoqëruara me vështirësi për të marrë pjesë në trajnime të organizuara jashtë bashkisë për shkak të largësisë në rastin e bashkive të largëta dhe mungesës së fondeve për mbulimin e shpenzimeve.
- Vështirësitë për të identifikuar rastet e shkeljeve për shkak të ngurrimit të qytetarëve për t'i raportuar ato në bashki ose zyra të tjera.
- Krijimi i një mjedisi të sigurt për identifikimin, raportimin dhe ndjekjen e rasteve deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre;
- Struktura efikase dhe efektive që merren me eliminimin e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe me bashkëpunimin ndërinstitucional kur trajtohen shkelje të të drejtave të njeriut.



- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe qëndrueshmëria e strukturave bashkiake kur merren me shërbimet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- Vështirësia e integritit dhe qëndrueshmërisë së komunitetit Rom në tregun e punës, krijimi i vendbanimeve të sigurt dhe të qëndrueshme dhe integrimi i tyre në skemat e strehimit social, për shkak të traditave të tyre të jetesës dhe shpeshësisë së lartë të lëvizshmërisë nëpër vendndodhje të ndryshme.

KONKLUZIONE MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Janë bërë disa përpjekje për të rritur kapacitetet e qeverisjes vendore në drejtim të zbatimit të standardeve të të drejtave të njeriut, ndërkohë që duhet bërë më shumë për të trajnuar administratën vendore dhe për të rritur vetëdijësimin e administratës vendore dhe të komunitetit për të drejtat e njeriut. Në vitin 2018, ASPA dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve organizuan disa trajnime për zyrtarët publikë vendorë mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Janë ofruar, mesatarisht, 4 trajnime për 22 bashki (ose 39% të bashkive); 61% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim mbi standardet e të drejtave të njeriut. Duhet bërë më shumë për të informuar bashkitë për organizatat dhe trajnimet e mundshme për standardet evropiane të të drejtave të njeriut, si dhe për rritjen e kapaciteteve të administratës bashkiake që merren me çështjet e të drejtave të njeriut. Rritja e

efikasitetit të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional është i domosdoshëm për të trajtuar në kohë çështjet e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Është raportuar një bashkëpunim i mirë me **Organizatave e Shoqërisë Civile, por një vetëm një numër i vogël i Organizatave vendore të Shoqërisë Civile janë aktive, ndërsa** në bashkitë e vogla **nuk ekziston asnjë Organizatë e Shoqërisë Civile.** Rreth 31% e bashkive kanë raportuar se kanë krijuar bashkëpunim të mirë me Organizatat vendore të Shoqërisë Civile gjatë shqyrtimit dhe trajtimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut në vitin 2018. Grupi ndërinstitucional i krpoor nga shërbimet bashkiake ka trajtuar sipas protokolleve rreth 95% nga 319 rastet e identifikuar/referuara të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Bashkitë raportuan se numri i Organizatave të Shoqërisë Civile të specializuara për trajtimin e të drejtave të njeriut është i kufizuar. Ekziston edhe mungesa e të kuptuarit të sjelljes tradicionale që kërkon mbështetjen e Organizatave të Shoqërisë Civile kur merren me trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Rritja e vetëdijësimit dhe krijimi i një mjedisi të sigurtë në bashki me qëllim që të inkurajojë qytetarët që të raportojnë rastet e shkeljeve, ndërkohë që rastet që përfshijnë dhunën në familje dhe shkeljet e të drejtave të fëmijëve, në veçanti, duhet të marrin vëmendje të madhe dhe të jenë në qendër të bashkëpunimit në mes të bashkive dhe veprimtarisë së Organizatave të Shoqërisë Civile në të ardhmen.



3. KRITERET EKONOMIKE

Ekonomi tregu funksionale dhe aftësia për të trajtuar konkurrencën e BE-së dhe forcat e tregut

3.1. EKZISTENCA E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

Objektivi specifik: përmirësimi i mjedisit të biznesit

Përmirësimi i klimës së biznesit, thjeshtimi i rregullave dhe rregulloreve, inkurajimi i kulturës sipërmarrëse në të gjitha nivelet, përmirësimi i kreditimit financiar ndaj NVM-ve dhe i bizneseve të reja fillestare (start-ups) dhe e biznesit të bazuar në inovacion janë disa nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Biznesin dhe Investimet 2014- 2020 në Shqipëri dhe përbëjnë prioritet për procesin e integritimit në BE.


Shqipëria ka bërë njëfarë progresi dhe është e përgatitur në mënyrë të moderuar në lidhje me zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Rregulloret lidhur me biznesin mbetën të komplikuar dhe mangësitë e sundimit të ligjit kanë vazhduar të pengojnë bizneset dhe të pengojnë investimet. Përmirësimi i mjedisit të biznesit kërkon përpjekje të mëtejshme.

Zhvillimi ekonomik është një nga funksionet kryesore të vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Objektivi specifik i kësaj fushe funksionale vlerësohet me anë të 5 treguesve të performancës. 67% e bashkive kanë hartuar, të paktën, një Plan Strategjik të Zhvillimit Ven-



dor (PSZHV), i cili është miratuar nga këshilli bashkiak (N=58); 1 bashki e kishte planin strategjik në procesin e hartimit ndërkohë që 26% e bashkive nuk kanë ende plan të tillë strategjik në nivel vendor.

Disa bashki kanë miratuar më shumë se një plan zhvillimi vendor përfshirë Planin e Mbrojtjes Sociale, Planin Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane.



Për shkak të vonësave të akumuluar nga vitet e mëparshme dhe burimeve të kufizuara vendore, vetëm 56% e bashkive kanë ofruar shërbime mbështetëse për zhvillimin e NVM-

Kutia më poshtë paraqet disa praktika të mira të identifikuar në vitin 2018.

KUTIA 3: PRAKTIKAT E MIRA TË MBËSHTETJES SË BASHKIVE PËR ZHVILLIMIN E NVM-VE

Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë 10 iniciativa për promovimin e zhvillimit të NVM-ve dhe bizneseve të reja fillestare (start-ups) në zonën e Tiranës në bashkëpunim me GIZ në vitin 2018, duke përfshirë trajnimin e 150 personave të rinj dhe të rritur. Aktivitete të tjera u koordinuan me institucionet shtetërore dhe subjektet e biznesit në ekosistemin e biznesit të Tiranës; u përdorën 4 (katër) skema grantesh në mbështetje të 67 sipërmarrësve ndërkohë që 25 hapësira tregtare u janë vënë në dispozicion bizneseve lokale për t'i marrë ato me qira.

Bashkia e Fierit ofron shërbime të ndërmjetësimit me sistemet bankare gjatë aplikimeve të NVM-ve për kredi.

Bashkia e Dibrës ka ofruar trajnime për NVM-të dhe ka trajnuar 15 udhëzues turistikë në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile.

Bashkia e Dibrës dhe **Bashkia e Roskovecit** kanë dhënë grante të vogla për zhvillimin e NVM-ve: përkrahja në Dibër u është dhënë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që punojnë në fushën e turizmit bujqësor, ndërsa përkrahja në Roskovec është dhënë për 10 NVM të drejtuara nga gratë.

Shuma e grantit shkon deri në 100.000 lekë.

Bashkia e Beratit ka ngritur Këshillin Ekonomik si një organ konsultativ me pjesëmarrjen e 11 operatorëve ekonomikë.

Bashkia e Gramshit ka nxitur pjesëmarrjen e NVM-ve në Projektin IPA CBC "STEP", i cili ka dhënë mbështetje për operatorët turistikë në zonën e Gramshit për të hapur llogaritë e tyre në Trip Advisor dhe për të promovuar aktivitetet e tyre në rrejet rajonale, përveç lehtësimit të pjesëmarrjes së NVM-ve në festivalin "Natyra Fest 2018".

Bashkia e Himarës dhe **Bashkia e Pogradecit** kanë përdorur skema me tarifa të diferencuara për bizneset, fermerët ose bizneset që veprojnë në sektorët e prodhimit (deri në 50% të tatimit mbi ndërtesat).

Bashkia e Kavajës ka dhënë mbështetje për bizneset e vogla duke u ofruar atyre objekte të lira për qira si dhe shërbime udhëzuese e këshilluese.

Bashkia e Korçës ka ofruar objekte për bizneset në zonën e "Pazarit të Vjetër";

ve në bashkitë e tyre në vitin 2018. Rreth 33% e bashkive nuk kanë ofruar shërbime të veçanta për zhvillimin e NVM-ve (N = 54). 7 (shtatë) bashki (ose 11%) nuk kanë paraqitur asnjë informacion apo të dhënë për këtë tregues.

43 bashki (ose 70%) raportuan për NVM-të e reja të ngritura në territoret e tyre (N = 58), që ishin gjithsej 8,245 në vitin 2018 (ose, mesatarisht, 142); 24% e bashkive kanë raportuar se nuk janë krijuar NVM të reja gjatë periudhës raportuese. Një nga problemet e identifikuar në raporte është mungesa e një sistemi për mbajtjen e të dhënave (regjistër) të NVM-ve.

Informacioni mbi këtë tregues është shumë i paqartë në shumicën e bashkive. Kjo tregon se ka mungesë vizioni lidhur me mënyrën se si mund të mbështeten NVM-të, sepse ose duhet të forcohet bashkëpunimi me to, ose departamentet përkatëse nuk kanë përgjegjësi për

të paraqitur të dhëna të mjaftueshme.

Ekzistojnë tre masa mbështetëse për NVM-të që raportohen kryesisht si masa për të mbështetur zhvillimin e NVM-ve: (i) organizimi i panairëve vendore; (ii) krijimi i mjediseve për biznesin (tregjet e hapura); dhe (iii) masat fiskale në formën e uljes së taksave. Përveç kësaj, disa bashki po bashkëpunojnë me Organizatat e Shoqërisë Civile për të trajnuar bizneset, në veçanti, ato biznese që operojnë në turizëm dhe shërbime të hotelierisë. Dhënia e granteve të vogla për të mbështetur NVM-të e reja ose bizneset e reja fillestare (start-ups) zbatohet në një numër shumë të vogël bashkish.

Problemet dhe sfidat

- Burime të kufizuara financiare bashkiake për të mbështetur subjektet e reja të biznesit nëpërmjet skemave të granteve konkurruese që mund të nxisin ngritjen e subjekteve të reja

- të biznesit dhe ndërmarrjeve të inovacionit.
- Pak bashki kanë dhënë stimuj për mbështetjen e subjekteve të reja të biznesit social të drejtuara nga të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël dhe për mbështetjen e bizneseve në zonat rurale.
- Mbështetja e bashkisë për zhvillimin e NVM-ve duhet të përfshihet në buxhetin vendor/ Programin Buxhetor Afatmesëm.
- Përmirësimi i mjedisit të biznesit duke ofruar shërbime cilësore për t'i bërë qytetet dhe rajonet më tërheqëse për investimet vendase dhe të huaja dhe për të rritur konkurrencën shqiptare në rajon.

KONKLUZIONE MBI EKZISTENCËN E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

Mbështetja e NVM-ve ka bërë njëfarë progresi dhe janë krijuar disa praktika të mira; megjithatë, të gjitha bashkitë duhet të japin një mbështetje të tillë. Zhvillimi ekonomik është një nga funksionet kryesore të qeverisjes vendore sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Rreth 67% e bashkive kanë hartuar, të paktën, një Plan Strategjik të Zhvillimit Vendor që përmirëson mjedisin e biznesit; 26% e bashkive nuk kanë arritur të

zhvillojnë një plan të tillë strategjik dhe ta miratojnë atë në këshillin bashkiak. Në vitin 2018 u krijuan rreth 8,245 NVM të reja (ose, mesatarisht 142).

Bashkitë kanë burime të kufizuara financiare për të mbështetur subjektet e reja të biznesit përmes skemave të granteve konkurruese që mund të nxisin ngritjen e subjekteve të reja të biznesit dhe ndërmarrjeve të inovacionit. Rreth 33% e bashkive nuk kanë ofruar shërbime të veçanta, të cilat promovojnë zhvillimin e NVM-ve. Disa bashki kanë aplikuar lehtësira tatimore për të mbështetur, në veçanti, NVM-të e drejtuara nga gratë. Pak bashki kanë dhënë stimuj për subjektet e reja të biznesit social të drejtuara nga të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël dhe për mbështetjen e bizneseve në zonat rurale.

Përfshirje më e mirë dhe më e mbështetur e biznesit në nivel kombëtar. Mbështetja vendore për NVM-të duhet të konsiderohet gjithashtu edhe në kuadër të përmirësimit të mjedisit të përgjithshëm të biznesit përmes ofrimit të shërbimeve cilësore në mënyrë që qytetet dhe rajonet të jenë më tërheqëse për investimet vendase dhe të huaja dhe të rrisin konkurrencën shqiptare në rajon.

4. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Aftësia për të marrë përsipër angazhimet e anëtarësimit, në veçanti, aftësinë për të zbatuar rregullat, standardet dhe politikat e acquis në mënyrë efikase, si dhe angazhimin për bashkimin politik, ekonomik dhe monetar.

4.1. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi dhe rural

Politika e përbashkët bujqësore mbështet fermerët dhe zhvillimin rural. Kjo kërkon sisteme të fuqishme të menaxhimit dhe kontrollit, rregulla të përbashkëta të BE-së për politikën e cilësisë dhe bujqësisë organike. Ndër prioritetet e tjera të rëndësishme të procesit të integritimit në BE, autoritetet shqiptare duhet, në veçanti: (i) të planifikojnë dhe të japin burime për përmirësimin e regjistrave të fermave dhe kafshëve dhe të përdorin statistikën bujqësore të disponueshme gjatë hartimit të politikave; (ii) të përfundojnë reformën e sistemit të këshillimit në bujqësi me qëllim forcimin e rritjes së investimeve në bujqësi dhe agro-përpunim; (iii) të plotësojnë kuadrin ligjor, institucional dhe administrativ për produktet organike, për emërtimin e mbrojtur të origjinës dhe treguesin e mbrojtur gjeografik.²⁵


Objektivi specifik (11.1): rritja e kapaciteteve të administratës vendore në sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor

Deri në fund të vitit 2018, Zyrat e Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB) ishin ngritur në 34 bashki (ose 56% të tyre), ndërsa ato nuk janë ngritur ende në 41% të pjesës

tjetër të bashkive (N = 59); 3% e bashkive nuk paraqitën të dhëna për këtë tregues.

Fondi mesatar vendor i alokuar për zhvillimin bujqësor dhe rural ishte rreth 9% e buxhetit të bashkisë në 85% të bashkive në vitin 2018 (N = 52); 16 bashki kanë raportuar se nuk kanë dhënë buxhet për këtë sektor.

Rreth 15% e bashkive kanë raportuar të dhëna të pasakta ose nuk kanë raportuar fare të dhëna. Grafiku tregon se bashkitë e Divjakës dhe të Dropullit kanë dhënë 50%-80% të buxhetit të përgjithshëm vendor për zhvillimin rural, gjë e cila është një çështje e diskutueshme.




4. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Tabela 12

11.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës vendore në sistemin e informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural


| Bashkitë | Ngritja e Zyrës së Informacionit Bujqësor dhe Zyrës Këshilluese në Bashki | Fondi lokal për zhvillimin rural / bujqë-sor në raport me buxhetin e Bashkisë në vitin e raportimit (në %) | Numri trajnimeve të stafit Zyrës së Informacionit Bujqësor dhe Zyrës Këshilluese ²⁶ |
|----------------|---|--|--|
| Belsh | Po | 10.00% | 0 |
| Berat | Po | 5.00% | 3 |
| Bulqize | Jo | 10.00% | 0 |
| Cerrik | Po | 8.00% | 2 |
| Delvine | Po | 0.00% | 0 |
| Devoll | Po | 0.01% | 0 |
| Diber | Jo | 2.00% | 0 |
| Divjake | Po | 80.00% | 2 |
| Dropull | Jo | 50.00% | 0 |
| Durrës | Jo | 15.90% | 0 |
| Elbasan | Po | 38.00% | 6 |
| Fier | Po | Nuk ka të dhëna | 5 |
| Finiq | Jo | 3.20% | 4 |
| Fushe Arrez | Jo | 35.00% | 4 |
| Gjirokaster | Po | 3.50% | 2 |
| Gramsh | Po | 0.31% | 2 |
| Has | Po | 1.20% | 1 |
| Himare | Po | 3.70% | 3 |
| Kamez | Jo | 0.00% | 0 |
| Kavaje | Jo | 0.60% | 0 |
| Kelcyre | Po | 0.00% | 2 |
| Klos | Po | 4.90% | 1 |
| Kolonje | Po | 23.00% | 0 |
| Konispol | Po | 10.00% | 0 |
| Korçë | Jo | 14,497,000 leke | 0 |
| Krujë | Po | 38.00% | 1 |
| Kuçovë | Po | 0.03% | 4 |
| Kukës | Jo | 0.20% | 3 |
| Kurbini | Po | 5.00% | 0 |
| Lezhë | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Libohovë | Jo | Nuk ka të dhëna | 4 |
| Librazhd | Po | 8.30% | 1 |
| Lushnjë | Jo | 31.60% | 0 |
| Malesi e Madhe | Po | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Maliq | Po | 0.00% | 5 |
| Mallakaster | Jo | 3.70% | 0 |
| Mat | Jo | Jo | 0 |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Mirditë | Po | 30.00% | 2 |
| Patos | Jo | 1.69% | 5 |
| Peqin | Po | 7.80% | 0 |
| Permet | Po | 8.60% | 2 |
| Pogradec | Po | 3.10% | 10 |
| Polican | Po | 0.00% | 4 |
| Prrenjas | Jo | 3.30% | 0 |
| Pukë | Jo | 0.00% | 0 |
| Pustec | Jo | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Roskovec | Jo | 6.20% | 0 |
| Rrogozhinë | Jo | 0.00% | 0 |
| Sarandë | Po | 10.00% | 2 |
| Selenice | Po | 0.00% | 2 |
| Shijak | Jo | 1.65% | 0 |
| Shkoder | Po | 3.10% | 6 |
| Skrapar | Jo | 4.44% | 0 |
| Tepelene | Jo | 0.00% | 0 |
| Tiranë | Po | 0.00% | 1 |
| Tropojë | Jo | 0.05% | 0 |
| Ura Vajgurore | Jo | 5.70% | 0 |
| Vau i Dejës | Po | 0.20% | 5 |
| Vlorë | Po | Po | 1 |
| Vorë | Po | 2.40% | 6 |

²⁶ Mbi prioritetet kombëtare në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përputhje me procesin e integritimit në BE (konkurrueshmëria e sektorit bujqësor dhe përmirësimi i teknikave të prodhimit, IPARD dhe peshkimi).



Vetëm 51% e bashkive kanë marrë pjesë në trajnime në vitin 2018 lidhur me prioritetet kombëtare në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke përfshirë, ndër të tjera, konkurrencën, menaxhimin e IPARD-it,

përmirësimin e teknikave të prodhimit dhe peshkimit (N = 61); trajnimet e ndjekura nga stafi variojnë nga 1 ose 2 trajnime deri në 10 trajnime në rastin e Bashkisë së Pogradecit.




Rezultatet e sondazhit mbi progresin dhe rezultatet e arritura si pjesë e rishikimit afatmesëm të Strategjisë Ndërsektoriale Kombëtare të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore (SNKDQV), maj-gusht 2018,²⁷ dhe veçanërisht rezultatet në lidhje me ndikimin e menaxhimit të ujitjes dhe kullimit pasi u transferua në bashki, kanë treguar sa më poshtë vijon: 76% e të intervistuarve vlerësuan ndikimin e këtij funksioni “si ndikim shumë të mirë/ndikim të mirë” dhe 22% si “me ndikim të dobët/dhe pa ndikim”.

Problemet dhe sfidat

- Përkushtim i dobët politik i disa bashkive që nuk kanë arritur të krijojnë Zyrat e Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB) në përputhje me prioritetet kombëtare.
- Burime të kufizuara financiare dhe njerëzore bashkiake për të forcuar rolin e Zyrave të Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB) në territorin e tyre.
- Mungesa e politikave strategjike për bu-

jqësinë dhe zhvillim rural në nivel vendor në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural 2014-2020 dhe në harmoni me mundësitë specifike vendore.

- Bashkëpunimi me organizatat këshilluese të specializuara në këtë zonë.
- Përfundimi i Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) që bën të mundur që të gjithë fermerët të marrin certifikatën e pronësisë së tokës.
- Infrastruktura e dobët rrugore në zonat e



27 Sondazhi u mbështet nga dldp / ASLG

largëta rurale përbën një pengesë për zhvillimin rural.

Objektivi specifik: përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, përmirësimi i infrastrukturës rurale, zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale.


Përmirësimi i produktivitetit, konkurrencës dhe standardeve të cilësisë është objektiv strategjik i CSARD 2014-2020 dhe prioritet i përbashkët i integritimit në BE. Përmirësimi i rrjeteve të ujitjes dhe kullimit dhe menaxhimi i tyre ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Qeveria e Shqipërisë e transferoi këtë funksion në vitin 2016 tek NjQV-të në përputhje me procesin e reformës së decentralizimit; asetet, burimet njerëzore dhe financiare u transferuan tek të gjitha bashkitë në mënyrë që ato ta ushtrorjnë këtë funksion. Rreth 267 punonjës publik u transferuan nga qeveria qendrore (Drejtoritë Rajonale të

Ujitjes dhe Kullimit) në 61 Bashki, të cilat përshtatën strukturat ekzistuese të menaxhimit. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbështeti të gjitha bashkitë me ekskavatorë të rinj dhe investime në disa stacione pompi.

Rezultatet e sondazhit,²⁸ i cili u realizua me një kampion të bashkive në lidhje me menaxhimin e këtij funksioni të ri të transferuar, tregoi përmirësim në aspektin e mbulimit territorial të bashkisë dhe rritje të efikasitetit të përdorimit të burimeve të disponueshme (përmirësim në vitet 2018, 2017 krahasuar me vitin 2015).

- Treguesit e performancës në lidhje me këtë objektivin specifik përfshijnë: (i) përmirësimin e sistemit të ujitjes si % e rrjetit të përgjithshëm të ujitjes bashkiake për periudhën raportuese; (ii) përmirësimi i sistemit të kullimit si % e rrjetit të përgjithshëm të kullimit; (iii) numri i granteve të dhëna fermerëve vendorë për bujqësinë dhe zhvillimin rural.



- Rrjeti i ujitjes i menaxhuar/përmirësuar nga shërbimet e bashkisë ishte, mesatarisht, 38% në vitin 2018 (N=53).²⁹ Gama e menaxhimit të rrjetit të ujitjes ndryshon nga 2.5% (përqindja më e ulët) deri në 100% (përqindja maksimale) në Bashkinë e Kavajës. Bashkitë e Beratit, Rogozhinës, Kamzës dhe Dropullit raportuan 0%, ndërsa bashkitë e Kukësit, Dibrës, Malësisë së Madhe, Pustecit, Memaliajt, Tiranës dhe Vlorës raportuan se “nuk kanë të dhëna të disponueshme».
- Mesatarisht, 44% e rrjetit vendor është ruajtur ose përmirësuar në vitin 2018 kur bëhet fjalë për menaxhimin e rrjetit të kullimit. Gama e menaxhimit të rrjetit të ujitjes ndryshon nga 3% (Lezhë), që është përqindja më e ulët deri në 100% (përqindja maksimale) në bashkitë e Korçës, Kavajës, Librazhdit dhe Tepelenës. Bashkitë e Kukësit, Kuçovës, Pustecit dhe Vlorës raportuan se “nuk kanë të dhëna të disponueshme».
- Rreth 84% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë dhënë grante nga buxheti vendor për fermerët vendorë. Divjaka, Konispoli, Mirdita, Vlora dhe Finiqi kanë raportuar se kanë mbështetur fermerët vendorë përmes skemave të granteve nga buxheti bashkiak për të promovuar produktet bujqësore, zhvillimin e biznesit bujqësor, turizmin bujqësor dhe ndërmarrjet e bazuara në inovacion në zonat rurale.


Problemet dhe sfidat

- Alokim më i madh i burimeve financiare dhe teknike për të përmirësuar sistemin e ujitjes dhe kullimit.
- Bashkëpunim i zgjeruar me bashkitë fqinje për të siguruar menaxhim efikas të sistemeve (rrjeteve) të ujitjes dhe kullimit.
- Bashkitë japin fonde shumë të kufizuara nga buxheti i tyre për skemat e granteve konkurruese për të promovuar prodhimet bujqësore, zhvillimin e biznesit bujqësor, turizmin bujqësor dhe ndërmarrjet e ba-

zuara në inovacion në zonat rurale.

- Mungesa e pikave të grumbullimit për produktet bujqësore që garantojnë një standard të përshtatshëm për ruajtjen e produkteve bujqësore.

Objektivi specifik (11.3): zbatimi i metodës LEADER




Metoda LEADER lidhet me fuqizimin vendor nëpërmjet zhvillimit të strategjisë vendore dhe alokimit të burimeve. Mjeti krpoor për zbatimin e metodës LEADER për zhvillimin e zonave dhe përfshirjen e përfaqësuesve vendorë në vendimmarrje është Grupi Vendor i Veprimit (GVV).

Grupet Vendorë të Veprimit krijohen me anë të partneritetit ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Qëllimi është të mbështeten fermerët dhe aktorët tjerë të rëndësishëm nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të strategjisë së integruar të zhvillimit rural. Kjo metodë nuk është e konsoliduar në të gjitha bashkitë.

Grupet vendore të veprimit u krijuan vetëm në 15 bashki (ose 25%) në vitin 2018, ndërsa 7 (shtatë) bashki (ose 11%) nuk paraqitën të dhëna për këtë tregues.

Objektivi specifik (11.4): përsheptimi i regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)

Mesatarja kumulative e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, të cilat u regjistruan nga bashkitë në vitin 2018, ishte 49% krahasu-




Grafiku 29

ar me numrin e përgjithshëm të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi në nivel kombëtar; rreth 28% e bashkive (N = 61) kanë raportuar ose të dhëna të pasakta ose nuk kanë raportuar fare të dhëna. Kjo tregon se procesi i regjistrimit është prapa planit të Planit të Veprimit të Strategjisë

Ndërsektoriale Kombëtare e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore (SNKDQV).

Vetëm 3 bashki kanë regjistruar 61% deri në 80% të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, ndërsa 14 bashki kanë një përqindje regjistrimi, e cila shkon nga 81% deri në 100%.



Grafiku 30

Problemet dhe sfidat

- Rritje e vetëdijësisimit ndërmjet bashkive rreth metodës LEADER dhe rolit të Grupit Vendor të Veprimit.
- Përmirësimi i operimit dhe funksionimit të Grupit ekzistuese Vendor të Veprimit.
- Regjistrimi i plotë nga shërbimet bashkiake i Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi.

KONKLUZIONE MBI BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Është bërë njëfarë *progresi drejt rritjes* së kapaciteteve të pushtetit vendor në lidhje me sistemin e informacionit dhe *me këshillimin rural dhe bujqësor, si dhe në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës rurale*. Zyrat e Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor (ZIKB) janë ngritur në 56% të bashkive. Vetëm 58% e bashkive kanë marrë pjesë në programet e rritjes së kapaciteteve. Pavarësisht njëfarë progresi të arritur në lidhje me performancën e ushtrimit të funksioneve të reja të decentralizuara në vitin 2016, përqindja mesatare e të gjithë rrjetit të ujitjes, i cili është mirëmbajtur/përmirësuar nga shërbimet bashkiake

Grafiku 32




ndërsa 69% kanë raportuar se nuk kanë treg të licencuar në bashkinë e tyre. 28% e bashkive (N = 61) kanë raportuar raste të shkeljeve të sigurisë ushqimore dhe veterinarë, ndërsa 66% e tyre nuk kanë raportuar

raste të shkeljeve të standardeve. Rreth 6% e bashkive nuk kanë paraqiture të dhëna.


Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon rolin mbikëqyrës të bashkive ndaj tregjeve ushqimore me pakicë. Ky funksion i NJQV-ve vlerësohet me anë të një treguesi të pestë të performancës, i cili është pranuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe që është përcaktuar si numri i tregjeve të shitjes me pakicë të licencuara nga shërbimet bashkiake kundrejt numrit total të tregjeve ushqimore me pakicë të bashkisë.

43% e bashkive nuk arritën të përmbushnin standardet e tregjeve ushqimore me pakicë në vitin 2018; 25% e bashkive kanë raportuar se të gjitha tregjet e tyre me


Grafiku 33



Grafiku 34



Grafiku 35



pakicë janë në përputhje me standardet e kërkuara, ndërsa 18% e tyre (N = 61) sigurojnë vetëm standarde të pjesshme.

Problemet dhe sfidat

- Rritja i kapaciteteve inspektuese të bashkive sipas legjislacionit të ndryshuar për shërbimin veterinar.
- Rritja i kapaciteteve inspektuese të bashkive në raport me tregjet ushqimore vendore të shitjes me pakicë.
- Licencimi i të gjitha tregjeve ushqimore me pakicë në të gjitha bashkitë në përputhje me standardet.
- Bashkëpunimi me autoritetet kompetente dhe zyrat rajonale për të garantuar sigurinë e ushqimit për qytetarët.
- Burime financiare të kufizuara për ngritjen e objekteve për të strehuar kafshët e rrugës.

KONKLUZIONE MBI POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARE DHE FITOSANITARE

Përmirësimi i kushteve sanitare dhe veterinarë për të mbrojtur shëndetin e konsumatorëve mbetet ende një shqetësim. Rreth 43% e bashkive nuk kishin asnjë veterinar në vitin 2018; 23% e bashkive kanë pasur tregje të licencuara për tregtimin e kafshëve, ndërsa 69% kanë raportuar që nuk kishin treg të licencuar në bashkinë e tyre; 28% e bashkive kanë raportuar raste të

shkeljeve të sigurisë ushqimore dhe veterinarë. Sa i përket respektimit të standardeve, rreth 43% e bashkive nuk kanë përmbushur standardet e tregjeve ushqimore me pakicë; 25% e bashkive kanë raportuar se të gjitha tregjet e tyre me pakicë janë në përputhje me standardet e kërkuara.

4.3.Kapitulli 14: Politika e transportit

Objektivat strategjike të politikave sektoriale të periudhës 2016-2020 nivel kombëtar janë fokusuar në përfundimin e rindërtimit të rrjetit rrugor kombëtar, menaxhimin e mirëmbajtjes dhe përmirësimin e sigurisë rrugore (reduktimin e numrit të aksidenteve dhe pikave të errëta).

Burimet financiare të BE-së (fondet IPA) për sektorin e transportit mbështesin zhvillimin e një sistemi efikas të transportit në Shqipëri, i cili duhet të integrohet me rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe rrjetin e BE-së. Një sistem i tillë i integruar i transportit është i rëndësishëm për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. Rritja e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të menaxhimit të transportit rrugor, zbatimi i standardeve të mirëmbajtjes dhe sigurisë, rritja e kapaciteteve administrative në funksion të ndërtimit të rrugëve dhe menaxhimi i mirëmbajtjes në nivel qendror dhe rajonal janë disa objektiva të tjerë kryesorë të financimit të BE-së për sektorin e transpor-

tit.

Funksioni i menaxhimit të rrugëve rurale dhe i rrjetit rrugor dytësor u transferua tek bashkitë më 1 janar 2016 në përputhje me procesin e reformës së decentralizimit.³² Asetet e zyrave qendrore (këshillat rajonale) duke përfshirë mjetet teknike dhe burimet njerëzore dhe financiare u transferuan tek bashkitë duke përfshirë edhe 2.000 punonjës publikë.

Rezultatet e Studimit “Mbi performancën e funksioneve të reja të vetëqeverisjes vendore” (2018) tregojnë se treguesit e performancës së sektorit të transportit që janë përdorur për transportin rural tregojnë përmirësime (2016/2017 krahasuar me 2015). Grupi i NJQV-ve, të cilat iu nënshtruan studimit, treguan performancë të përmirësuar gjatë periudhës 2016-2018 lidhur me transportin publik dhe linjat e transportit³³.

Objektivi specifik: rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor

Ky objektivi specifik vlerësohet me anë të 8 treguesve të performancës, të cilët janë përcaktuar në konsultim me ekspertët e Minis-

trisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në përputhje me treguesit e performancës së sektorit sipas përkufizimit të duhur.

- Mesatarisht, 52% e rrjetit urban ekzistues të bashkive përbushte standardet rru-gore në vitin 2018. Ky tregues luhatej nga niveli më i ulët prej %³⁴ tek më i larti prej 100%. Rreth 5% (ose 3 bashki) nuk paraqitën asnjë të dhënë lidhur me këtë tregues (N = 57).
- Mesatarisht, 33% e rrjetit rural ekzistues të bashkive përbushte standardet rru-gore në vitin 2018. Ky tregues luhatej nga niveli më i ulët prej 0%³⁵ deri tek më i larti prej 92%. Rreth 5% (ose 3 bashki) nuk paraqitën asnjë të dhënë lidhur me këtë tregues (N = 57).
- Mesatarisht, 35% (N = 57) e rrjetit rru-gor dytësor dhe tretësor të bashkive (me përjashtim të rrugëve nacionale) përbushte standardet e sinjalistikës rrugore.

Mesatarisht, 81% e numrit të përgjithshëm të fshatrave të bashkive ishin të lidhura me qendrën e bashkisë nëpërmjet rrjetit ekzistues rrugor në vitin 2018, ndërsa 78% e fsha-




32 Qeveria Shqiptare, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 127/2015 “Për transferimin e disa funksioneve në NJQV”.

33 Burimi: Raporti i studimit “Mbi realizmin e funksioneve të reja të pushtetit vendor”, O. Shapo (2018)

34 Bashkitë Fushë-Arrëz dhe Maliq.

35 Bashkitë Maliq, Pukë dhe Cërrik.



trave ishin të lidhura ndërmjet tyre nëpërmjet rrjetit ekzistues rrugor. Ky tregues luhatej nga 20% deri në 100% të numrit të përgjithshëm të fshatrave të bashkive.

Ndarja e buxhetit për mirëmbajtjen e rrugëve në vitin 2018 ishte në nivel të ulët. Bashkitë dhanë, mesatarisht, 8.6% e buxhetit të përgjithshëm për mirëmbajtjen e rrugëve. Përqindja maksimale e treguesit (30% e buxhetit të bashkisë) duket e mbivlerësuar.

Rreth 15% e bashkive nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë.

- Financimi për rindërtimin e rrugëve nga bashkitë luhatej nga 0% deri në 34%³⁶ të buxhetit të tyre; 8.8% ishte përqindja mesatare e buxhetit të përgjithshëm të bashkive në vitin 2018.
- Mesatarisht, 6.82% ishte alokimi i buxhetit për sigurinë rrugore në krahasim me alokimin e buxhetit të bashkive për sektorin e transportit (N=56).

Tabela 13

14.1. Rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor

| Bashkitë | % e rrjetit rrugor ekzistues urban në territorin e bashkisë në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit | % e rrjetit rrugor ekzistues rural në territorin e bashkisë në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit | % e rrjetit rrugor ekzistues të territorit të bashkisë i cili është brenda standardeve ligjore të sinjalistikës | Numri i fshatrave të lidhura me qendrën e Bashkisë kundrejt numrit total të fshatrave të Bashkisë nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues (në %) | Numri i fshatrave të lidhura midis tyre nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues në raport me numrin total të fshatrave (në %) | Fondi i buxhetit vendor për mirëmbajtjen e rrugëve (në % të Buxhetit të Bashkisë) në vitin e raportimit | Fondi i buxhetit vendor për ndërtimin/rehabilitimin e rrugëve në raport me buxhetin Bashkisë në vitin e raportimit (në %) | Fond për sigurinë rrugore në raport me fondin vendor për sektorin e transportit (në %) |
|----------------|---|---|---|---|--|---|---|--|
| Belsh | 100.0% | 70.0% | 100.0% | 100.0% | 76.0% | 10.0% | 10.0% | 5.0% |
| Berat | 50.0% | 40.0% | 80.0% | 100.0% | 100.0% | 8.0% | 42.0% | 0.3% |
| Bulqize | 24.0% | 90.0% | 11.0% | 96.0% | 5600.0% | 3.0% | 45.0% | 5.0% |
| Cerrik | 20.0% | 0.0% | 10.0% | 8570.0% | 8750.0% | 194.0% | 1300.0% | 1940.0% |
| Delvine | 50.0% | 40.0% | 60.0% | 100.0% | 100.0% | 4.9% | 40.0% | 0.0% |
| Devoll | 40.0% | 80.0% | 40.0% | 100.0% | 100.0% | 22.0% | 22.0% | 0.0% |
| Diber | 20-30% | 20-30% | 50-60% | 100.0% | 70.0% | 1.9% | 0.0% | Nuk ka të dhëna |
| Divjake | 45.0% | 70.0% | 30.0% | 100.0% | 100.0% | 146.0% | 1560.0% | 0.0% |
| Dropull | 36.0% | 27.0% | 9.0% | 72.0% | 65.0% | 83.0% | 99.4% | 0.0% |
| Durres | 85.0% | 78.0% | 80.0% | 100.0% | 100.0% | 2.0% | 32.6% | 0.0% |
| Elbasan | 36.5% | 6.6% | 16.3% | 99.0% | 80.0% | 1.0% | 17.2% | 18.0% |
| Fier | 92.0% | 92.0% | 60.0% | 95.0% | 82.0% | 2100000000.0% | 7000000000.0% | 300000000.0% |
| Finiq | 3.0% | 26.3% | 8.0% | 100.0% | 100.0% | 3.2% | 2.2% | 0.0% |
| Fushe Arrez | 0.0% | 20.0% | 20.0% | 90.0% | 90.0% | 2.0% | 6.0% | 0.0% |
| Gjirokaster | 80.0% | 55.0% | 45.0% | 57.0% | 4700.0% | 2.0% | 19.0% | 0.0% |
| Gramsh | 100.0% | 80.0% | 50.0% | 33.0% | 15.0% | 9.0% | 16.0% | 0.0% |
| Has | 70.0% | 40.0% | 10.0% | 80.0% | 80.0% | 6.0% | 6.0% | 0.0% |
| Himare | 10.0% | 5.0% | 50.0% | 50.0% | 50.0% | 1.9% | 25.0% | 25.0% |
| Kamez | 65.0% | 60.0% | 30.0% | 90.0% | 90.0% | 10.0% | 3.0% | 1.5% |
| Kavaje | 100.0% | 60.0% | 100.0% | 100.0% | 100.0% | 13.0% | 11.0% | 76.0% |
| Kelcyre | 53.0% | 0.0% | 8.0% | 48.0% | 48.0% | 16.0% | 6.6% | 0.0% |
| Klos | 20.0% | 10.0% | 15.0% | 95.0% | 100.0% | 8.0% | 23.0% | 2.0% |
| Kolonje | 100.0% | 21.0% | 13.0% | 43.0% | 43.0% | 4.0% | 0.8% | 0.0% |
| Konispol | 2.0% | 9.0% | 3.0% | 100.0% | 100.0% | 3.1% | 3.0% | 0.0% |
| Korce | 44.8% | 47.3% | 32.4% | 95.5% | 100.0% | 64567400 | 28.000.000 | 0.0% |
| Kruje | 45.0% | 15.0% | 45.0% | 40/50 | 40/50 | 10.0% | 48.0% | 0.7% |
| Kucove | 56.0% | 56.0% | 42.0% | 75.0% | 75.0% | 3.5% | 20.9% | 27.8% |
| Kukes | 80.0% | 23.3% | 60.0% | 83.0% | 65.0% | 100.0% | 100.0% | 9.2% |
| Kurbini | 80.0% | 30.0% | 40.0% | 20.0% | 66.7% | 0.3% | 1.5% | 1.0% |
| Lezhe | 35.0% | 40.0% | 70.0% | 95.0% | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Libohove | 25.0% | 30.0% | 30.0% | 100.0% | 100.0% | 4.7% | 55.2% | 0.0% |
| Librazhd | 80.0% | 35.0% | 50.0% | 96.0% | 65.0% | 5.7% | 16.0% | 0.0% |
| Lushnje | 80.0% | 25.0% | 12.0% | 100.0% | 100.0% | 7.4% | 19.7% | 23.1% |
| Malesi e Madhe | 50.0% | 50.0% | 50.0% | 35.0% | 98.0% | 14.7% | 25.0% | 0.0% |
| Maliq | 0.0% | 0.0% | 75.0% | 86.4% | 70.0% | 2.5% | 0.0% | 0.0% |
| Mallakaster | 80.0% | 20.0% | 5.0% | 36.6% | 87.8% | 3.1% | 34.1% | 20.0% |
| Mat | 80.0% | 25.0% | 75.0% | 95.0% | 95.0% | 13.0% | 16.0% | 16.2% |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | 52.0% | 5200.0% | 10.0% | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Mirdite | 85.0% | 40.0% | 50.0% | 32.0% | 85.0% | 10.0% | 15.0% | 5.0% |
| Patos | 45 % | 30.0% | 20.0% | 80.0% | 55.0% | 15.0% | 21.0% | 0.2% |
| Peqin | 30.0% | 25.0% | 35.0% | 29.0% | 25.0% | 25.0% | 25.0% | 25.0% |
| Permet | 53.0% | 14.0% | 10.0% | 59.0% | 59.0% | 16.0% | 6.6% | 0.0% |
| Pogradec | 65.0% | 23.0% | 30.0% | 100.0% | 100.0% | 3.1% | 18.5% | 1,68 |
| Polican | 25.0% | 3.0% | 13.0% | 100.0% | Nuk ka të dhëna | 6.0% | 21.0% | 0.3% |
| Prrenjas | 85.0% | 10.0% | 4.0% | 100.0% | 100.0% | 0.1% | 0.0% | 0.0% |
| Puke | 0.0% | 0.0% | 20.0% | 100.0% | 100.0% | 1.1% | 12.4% | 0.0% |
| Pustec | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | 0.0% | 730000 | 0.0% |
| Roskovec | 30.0% | 73.3% | 0.0% | 100.0% | 100.0% | 0.2% | 18.4% | 0.8% |
| Rrogozhine | 40.0% | 20.0% | 50.0% | 60.0% | 70.0% | 28000000 | 60.400.000 | 18000000 |
| Sarandë | 70.0% | 0.0% | 70.0% | 100.0% | 2000.0% | 2.0% | 16.0% | 3.5% |
| Selenice | 20.0% | 20.0% | 15.0% | 10.0% | 3000.0% | 3.0% | 20.0% | 3.0% |
| Shijak | 54.0% | 19.7% | 40.0% | 16.0% | 100.0% | 1.4% | 14.4% | 46.0% |
| Shkoder | 50.0% | 16.0% | 50.0% | 9300.0% | 9300.0% | 0,7% | 8.0% | 0,5% |
| Skrapar | 35.0% | 9.0% | 11.0% | 90.0% | 69.0% | 4.0% | 8.0% | 10.0% |
| Tepelene | 40.0% | 45.0% | 10.0% | 100.0% | 30.0% | 11.0% | 0.2% | 0.0% |
| Tirane | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | 29.0% | 20.0% | 10.0% |
| Tropeje | 70.0% | 15.0% | 10.0% | 95.0% | 95.0% | 0.0% | 0.0% | 0,3% |
| Ura Vajgurore | 73.0% | 73.0% | 20.0% | 18.0% | 2000.0% | 1.2% | 17.5% | 0.5% |
| Vau i Dejes | 31.0% | 31.0% | 15.0% | 28.0% | 3400.0% | 0 | 13.4 % | 0.4% |
| Vlore | 80.0% | 45.0% | 70.0% | 85.0% | 90.0% | 2,696,000 leke | 4.0% | 0.0% |
| Vore | 60.0% | 50.0% | 35.0% | 100.0% | 100.0% | 1.8% | 36.0% | 0.6% |

Objektivi specifik: përmirësimi i transportit publik

Sipas legjislacionit kombëtar për sektorin e transportit, shërbimet e transportit janë nënkontraktuar dhe ofrohen plotësisht nga operatorët privatë. Ata duhet të garantojnë cilësi të mirë të ofrimit të shërbimeve, të publikojnë orarin e përditshëm të transportit publik për secilën linjë transporti në stacionin e autobusëve dhe gjithashtu të mbulojë edhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit. Bashkia ka përgjegjësinë e përgjithshme të kontrollit të ofrimit të shërbimeve në mënyrë efektive dhe efikase për qytetarët sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratë. Nisur nga fakti se shërbimi i transportit publik është i nënkontraktuar, bashkitë nuk japin buxhet për mirëmbajtjen e automjeteve të transportit publik.


- Rreth 34% e bashkive e kanë publikuar orarin e transportit publik në stacionet e autobusëve; pjesa tjetër, 66% e bashkive, nuk e kanë publikuar orarin e transportit publik.
- Vetëm 9 bashki (ose 15%) kanë dhënë buxhet për mirëmbajtjen e automjeteve të transportit publik me një mesatare prej 7% të buxhetit vendor për sektorin e transportit. Rreth 85% e bashkive kanë raportuar se shërbimi i mirëmbajtjes ofrohet nga kompanitë private sipas detyrimeve të përcaktuara në kontrata.

14.2. Përmirësimi i transportit publik

| Bashkitë | Plan i transportit publik të bashkisë i publikuar në stacione të autobusëve | Fondi i Bashkisë për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit publik në raport me fondin total për sektorin e transportit në vitin e raportimit (në %) |
|----------------|---|---|
| Belsh | Jo | 0% |
| Berat | Jo | 0 |
| Bulqize | Jo | 0 |
| Cerrik | Po | 2.14 |
| Delvine | Jo | 0% |
| Devoll | 0.00% | Nuk ka të dhëna |
| Diber | Jo | 0.00% |
| Divjake | Jo | 10.00% |
| Dropull | Jo | 0 |
| Durres | Jo | 0 |
| Elbasan | Po | Nuk ka të dhëna |
| Fier | Po | 0 |
| Finiq | Jo | 0% |
| Fushe Arrez | 0 | 0 |
| Gjirokastr | Jo | 0 |
| Gramsh | Po | 0% |
| Has | Jo | 0 |
| Himare | Jo | 25% |
| Kamez | Po | 0 |
| Kavaje | Po | 0.00% |
| Kelcyre | Jo | 0.00% |
| Klos | Jo | 0.00% |
| Kolonje | Jo | 0.00% |
| Konispol | Jo | 0.00% |
| Korce | Po | Jo |
| Kruje | Po | 0 |
| Kucove | Jo | 0% |
| Kukes | Jo | 0 |
| Kurbin | Jo | 0 |
| Lezhe | Jo | 0% |
| Libohove | Jo | 0 |
| Librazhd | Jo | 0 |
| Lushnje | Jo | 0 |
| Malesi e Madhe | Jo | 0 |
| Maliq | Jo | 0 |
| Mallakaster | Po | 0% |
| Mat | 1 | 13% |
| Memaliaj | 1 | Nuk ka të dhëna |
| Mirdite | Po | 0% |
| Patos | Jo | 0 |
| Peqin | Jo | 0.10% |
| Permet | Jo | 0 |
| Pogradec | Po | 0 |
| Polican | Po | 0% |
| Prrrenjas | Jo | 0 |
| Puke | Jo | 0 |
| Pustec | Po | 0 |
| Roskovec | Jo | 0 |
| Rrogozhine | Po | 800000 |
| Sarande | Jo | 0 |
| Selenice | 0 | 0 |
| Shijak | Jo | 0 |
| Shkoder | Po | Jo |
| Skrapar | Jo | 1.35% |
| Tepelene | Jo | 0 |
| Tirane | Po | Jo |
| Tropoje | Po | 0.13% |
| Ura Vajgurore | Jo | 0.50% |
| Vau i Dejes | Jo | Jo |
| Vlore | Po | 0% |
| Vore | Po | 0% |

Grafiku 38

Publikimi i orareve të transportit publik në stacionet e autobusëve




Problemet dhe sfidat

- Përdorimi i automjeteve të vjetra, mungesa e ajrit të kondicionuar.
- Megjithë rritjen e numrit të linjave ndër-bashkiake, ekziston nevoja për mbulimin e më shumë linjave.
- Mungesa e kapaciteteve inspektuese dhe kontrolluese të shërbimeve bashkiake.
- Ngritja e një sistemi elektronik të biletave në shërbimin e transportit urban.
- Zhvillimi i sistemit GPS për të raportuar për performancën e shërbimit të transportit publik.
- Vendosja e sistemeve inteligjente SIT dhe kompjuterizimi i stacioneve.
- Mbështetja e zhvillimit të shërbimeve të gjelbra të taksive.

Objektivi specifik: nxitja e ecjes në këmbë dhe e përdorimit të biçikletës

Zhvillimi i zgjidhjeve bashkë-modale përmes optimizimit të mënyrave individuale të transportit dhe përqendrimi tek mënyrat e transportit që janë efçente për sa i përket energjisë dhe miqësore me mjedisin është një objektivi i veçantë i Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020. Gjatë viteve të fundit, bashkitë kanë demonstruar dhe kanë shtuar vëmendjen ndaj përmirësimit të infrastrukturës rrugore urbane në mënyrë që të mundësojnë ecjen në këmbë dhe përdorimin e biçikletës.




Grafiku 39

- Rreth 26% e bashkive kanë ndërtuar korsi biçikletash (N = 61); në vitin 2018 ishin të disponueshme, mesatarisht, 4.1% korsi biçikletash; përqindja luhatej nga 0.01% (Bashkia e Beratit) deri në 14% (Bashkia e Tiranës).
- 29 bashki (ose 48% e tyre) nuk kanë korsi biçikletash.

62%, mesatarisht, më pak se 3, (N = 38) të bashkive kanë organizuar fushata vetëdijësimi në vitin 2018 për ecjen në këmbë dhe për përdorimin e biçikletave në kuadër të Javës Evropiane të Lëvizshmërisë dhe Ditës Botërore të Mjedisit.

Grafiku më poshtë paraqet bashkitë që organizuan veprimtari të tilla vetëdijësimi. Korça është bashkia që ka organizuar numrin më të madh të veprimtarive. Bashkia e Tiranës gjithashtu ka organizuar veprimtari të tilla, por bashkia nuk ka paraqitur të dhënat për numrin e tyre.



Grafiku 40

Tabela 15

14.3. Promovimi i ecjes në këmbë dhe me biçikleta

| Bashkitë | Km rrugë për biçikleta në zonat urbane të Bashkisë në raport me km rrugë totale në zonat urbane (ne %) - treguesi të jete kumulativ për (%) ³⁷ | % e rrjetit rrugor të brendshëm të zonave urbane të bashkisë i pajisur me trotuarë | Fushata promovimi të ecjes në këmbë dhe me biçikleta të ndërmarra nga Bashkia |
|----------------|---|--|---|
| Belsh | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | 0 |
| Berat | 0.01% | 87.00% | 2 |
| Bulqize | 0.40% | 15% | 2 |
| Cerrik | 2 | Nuk ka të dhëna | Po |
| Delvine | 0.00% | 80% | Po |
| Devoll | Nuk ka të dhëna | 15.00% | 0 |
| Diber | 5.00% | 80.00% | 0 |
| Divjake | 3.00% | 70.00% | Jo |
| Dropull | 0 | 10.00% | 3 |
| Durrës | 0.2 | 80.00% | 1 |
| Elbasan | 0.16% | 26.50% | Po |
| Fier | Nuk ka të dhëna | 60.00% | 6 |
| Finiq | 0 | 0% | 0 |
| Fushe Arrez | 0.35 km | 35% | Po |
| Gjirokastr | 4% | 8% | 3 |
| Gramsh | 0% | 95% | Po |
| Has | 0 | 30% | Po |
| Himare | 0 | 5% | Po |
| Kamëz | 0 | 35.00% | Jo |
| Kavajë | 0.04% | 95.00% | 2 |
| Kelcyre | 0.00% | 53.00% | Po |
| Klos | 0.00% | 50.00% | 0 |
| Kolonjë | 0.00% | 50.00% | Jo |
| Konispol | 0.00% | 10.00% | Po |
| Korçë | 15 km | 90% | 6 |
| Krujë | 0 | 70% | 5 |
| Kuçovë | 0.0% | 22.4% | 2 |
| Kukës | 11.71% | 80% | 3 |
| Kurbin | 0 | 100% | 0 |
| Lezhë | 4% | 70% | Po |
| Libohovë | 3% | 0% | 0 |
| Librazhd | 0 | 70% | Jo |
| Lushnjë | 0.1% | 90% | 2 |
| Malesi e Madhe | 600m | 600m | 2 |
| Maliq | 2 km | 20% | 2 |
| Mallakastër | 0% | 80% | Jo |
| Mat | 0 | 95% | 3 |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Mirditë | 0 | 80% | Po |
| Patos | 2% | 70% | 2 |
| Peqin | 32 Km | 70% | Jo |
| Permet | 0 | 53% | Po |
| Pogradec | 0 | 52% | Po |
| Polican | 10% | 90% | Po |
| Prrenjas | 2 | 80% | Jo |
| Pukë | 0 | 40% | Jo |
| Pustec | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Jo |
| Roskovec | 0.15% | 70% | 1 |
| Rrogozhinë | 0 | 40% | Po |
| Sarandë | 0 | 80% | 1 |
| Selenice | 1 | 10 | 1 |
| Shijak | 0 | 50% | 1 |
| Shkoder | 8% | 40% | Po |
| Skrapar | 0% | 90% | Jo |
| Tepelene | 0 | 90% | Jo |
| Tiranë | 14% | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Tropoje | 0% | 70% | Po |
| Ura Vajgurore | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Vau i Dejës | 0 | 3% | Jo |
| Vlorë | Nuk ka të dhëna | 80% | 5 |
| Vorë | 0% | 92% | 0 |

37 Treguesi duhet të jetë kumulativ për të matur progresin nga viti në vit.

Problemet dhe sfidat

- Shkalla e vetëdijësimit të qytetarëve për problemin mjedisor dhe promovimi i mënyrave alternative të lëvizjes.
- Mungesa e burimeve të përshtatshme financiare për investime për të ndërtuar korsi biçikletash dhe për të shpronësuar pronarët.

KONKLUZIONE MBI POLITIKËN E TRANSPORTIT

Rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor po tregon njëfarë progresi, por janë bërë përpjekje të kufizuara për të promovuar ecjen në këmbë dhe përdorimin e biçikletave. Mesatarisht, vetëm 52% e rrjetit ekzistues urban të bashkive plotëson standardet rrugore në vitin 2018, ndërsa në rastin e rrjetit rural ekzistues të bashkive ishte 33%, ndërkohë që sinjalistika rrugore përmbushte standardet, mesatarisht, 35%. Mesatarisht, rreth 8.6% e buxhetit të përgjithshëm të bashkive ishte dhënë në vitin 2018 për mirëmbajtjen e rrugëve ndërkohë që buxheti i dhënë për sigurinë rrugore kundrejt buxhetit të dhënë nga bashkitë për sektorin e transportit ishte 6.82%. Vetëm 26% e bashkive kanë ndërtuar korsi biçikletash; korsi të biçikletave përbënin, mesatarisht, 4.1% të gjatësisë së rrjetit urban në vitin 2018, gjë që tregon një përqindje të ulët. 48% e bashkive nuk kanë korsi biçikletash në zonat e tyre urbane.

Përmirësimi i transportit publik dhe ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të rehatshme për qytetarët mbetet një sfidë. Rreth 66% e bashkive publikuan orarin e transportit publik në territorin e tyre. 15% e bashkive kanë dhënë buxhet për mirëmbajtjen e automjeteve të transportit publik me një mesatare prej 7% të buxhetit vendor të dhënë për sektorin e transportit në vitin 2018; rreth 66% e bashkive kanë siguruar mirëmbajtjen e mjeteve të transportit publik si pjesë e kontratave me shoqëritë (e nënkontraktuara) private.




4.4. Kapitulli 15: Energjia

Strategjia Kombëtare për Energjinë, 2018 – 2030³⁸ (SKE) dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Eficencën e Energjisë (PKVEE) 2018 - 2021³⁹ përcaktojnë përgjegjësitë institucionale jo vetëm për institucionet e administratës qendrore, por edhe për njësitë e qeverisjes vendore. Detyrimi i parë për bashkitë qëndron në emërimin / rekrutimin e menaxherit për eficientë e energjisë, i cili pasi të trajnohet dhe certifikohet do të udhëheqë procesin e hartimit të Planit të Veprimit (PV) të masave për eficientë e energjisë në nivel vendor.

PV i miratuar nga bashkia do të jetë në përputhje me PKVEE, 2018 -2021, që integron masat që lidhen me zbatimin e metodave dhe kërkesave për institucionet publike, subjektet private, ndërtimin e objekteve të reja publike dhe shërbimeve publike, shkollat dhe kopshtet, ndriçimin rrugor dhe fusha të tjera siç përcaktohet me legjislacionin e sektorit përkatës.

Objektivi specifik: Rritja e eficientës së përdorimit të energjisë nga konsumatorët familiarë por edhe nga pallatet me shumë banorë, si për

shërbimet publike ashtu edhe për ato private. Rreth 24% e bashkive kanë caktuar menaxherin për eficientë e energjisë (N = 55); 10% e bashkive nuk kanë raportuar të dhëna për këtë tregues; deri në fund të vitit 2018, 66% e bashkive nuk e kishin caktuar ende menaxherin për eficientë e energjisë. Trajnimi dhe certifikimi i menaxherit për eficientë e energjisë në nivelin vendor është zhvilluar nga 23% e bashkive në 2018. Plani Lokal i Veprimit për eficientë e energjisë është hartuar dhe miratuar në KB nga 25% e bashkive (N = 58); 2 bashki (ose 3%) ishin në proces hartimi; 67% e bashkive nuk kishin hartuar ndonjë Plan Lokal të Veprimit për ef-



icencën e energjisë deri në fund të vitit 2018. Bashkia e Tiranës ka përfshirë masa për eficientë e energjisë në Planin e saj të Veprimit “Qyteti i Gjelbër” (2018) dhe në Planin e Veprimit për Përshtatjen e Tiranës ndaj Ndryshimeve të Klimës (2015), ndërkohë që bashkia disponon edhe një Plan Veprimi për Eficencën Energjitetike të miratuar në vitin 2013 i cili përcakton masa për eficientë e energjisë të cilat shtrihen deri në vitin 2020. Në koordinim me institucionet qendrore, 61% e bashkive kanë organizuar fushata këshilluese me institucionet publike dhe komunitetin e biznesit për efikasitetin e energjisë në nivelin lokal, në total 59 fushata për ngritjen e vetëdijes të kryera në nivel kombëtar (mesatarisht 1 fushatë); 24% e bashkive nuk kanë organizuar ndonjë fushatë këshilluese; 15% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna për këtë tregues.

38 VKM nr.480/31.07.2018 mbi miratimin e Strategjisë Kombëtare për Energjinë

39 Plani Kombëtar i Veprimit për eficientë e energjisë (PKVEE) do të rishikohet çdo 3 vjet

4.4. KAPITULLI 15: ENERGJIA

Tabela 16

15.1. Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë

| Bashkitë | Caktimi (rekrutimi) i menaxherit të eficiencës së energjisë në Bashki | Trajnimi dhe certifikimi i menaxherit të energjisë nga strukturat përkatëse | Hartimi i Planit vendor të Veprimit (PV) në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit (2018-2020) për eficiencën e energjisë |
|----------------|---|---|---|
| Belsh | Nuk ka të dhëna | Jo | Jo |
| Berat | Jo | Po | Jo |
| Bulqize | Po | Po | Po |
| Cerrik | Po | Jo | Jo |
| Delvine | Jo | Jo | Jo |
| Devoll | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Po |
| Diber | Jo | Jo | Jo |
| Divjake | Jo | Jo | Jo |
| Dropull | Jo | Jo | Jo |
| Durres | Jo | Jo | Jo |
| Elbasan | Po | Po | Po |
| Fier | Jo | Jo | Jo |
| Finiq | Jo | Jo | Jo |
| Fushe Arrez | Jo | Jo | Po |
| Gjirokaster | Jo | Po | Jo |
| Gramsh | Jo | Jo | Jo |
| Has | Po | Po | Jo |
| Himare | Jo | Jo | Jo |
| Kamez | Jo | Jo | Jo |
| Kavaje | Jo | Jo | Jo |
| Kelcyre | Po | Po | Jo |
| Klos | Po | Po | Po |
| Kolonje | Jo | Jo | Jo |
| Konispol | Jo | Jo | Jo |
| Korce | Po | Po | Po |
| Kruje | Jo | Jo | Po |
| Kucove | Po | Jo | Jo |
| Kukes | Po | Po | Po |
| Kurbin | Jo | Jo | Jo |
| Lezhe | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Libohove | Po | Po | Jo |
| Librazhd | Jo | Jo | Jo |
| Lushnje | Jo | Jo | Jo |
| Malesi e Madhe | Jo | Jo | Jo |
| Maliq | Jo | Jo | Jo |
| Mallakaster | Jo | Jo | Jo |
| Mat | In process | In process | In process |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | In process |
| Mirdite | Jo | Jo | Jo |
| Patos | Po | Po | Po |
| Peqin | Jo | Jo | Po |
| Permet | Po | Po | Jo |
| Pogradec | Jo | Jo | Po |
| Palican | Jo | Jo | Jo |
| Prrenjas | Jo | Jo | Jo |
| Puke | Jo | Jo | Jo |
| Pustec | Jo | Jo | Po |
| Roskovec | Jo | Jo | Jo |
| Rrogozhine | 0 | 0 | Jo |
| Sarande | Jo | Jo | Po |
| Selenice | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Shijak | Jo | Jo | Jo |
| Shkoder | Po | Po | Jo |
| Skrapar | Jo | Jo | Jo |
| Tepelene | Jo | Jo | Jo |
| Tirane | Jo | Jo | Po |
| Tropoje | Po | Jo | Jo |
| Ura Vajgurore | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Vau i Dejes | Jo | Jo | Jo |
| Vlore | Po | Po | Po |
| Vore | Jo | Jo | Jo |

Forcimi i kapaciteteve institucionale për eficiencën e energjisë: Shumë pak bashki kanë marrë pjesë në trajnime mbi masat dhe kërkesat e PKVEE në vitin raportues (2018); Rreth 20% e bashkive morën pjesë në këto trajnime; 64% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim; rreth 5% e bashkive nuk kanë sjellë të dhëna.

Tabela 17

15.2. Rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë: përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat dhe shërbimet publike dhe private

| Bashkitë | Numri i trajnimeve të administratës vendore mbi Planin Kombëtar të Veprimit mbi Efikasitetin e Energjisë 2018-2020 dhe kërkesat minimale për ndërtesa/shërbimeve publike dhe private |
|----------------|--|
| Belsh | 0 |
| Berat | 4 |
| Bulqize | 0 |
| Cerrik | 1 |
| Delvine | 0 |
| Devoll | 0 |
| Diber | 0 |
| Divjake | 0 |
| Dropull | 0 |
| Durrës | 1 |
| Elbasan | 0 |
| Fier | 0 |
| Finiq | 0 |
| Fushë Arrez | 2 |
| Gjirokastër | 0 |
| Gramsh | 0 |
| Has | 0 |
| Himare | 0 |
| Kamëz | 0 |
| Kavajë | 0 |
| Kelcyre | 1 |
| Klos | 0 |
| Kolonjë | 1 |
| Konispol | 0 |
| Korçë | 0 |
| Krujë | 0 |
| Kuçovë | 0 |
| Kukës | 0 |
| Kurbini | 0 |
| Lezhë | 0 |
| Libohovë | 2 |
| Librazhd | 0 |
| Lushnjë | 0 |
| Malesi e Madhe | 1 |
| Maliq | 0 |
| Mallakastër | 0 |
| Mat | N |
| Memaliaj | 2 |
| Mirditë | 0 |
| Patos | 4 |
| Peqin | 0 |
| Permet | 1 |
| Pogradec | 4 |
| Polican | 0 |
| Prrenjas | 0 |
| Pukë | 0 |
| Pustec | Nuk ka të dhëna |
| Roskovec | 0 |
| Rrogozhinë | 0 |
| Sarandë | 0 |
| Selenice | Nuk ka të dhëna |
| Shijak | 0 |
| Shkoder | 3 |
| Skrapar | 0 |
| Tepelene | 1 |
| Tiranë | 0 |
| Tropojë | 0 |
| Ura Vajgurore | Nuk ka të dhëna |
| Vau i Dejës | 0 |
| Vlorë | 1 |
| Vorë | 0 |

Për shkak të numrit të kufizuar të menaxherëve të efikasitetit të energjisë të caktuar nga bashkitë, ka pasur pak kontrole mbi aplikimin e masave të efikasitetit të energjisë në përputhje me kërkesat për ndërtimin e objekteve publike dhe private të ndërmarrë nga bashkitë në vitin 2018. Vlera mesatare e kontroleve në kërkesat e efikasitetit të energjisë mes bashkive, është 1; 64% e bashkive nuk kanë ndërmarrë asnjë kontroll mbi efikasitetin e energjisë në vitin 2018. Rreth 16% e bashkive nuk kanë ofruar asnjë të dhënë për këtë tregues të performancës.

Problemet dhe sfidat

- Mungesa e menaxherit për efikasitetin e energjisë në administratën vendore siç kërkohet nga strategjia kombëtare për energjinë.
- Mungesa e vëmendjes politike nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak për përaftrimin e masave lokale me prioritetet e qeverisjes qendrore në sektorin e energjisë.
- Burime të kufizuara njerëzore, teknike dhe financiare për hartimin dhe përaftrimin e PV për Efikasitetin e Energjisë në nivel lokal me PKVEE, 2018-2021.
- Mungesa e koordinimit efektiv për efikasitetin e energjisë ndërmjet ministrive të linjës, institucioneve të tjera qendrore dhe bashkive.

PËRFUNDIME MBI ENERGJINË

Ka patur shumë pak progres në drejtim të rritjes së efikasitetit të përdorimit të energjisë, ndërsa disa përpjekje janë bërë për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për një përdorim më efikas të energjisë. Për sa i përket rritjes së efikasitetit në përdorimin e energjisë, në vitin 2018, rreth 24% e bashkive kanë caktuar menaxherin për efikasitetin e energjisë (N = 55); 66% e bashkive nuk e kishin caktuar menaxherin për efikasitetin e energjisë deri në fund të vitit 2018.

Trajnimi dhe certifikimi i menaxherit për efikasitetin energjitik në nivelin lokal bëhet nga 23% e bashkive. Plani Lokal i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë është hartuar dhe

4.5. Kapitulli 16: Taksat

miratuar në KB nga 25% e bashkive⁴⁰; 67% e bashkive nuk kanë hartuar ndonjë Plan Lokal të Veprimit për Eficencën e Energjisë deri në fund të vitit 2018 (N = 58).

61% e bashkive kanë organizuar fushata këshilluese me institucionet publike dhe komunitetin e biznesit për eficencën e energjisë në nivel lokal – në vitin 2018 është zhvilluar mesatarisht 1 fushatë për eficencën energjitike; 24% e bashkive nuk kanë organizuar ndonjë fushatë këshilluese.

Forcimi i kapaciteteve institucionale për eficencën energjitike: Shumë pak bashki kanë marrë pjesë në trajnime të zhvilluara mbi masat dhe kërkesat e PKVEE në vitin raportues (2018). 64% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim. Nga shërbimet bashkiake është kryer mesatarisht, 1 kontroll vjetor në 2018 mbi zbatimin e kërkesave për eficencën energjitike.

4.5. Kapitulli 16: Taksat

Një gamë e gjerë aktivitetesh informuese dhe në mbështetje të tatimpaguesit ka nisur, duke përfshirë: portalin, help desks, vizitat e biznesit dhe broshurat. Administrata Tatimore ka filluar me zbatimin e Planit të Veprimit Anti-Infomalitet⁴¹.


Ligji për financat vendore përmirësoi parashikueshmërinë e burimeve të qeverisjes vendore duke përcaktuar që transferimi i pakushtëzuar të mos jetë më pak se 1% e PBB-së së një viti më parë; nivelet e taksave referuese janë prezantuar për pothuajse të gjitha taksat. Diskrecioni vendor në modifikimin e normës së tatimit përcaktohet për taksën e pronës⁴². Janë bërë disa ndryshime në sistemin e taksave të përbashkëta, (i) niveli i ndarjes për taksën e regjistrimit të automjeteve u rrit në 25% të arkëtimit për t'u transferuar në bashki, (ii) tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) u prezantua si taksë e përbashkët. Mbledhja e taksës mbi pasurinë e

bazuar në vlerën e pronës në favor të bashkive nuk ishte bërë ende funksionale në vitin 2018. Krijimi i një kadastre fiskale për administrimin e taksave të pasurive në nivel lokal është në proces

Objektivi Specifik: Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme.

Administrimi i taksave lokale është përmirësuar nga shumë bashki. Përmirësimet kryesisht konsistojnë në rritjen e transparencës për regjistrimin e biznesit, ankesat online nga qytetarë të veçantë dhe subjektet e biznesit, si dhe në përgjithësi janë përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve. Niveli i formalizmit të ekonomisë u përmirësua përmes vendosjes së sistemit online (TIK) me institucionet publike duke bërë të mundur shkëmbimin e informacionit kryesor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Gjithashtu është përmirësuar planifikimi i kontroleve në subjektet e biznesit nga shërbimet e administratës tatimore vendore.

- Rreth 77% e bashkive (ose 47 bashki) kanë miratuar politika tatimore lokale për promovimin e ekonomisë formale; 20% e bashkive nuk kanë miratuar ndonjë politikë lokale të taksave.
- Numri mesatar i inspektimeve në terren të kryera nga shërbimet tatimore të bash-




kive për të luftuar informalitetin në ekonomi ishte 858 në 2018 (ose më shumë se dyfish krahasuar me numrin e inspektimeve në 2017). Duke qenë se inspektimet

40 Bashkia e Tiranës ka përfshirë masat për eficencën e energjisë brenda "Planit të Veprimit Qyteti i Gjellbër" (2018), Planit të Veprimit për Përshtatjen ndaj ndryshimeve të klimës për Tiranën (2015)

41 Raporti i Monitorimit të Strategjisë mbi Menaxhimin e Financave Publike (Mars 2018)

42 Në nivelin +/- 30% të nivelit tregues të taksave




në terren të kryera nga DPT në Bashkinë e Tiranës janë shumë të larta, vlera mesatare e inspektimeve në terren midis të gjitha bashkive, duke përfshirë Bashkinë e Tiranës, është 338 (ose 24% më e lartë kundrejt vlerës mesatare të inspektimeve në terren në 2017).

- Rreth 88% e bashkive (ose 54 bashki) kanë krijuar dhe përditësuar rregullisht databazën bashkiake të debitorëve; Katër (4) bashki ende nuk kanë krijuar një bazë të dhënash bashkiake për debitorët, 1 bashki ishte në proces të krijimit të databazës; ndërsa 3 bashki të tjera (ose 2%) nuk siguruan të dhëna.

Bashkitë duher të organizojnë dëgjesa publike me grupet e interesit nga sektori i biznesit për nisma të reja mbi taksat lokale si dhe të marrin mendime dhe rekomandime.

- Midis të gjitha bashkive, numri mesatar i dëgjesave publike të zhvilluara nga bashkitë për informimin dhe konsultimin e politikave të taksave lokale në vitin 2018 ishte 5 (25% më e lartë kundrejt 2017).

Në vitin 2018 të ardhurat e bashkive nga taksat vendore dhe tarifat e tjera u rritën në krahasim me vitin 2017 - vlera mesatare e të ardhurave vendore midis të gjitha bashkive është 28% më e lartë në vitin 2018. Shtatë (7) bashki kanë rritur të ardhurat lokale mbi 70% në 2018 krahasuar me 2017⁴³.



4.5. Kapitulli 16: Taksat

Tabela 18

16.1. Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme

| Bashkitë | Numri i inspektimeve në terren të ndërmarrë nga bashkia me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale | Numri i dëgjësive publike me grupet e biznesit të organizuara nga bashkia me qëllim informimin dhe përfshirjen në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë | Ndërtimi i një baze të dhënash (program) të debitorëve të bashkisë |
|----------------|--|--|--|
| Belsh | 30 | 3 | Po |
| Berat | 115 | 8 | Po |
| Bulqize | 561 | 6 | Po |
| Cerrik | 35 | 10 | Po |
| Delvine | 270 | 4 | Nuk ka të dhëna |
| Devoll | 60 | 1 | Po |
| Diber | 6 | 1 | Po |
| Divjake | 562 | 5 | Po |
| Dropull | 36 | 3 | Po |
| Durrës | 3200 | 2 | Po |
| Elbasan | 50 | 1 | Po |
| Fier | 1611 | 15 | Po |
| Finiq | 99 | 5 | Po |
| Fushë Arrez | Nuk ka të dhëna | Jan 03 | Jo |
| Gjirokaster | 4 | 15 | Po |
| Gramsh | 27 | 20 | Po |
| Has | Nuk ka të dhëna | 2 | Po |
| Himare | 20 | 13 | Po |
| Kamez | 7 | 3 | Po |
| Kavajë | 531 | 12 | Po |
| Kelcyre | Nuk ka të dhëna | 0 | Po |
| Klos | 5 | 4 | Po |
| Kolonjë | Nuk ka të dhëna | 2 | Po |
| Konispol | 4 | 3 | Po |
| Korçë | 1474 | 6 | Po |
| Krujë | 15 | 0 | Po |
| Kuçovë | 300 | 1 | Po |
| Kukës | 40 | 1 | 1 |
| Kurbini | 4 | 1 | Po |
| Lezhë | 515 | 12 | Po |
| Libohovë | 2 | 2 | Po |
| Librazhd | 400 | 2 | Po |
| Lushnjë | 4000 | 11 | Po |
| Malesi e Madhe | 10 | 1 | Nuk ka të dhëna |
| Maliq | Po | 7 | Po |
| Mallakaster | 29 | 4 | Po |
| Mat | 65 | 3 | Po |
| Memaliaj | 30 | Nuk ka të dhëna | In proces |
| Mirditë | 54 | 10 | Po |
| Patos | 12 | 4 | 2 |
| Peqin | 10 | 1 | Jo |
| Permet | Nuk ka të dhëna | 2 | Po |
| Pogradec | 240 | 10 | Po |
| Polican | 10 | 2 | Po |
| Prrenjas | 30 | 0 | Jo |
| Pukë | 50 | 2 | Po |
| Pustec | Nuk ka të dhëna | 3 | Po |
| Roskovec | 25 | 2 | Po |
| Rrogozhinë | 4 | 2 | Po |
| Sarandë | 550 | 4 | Po |
| Selenice | 480 | 3 | Po |
| Shijak | 137 | 2 | Po |
| Shkoder | 1400 | 37 | Po |
| Skrapar | 6 | 2 | Po |
| Tepelene | 5 | 2 | Po |
| Tiranë | 27527 | 13 | Po |
| Tropojë | 57 | 4 | Jo |
| Ura Vajgurore | 4 | 2 | Po |
| Vau i Dejës | 650 | 3 | Po |
| Vlorë | Nuk ka të dhëna | 2 | Po |
| Vorë | 120 | 1 | Po |

Problemet dhe sfidat

- Formalizimi i ekonomisë dhe rritja e të ardhurave vendore.
- Kapacitete teknike, sistemi financiar dhe TIK-u të kufizuara për administrimin efektiv të të ardhurave vendore nga taksat dhe tarifat.
- Qëndrueshmëria dhe profesionalizmi i shërbimeve bashkiake të taksave.
- Rritja e aftësive inspektuese për të mbuluar territorin e zgjeruar të bashkisë.
- Vendosja e kadastrës fiskale.
- Angazhim dhe pjesëmarrje aktive e e qytetarëve dhe komunitetit të biznesit në konsultimet publike të zhvilluara nga administrata tatimore bashkiake

PËRFUNDIME PËR TAKSAT***Përmirësim në administrimin e sistemit vendor të taksave dhe tarifave.***

Rreth 77% e bashkive kanë miratuar politika për taksat lokale me qëllim promovimin e ekonomisë formale (ky tregues tregon përmirësim krahasuar me vitin 2017 (ku ishte në nivelin e 51%); 20% e bashkive nuk kanë miratuar ndonjë politikë lokale taksash.

Numri mesatar i inspektimeve në terren të kryera nga shërbimet tatimore të bashkisë për të luftuar informalitetin në ekonomi ishte 858 në 2018 (ose më shumë se dyfish krahasuar me numrin e inspektimeve në 2017). Rreth 88% e bashkive kanë krijuar dhe përditësuar rregullisht data-bazën bashkiake të debitorëve (N = 59).

Në funksion të rritjes së transparencës nëpërmjet konsultimit publik, në vitin 2018 u organizuan nga bashkitë mesatarisht 5 seanca dëgjimore publike, për informimin dhe konsultimin me publikun mbi politikat e taksave lokale (25% më shumë se në vitin 2017).

4.6. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi

Mbrojtja sociale është një funksion thelbësor që si qeverisja qendrore ashtu edhe ajo vendore e, kanë përgjegjësi të përbashkët dhe role koordinuese për t'u ekzekutuar⁴⁴. Megjithëse, funksioni i mbrojtjes sociale nuk është plotësisht i decentralizuar, në vitet e fundit pas RAT bashkitë kanë alokuar më shumë burime njerëzore dhe financiare për ekzekutimin e mbrojtjes sociale në nivelin lokal. Politika sociale lokale është në përputhje me prioritetet kombëtare⁴⁵ që konsistojnë në përmirësimin e funksionimit të sistemit të ndihmës ekonomike bazuar në një grup kriterish, rritjen e aksesit në shërbimet publike nga persona vulnerabël, ndihmën sociale për personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike, me qëllim mbrojtjen e tyre nga përjashtimi social dhe varfëria, rritjen e gjithë-përfshirjes së tyre dhe mundësive të punësimit përmes mbështetjes së pjesëmarrjes aktive në programet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive (arsim profesional / programe profesionale).

Objektivi specifik: mbrojtja sociale në nivelin lokal


Progresi në zbatimin e politikës së mbrojtjes sociale në nivelin lokal bëhet përmes vlerësimit të 10 treguesve të performancës, të cilat konsistojnë në burimet njerëzore bashkiake të caktuara për funksionin e mbrojtjes sociale, administrimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike, ndërtimin e kapaciteteve (zyrtarë publik vendorë të trajnuar), strehimin social dhe qendrat bashkiake të kujdesit social (qendrat ditore ose rezidenciale).

- Numri mesatar i zyrtarëve shtesë të pushtetit vendor përgjegjës për përfshirjen sociale në bashkitë e vendit është 2 (krahasuar me 3 staf shtesë në 2017). Njëzet e tetë (28) bashki nuk kishin ndonjë staf shtesë në 2018 i cili është i ngjashëm me vitin 2017.
- Numri mesatare e zyrtarëve lokalë shtesë, përgjegjës për menaxhimin, mon-

44 Ligji 139/2015 "Mbi Vetëqeverisjen Vendore"

45 Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020; Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Zhvillimin e Aftësive 2014-2020

Grafiku 48



itorimin dhe vlerësimin e skemës së ndihmës ekonomike është 1.4 në të gjitha bashkitë. Rreth 50% e bashkive (ose 31 bashki) nuk kishin staf shtesë në vitin 2018.

Rritja e funksioneve dhe kompetencave të njëjësive të qeverisjes vendore duhet të shoqërohet me masa për ngritjen e kapaciteteve. Në vitin 2018, zyrtarët e qeverisjes vendore të Departamentit të Shërbimeve Sociale kanë marrë pjesë në programe të ndryshme trajnimi mbi sistemin e ri të ndihmës ekonomike, ofrimin e shërbimit të integruar social, menaxhimin e të drejtave të njeriut, sistemin ROMALB, statistikave sociale sipas standardeve të BE-së, dhe tema të tjera. Trajnimet mbështeten nga institucionet qendrore

(fondi buxhetor) dhe projektet e financuara nga donatorët.

Sa i përket pjesëmarrjes së shtuar në klasat përgatitore për arsimin parashkollor, numri mesatar i kopshteve në nivelin kombëtar është 28 (N = 61), dhe raporti i regjistrimit të fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç në këtë sistem arsimor është rreth 70% (N = 53), i cili ishte më i ulët se niveli 79% në 2017. Rreth 13% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna. Mesatarisht, 232 fëmijë nga grupi i marginalizuar, përfshirë romët dhe egjiptianët, kanë ndjekur arsimin parashkollor në vitin 2018 (N = 43). Bashkitë kanë alokuar mesatarisht rreth 2.9% të buxhetit të bashkisë (N = 52) për ndërtimin e kopshteve të reja dhe rikonstrukcionin e atyre ekzistuese.

Objektivi specifik: Përfshirja sasiore dhe cilësore e grupeve të marginalizuara në sistemin arsimor parauniversitar

Mesatarisht, 0,42% e buxhetit të bashkive për vitin 2018 u përdor për regjistrimin në arsimin e detyrueshëm të fëmijëve romë dhe egjiptianë dhe grupe të tjera të marginalizuara; vlera mesatare e braktisjes nga fëmijët që u përkisnin këtyre grupeve ishte rreth 7.

Sa i përket përmirësimit të infrastrukturës shkollore të sistemit arsimor parauniversitar, në vitin 2018 u alokuar mesatarisht 3.48% e buxhetit të bashkive (N = 51); Rreth 20%

e bashkive (N = 61) raportuan se nuk kishin alokuar buxhet për investime në shkolla. Planifikimi i infrastrukturës së shkollave që lejon mundësinë e rritjes së aksesit nga PAK është realizuar nga rreth 89% e bashkive.

Përfaqësuesit e bashkisë kanë qenë të pranishëm në bordet e shkollës në rreth 87% të bashkive (N = 61); Rreth 56% e bashkive kanë mbështetur nisma për krijimin e komunitit shkollë-prindër-qeveri; 36% e bashkive nuk e kanë zbatuar një iniciativë të tillë.

Sa i përket ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale, rreth 74% e bashkive kanë raportuar se nuk kanë patur raste shkeljesh dhe ndërtimesh të paligjshme në zonat e trashëgimisë kulturore; 6 bashki (ose 10%) kanë raportuar 1 deri në 5 raste shkeljesh. Masat janë ndërmarrë nga shërbimet e bashkisë - mesatarisht, 1.99% e buxhetit të bashkive për vitin 2018 ishte ndarë për mbrojtjen e pasurive kulturore. Rreth 36% e bashkive nuk kanë ndarë buxhet të veçantë për këtë funksion. Mesatarisht, në vitin 2018 janë planifikuar dhe organizuar nga bashkitë (N = 59) 11 aktivitete kulturore.

4.11. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës

Objektivi specifik: Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe menaxhimit të pyjeve

Forcimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore dhe rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e natyrës dhe pyjeve, është prioritet i Strategjisë Kombëtare për Mjedisin 2018-2030 dhe një përparësi e axhendës së Integritimit Evropian të vendit. Bashkitë kanë një rol të rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve lokalë në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe pyjeve dhe minimizimin e ndotjes organike.

- Numri i përgjithshëm i zyrtarëve publik vendorë të trajnuar për legjislacionin mjedisor, mbrojtjen e mjedisit dhe standardet ishte rreth 107. Vlera mesatare e trajnimeve të organizuara ishte rreth 2 trajnime (në të njëjtin nivel me 2017). Treguesi sillet nga 1 në 6, që do të thotë se të gjitha bashkitë (N = 46) kanë trajnuar të paktën zyrtar publik.
- Rreth 20% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në programe të ngritjes së kapaciteteve për çështje të mjedisit; rreth 5% (ose 3 bashki) nuk kanë vënë të dhëna në dispozicion.
- Për sa i përket rolit mbështetës të bashkive për fushatat e ndërgjegjësimit me qytetarët vendas dhe subjektet e biznesit në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe pyjeve si dhe minimizimin e ndotjes organike, 75% e bashkive kanë organizuar gjithsej 241 aktivitete ndërgjegjësimi; mesatarisht, 5 aktivitete të organizuara në 2018.
- Rreth 25% e bashkive nuk kanë ofruar të dhëna të sakta ose nuk kanë siguruar asnjë të dhënë për aktivitete sensibilizuese mbi mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe pyjeve.

Objektivi specifik: Edukimi i gjeneratave të reja për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes

Mes qytetarëve dhe të rinjve shqiptarë ka një mungesë kulture dhe sjellje të duhur kundrejt mbrojtjes së mjedisit, natyrës, pyjeve dhe në lidhje me ndotjen e mjedisit. Edukimi i të rinjve është i rëndësishëm dhe bashkitë duhet të bëjnë më shumë në këtë drejtim. Tema për vitin 2018 në ditën ndërkombëtare të mjedisit ishte “Të mundim ndotjen plastike” - një thirrje për veprim për secilin qytetar që të bashkohen në luftën kundër një prej sfidave më të mëdha mjedisore, duke u angazhuar në aktivitetet e Ditës së Tokës, aktivitetet promovuese për mbjelljen e pemëve, dhe temave të tjera që lidhen me mjedisin.

- Rreth 75% e bashkive (N = 61) kanë organizuar takime edukative dhe ndërgjegjësuere në shkolla si dhe fushata kundër ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e tij.
- Në total, në vitin 2018 janë kryer 188 aktivitete sensibilizuese, ose mesatarisht 4 aktivitete (N = 46), e cila është vlerë më e lartë në krahasim me vitin 2017 (mesatarisht 3 aktivitete). Rreth 25% e bashkive nuk kanë ofruar të dhëna të sakta ose nuk kanë siguruar asnjë të dhënë që lidhet me këtë tregues.


Tabela 31

27.1. Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve

| | Numri i nëpunësve të administratës vendore të trajnuar për legjislacionin mjedisor dhe zbatimin e tij si dhe përparësitë e fushës së mjedisit në lidhje me integrimin në BE | Fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes organizuar nga Bashkia, institucione qendrore dhe aktorë të tjerë (OSHC/projekte) |
|----------------|---|---|
| Belsh | 4 | 3 |
| Berat | 1 | 3 |
| Bulqize | 6 | Po |
| Cerrik | 1 | 16 |
| Delvine | 1 | 1 |
| Devoll | 3 | 2 |
| Diber | 0 | 12 |
| Divjake | 2 | Po |
| Dropull | 2 | 0 |
| Durres | 2 | 0 |
| Elbasan | Nuk ka të dhëna | 7 |
| Fier | 1 | 2 |
| Finiq | 0 | 0 |
| Fushe Arrez | 4 | 10 |
| Gjirokaster | 1 | 1 |
| Gramsh | 3 | 3 |
| Has | 3 | 11 |
| Himare | 4 | Po |
| Kamez | 1 | 0 |
| Kavaje | 1 | 3 |
| Kelcyre | 2 | 0 |
| Klos | 2 | 4 |
| Kolonje | 2 | 4 |
| Konispol | 0 | 0 |
| Korce | 2 | 10 |
| Kruje | 2 | 10 |
| Kucove | 2 | 2 |
| Kukes | 0 | 2 |
| Kurbini | 2 | Po |
| Lezhe | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Libohove | 1 | 5 |
| Librazhd | 0 | 2 |
| Lushnje | 3 | Po |
| Malesi e Madhe | 1 | Jo |
| Maliq | 0 | 0 |
| Mallakaster | 0 | 7 |
| Mat | 1 | 3 |
| Memaliaj | 1 | Nuk ka të dhëna |
| Mirdite | 2 | 14 |
| Patos | 1 | 9 |
| Peqin | 5 | 9 |
| Permet | 2 | 11 |
| Pogradec | 1 | 7 |
| Polican | 0 | Po |
| Prrenjas | 0 | 4 |
| Puke | 3 | 14 |
| Pustec | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Roskovec | 1 | 25 |
| Rrogozhine | 3 | Po |
| Sarande | 1 | Po |
| Selenice | 2 | 3 |
| Shijak | 3 | 3 |
| Shkoder | 5 | 3 |
| Skrapar | 0 | Nuk ka të dhëna |
| Tepelene | 2 | 6 |
| Tirane | 6 | 1 |
| Tropoje | 0 | 2 |
| Ura Vajgurore | 1 | Po |
| Vau i Dejes | 0 | Jo |
| Vlore | 2 | 6 |
| Vore | 6 | 1 |

Objektivi specifik: hartimi i planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit mjedisor në nivelin lokal.

- Sa i përket PLV për përmirësimin e cilësisë së ajrit, 25% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar Planin Lokal të Veprimit (vlera e treguesit është më e lartë në krahasim me vitin 2017 në nivelin e 18%).
- 3% e bashkive ishin në proces hartimi të planit deri në fund të vitit 2018; 67% e bashkive nuk kanë hartuar ende PLV për përmirësimin e cilësisë së ajrit në territorin e bashkisë së tyre.



- Rreth 28% e bashkive i kanë integruar masat lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit në dokumentin e tyre strategjik, duke përfshirë PBA - që tregon përmirësim nëse krahasohet me vitin 2017 (në nivelin 20%), ndërsa 61% e bashkive ende nuk e kanë ende një dokument të integruar strategjik.

Tabela 32

27.3. Hartimi i planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në nivel vendor

| Plan vendor i veprimit (PV) për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në zbatim të Planit Kombëtar për përmirësimin e cilësisë së ajrit | |
|--|-----------------|
| Belsh | Jo |
| Berat | Jo |
| Bulqize | Jo |
| Cerrik | Jo |
| Delvine | Jo |
| Devoll | Jo |
| Diber | Po |
| Divjake | Po |
| Dropull | Jo |
| Durrës | Jo |
| Elbasan | Po |
| Fier | Jo |
| Finiq | Jo |
| Fushë Arrez | Ne process |
| Gjirokastrë | Jo |
| Gramsh | Po |
| Has | Jo |
| Himare | Jo |
| Kamez | Po |
| Kavajë | Po |
| Kelcyre | Jo |
| Klos | Po |
| Kolonjë | Jo |
| Konispol | Jo |
| Korce | Jo |
| Krujë | Jo |
| Kuçovë | Jo |
| Kukës | Jo |
| Kurbini | Jo |
| Lezhë | Nuk ka të dhëna |
| Libohovë | Po |
| Librazhd | Jo |
| Lushnjë | Jo |
| Malesi e Madhe | Jo |
| Maliq | Ne process |
| Mallakastër | Jo |
| Mat | Jo |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna |
| Mirditë | Jo |
| Patos | Po |
| Peqin | Po |
| Permet | Jo |
| Pogradec | Po |
| Polican | Jo |
| Prrenjas | Jo |
| Pukë | Jo |
| Pustec | Jo |
| Roskovec | Jo |
| Rrogozhinë | Po |
| Sarandë | Jo |
| Selenice | Nuk ka të dhëna |
| Shijak | Po |
| Shkoder | Jo |
| Skrapar | Jo |
| Tepelene | Jo |
| Tiranë | Jo |
| Tropojë | Jo |
| Ura Vajguore | Po |
| Vau i Dejës | Jo |
| Vlorë | Jo |
| Vorë | Po |

Grafiku 83



- 2% e bashkive ishin në proces të përfshirjes / integritit të masave lokale brenda dokumentit strategjik në nivelin lokal. Rreth 10% e bashkive nuk kanë ofruar asnjë të dhënë.

Problemet dhe sfidat

- Kapacitetet e kufizuara të planifikimit dhe angazhimi i ulët nga organet vendimmarrës në nivelin lokal për hartimin e planit të masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe integrimin e tyre brenda dokumentit strategjik dhe PBA të bashkisë.
- Kapacitete të kufizuara për të siguruar trajnime të vazhdueshme në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, njohuri mbi legjislacionin dhe praktikatat më të mira kundrejt standardeve.
- Burime të kufizuara financiare për organizimin e aktiviteteve edukative dhe sensibilizuese për qytetarët vendas, subjektet e biznesit dhe gjeneratën e re.
- Përfshirja e kufizuar e aktorëve të shoqërisë civile, shkollave dhe studentëve për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe përmirësimin e cilësisë së tij.
- Trajnime të rregullta për çështjet e mjedisit dhe cilësinë e ajrit.


Objektivi specifik: Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka

hartuar dhe miratuar një dokument të ri strategjik për mbrojtjen e mjedisit 2018 – 2030, me mbështetje të donatorëve dhe ekspertëve bazuar në qasjen e standardeve minimale të përballeshme. Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve në vend, përmbushja e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare, përmirësimi i performancës së sektorit kundrejt standarteve, zgjerimi i zonës së mbuluar me shërbimet e lidhura me mbetjet dhe përmirësimi i cilësisë së tyre, duke përfshirë dhe zonat e largëta, janë disa nga objektivat kryesore të këtij dokumenti të ri strategjik. Dy vendime të reja (VKM)⁶⁴ për modelin e llogaritjes së kostos dhe tarifave, si dhe metodologjinë e mbylljes së vend depozitimeve të mbeturinave dhe standardeve të rehabilitimit, kanë qenë baza e ndërhyrjeve të ndërmarra nga bashkitë në të gjithë vendin për të përbaluar situatën emergjente në sektorin e menaxhimit të mbetjeve; MTM ka hartuar Hartën e 199 vendeve të depozitimit të mbeturinave dhe një plan masash për zvogëlimin e rreziqeve të vend depozitimeve në vitin 2018. Disa bashki janë mbështetur me projekte të financuara nga donatorët për të zhvilluar dhe zbatuar planin e menaxhimit


menaxhimin e mbetjeve;

- Rreth 46% e bashkive nuk kishin një PMM të tillë, dhe si rrjedhim nuk përfshiheshin në PBA, ndërsa 2% e bashkive nuk ofruan të dhëna.




- Rreth 64% e bashkive kanë menaxhuar në 2018 mbledhjen e dhe vend depozitimet e mbetjeve të ngurta në deponitë sipas planit të tyre të menaxhimit lokal (kjo tregon përmirësim krahasuar me vitin 2017 - në nivelin 43%; 31% e bashkive e kanë menaxhuar shërbimin pa pasur nevojë për një PMM të integruar.

- Rreth 8% e bashkive i mbledhin mbetjet urbane përmes koshave të diferencuar, dhe kjo ndodh përmes një numri të vogël perso-





të mbetjeve në nivelin lokal.

- Deri në fund të 2018, 49% e bashkive kishin hartuar dhe miratuar Planin e Menaxhimit të Mbetjeve që është pjesë e PBA (vlera e këtij treguesi është më e lartë në krahasim me vitin 2017 - në nivelin prej 11%); 3% e bashkive ishin në proces të hartimit të planit lokal për



nash që mbledhin materialet e diferencuara; 85% e bashkive nuk i riciklojnë mbetjet bashkiake. MTM ka miratuar vendimin sipas të cilit



mbledhja e mbeturinave të bashkisë duhet të bëhet në bazë të 2 rrymave të mbetjeve.

- Rreth 95% e bashkive nuk ishin në gjendje ti menaxhonin mbetjet bashkiake në dy rryma të veçanta, 3% e bashkive kanë arritur ti menaxhojnë, 2% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna.
- Në total, u raportuan nga bashkitë 71 vend depozitimet të autorizuar për vitin 2018, ose mesatarisht 1 (N = 50).
- Rreth 33% e bashkive raportojnë të kenë së paku 1 deponi të paautorizuar në territorin e tyre; 64% e bashkive raportojnë se nuk kanë asnjë vend depozitim mbetjesh të paautorizuar; 3% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna.
- Bazuar në të dhënat e raportuara, disertanca mesatare e qendrës së bashkisë me deponinë më të afërt është 18 km. Bashkitë të cilat i kanë deponitë e tyre mjaft larg qendrës së qytetit janë Bashkitë Fushë Arrëz (80 km), Himarë (75 km) dhe Tepelenë (70 km).

Problemet dhe sfidat

- Kapaciteti i kufizuar në nivel vendor për të zhvilluar dhe miratuar Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe për të siguruar zbatimin e tij sipas standardeve dhe treguesve të performancës.
- Kapacitete të kufizuara administrative dhe financiare për shtrirjen e shërbimeve të integruara të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë.
- Tarifa e shërbimit të mbetjeve nuk mbulon koston e plotë, kjo shoqëruar edhe me mbledhjen e tarifave e cila është më pak se 100%.
- Forcimi i kapaciteteve të administratës bashkiake dhe monitorimi i grumbullimit dhe deponimit të mbetjeve sipas standardeve minimale të përballueshme dhe tarifave lokale të shërbimit.
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve lokalë për ti hedhur mbetjet në dy koshë të veçantë.
- Vazhdimi i investimeve në deponinë e Bushatit pasi ende nuk kanë përfunduar të gjitha fazat e projektit. Menaxhimi i vend depozitimit së Bushatit pas përfundimit të plotë të projektit mbetet një sfidë.
- Ndarja e mbeturinave në burim në përputhje me vendimin e MTM (kërkesat ligjore)
- Ndërtimi i vend depozitimit së re në disa bashki.

Tabela 33

27.4. Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve

| | Plan vendor i MIM i hartuar, dhe planifikuar në PBA | Mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë bëhet në mënyrë të rregullt sipas Planit vendor të Menaxhimit të Mbetjeve | Mbetjet e riciklueshme të territorit të bashkisë riciklohen sipas objektivave të Planit MIM vendor (nga shoqëritë e riciklimit / ose ndërmarrjet publike) | Numri i vend-depozitimeve të paautorizuara në territorin e bashkisë | Numri i vend-depozitimeve të autorizuara / landfill ose incinerator në territorin e bashkisë | Mbetjet ndahen në burim në rryma sipas legjislacionit |
|----------------|---|---|---|---|--|---|
| Belsh | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Berat | Jo | Po | Jo | 3 | 2 | Jo |
| Bulqize | Jo | Po | Jo | 3 | 0 | Jo |
| Cerrik | Jo | Jo | Jo | 0 | 0 | Jo |
| Delvine | Ne Proces | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Devoll | Jo | Jo | Po | 42 | 1 | Jo |
| Diber | Po | Po | Jo | 3 | 1 | Jo |
| Divjake | Jo | Po | Jo | 0 | 4 | Jo |
| Dropull | Po | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Durrës | Jo | Po | Jo | 0 | 4 | Jo |
| Elbasan | Po | Po | Nuk ka të dhëna | 0 | 2 | Jo |
| Fier | Jo | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Finiq | Po | Po | Jo | 3 | 1 | Jo |
| Fushe Arrez | Jo | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Gjirokastrë | Jo | Po | Jo | 5 | 0 | Jo |
| Gramsh | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Has | Po | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Himare | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Po |
| Kamez | Jo | Jo | Jo | 1 | 0 | Jo |
| Kavajë | Po | Po | Jo | 4 | 0 | Jo |
| Kelcyre | Jo | Jo | Jo | 0 | 0 | Jo |
| Klos | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Kolonjë | Jo | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Konispol | Po | Po | Jo | 0 | 0 | Jo |
| Korçë | Po | Po | Po | 0 | 1 | Po |
| Krujë | Jo | Jo | Jo | 2 | 2 | Jo |
| Kuçovë | Jo | Po | Jo | 0 | 2 | Jo |
| Kukës | Po | Po | Jo | 0 | 2 | Jo |
| Kurbini | Po | Po | Jo | 4 | 0 | Jo |
| Lezhë | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Libohovë | Po | Partially | Jo | 4 | 1 | Jo |
| Librazhd | Jo | Jo | Jo | 1 | 0 | Jo |
| Lushnjë | Jo | Jo | Jo | 0 | 4 | Jo |
| Malesi e Madhe | Po | Partially | Jo | 4 | 1 | Jo |
| Maliq | Jo | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Mallakastër | Jo | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Mat | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Memaliaj | In process | Po | Partially | 1 | 0 | Nuk ka të dhëna |
| Mirditë | Jo | Jo | Jo | 0 | 2 | Jo |
| Patos | Jo | Jo | Jo | 2 | 1 | Jo |
| Peqin | Po | Jo | Jo | 6 | 1 | Jo |
| Permet | Po | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Pogradec | Po | Po | Nuk ka të dhëna | 0 | 1 | Jo |
| Polican | Jo | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Prrenjas | Jo | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Pukë | Po | Po | Jo | 0 | 2 | Jo |
| Pustec | Jo | Nuk ka të dhëna | Jo | 2 | 2 | Jo |
| Roskovec | Jo | Jo | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Rrogozhinë | Po | Po | Po | 0 | 0 | Jo |
| Sharandë | Jo | Po | Jo | 0 | 2 | Jo |
| Selenice | Nuk ka të dhëna | Po | Jo | 3 | 1 | Jo |
| Shijak | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Shkoder | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Skrapar | Po | Po | Jo | 3 | 2 | Jo |
| Tepelene | Jo | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Tiranë | Po | Po | Po | Nuk ka të dhëna | 1 | Jo |
| Tropojë | Jo | Po | Jo | 5 | 2 | Jo |
| Ura Vajgurore | Po | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |
| Vau i Dejës | Po | Po | Po | Nuk ka të dhëna | 1 | Jo |
| Vlorë | Po | Po | Partially | 0 | 2 | Jo |
| Vorë | Jo | Po | Jo | 0 | 1 | Jo |

Objektivi specifik: Forcimi i zbatimit të vendimit për ngritjen e task forcës për ndotjen akustike në qendrat ur-

bane dhe zonat turistike bregdetare

Forcimi i zbatimit të vendimit për ngritjen dhe funksionimin e task forcës për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare është një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Mjedisin 2018-2030 dhe një përparësi në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Sipas detyrimeve juridike të ligjit nr. 9774/2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis”, bashkitë duhet të hartojnë dhe miratojnë plane lokale veprimi për zhurmën në zonat e banimit, procesin e vlerësimit të zhurmave, përcaktimin e zonave të qeta në ambientet e banimit apo ambiente të hapura dhe vendosjen e sanksioneve kundër mosrespektimit të ligjit nga subjekte të ndryshme.

- Rreth 49% e bashkive kanë krijuar task forcën për ndotjen akustike, ndërsa 44% e bashkive nuk e kishin krijuar ende atë deri në fund të 2018; 7% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna.
- Në total, në 2018 janë punësuar 88 inspektorë për ndotjen akustike me një vlerë mesatare prej 3 inspektorësh (N = 30).
- Në vitin 2018, janë organizuar shtatë (7) trajnime për inspektorët e bashkive mbi ndotjen akustike, kuadrin ligjor dhe masat në nivelin lokal.




Tabela 34

27.5. Forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare

| Qytet | Numri i Inspektorëve të policisë bashkake për task forcën e ngritur për ndotjen akustike në zonat urbane dhe turistike |
|----------------|--|
| Belsh | 0 |
| Berat | 3 |
| Bulqize | Nuk ka të dhëna |
| Cerrik | 0 |
| Delvine | 0 |
| Devoll | 0 |
| Diber | 5 |
| Divjake | 2 |
| Dropull | 1 |
| Durres | 2 |
| Elbasan | Nuk ka të dhëna |
| Fier | 0 |
| Finiq | 0 |
| Fushe Arrez | 2 |
| Gjirokaster | 0 |
| Gramsh | 0 |
| Has | 1 |
| Himare | 0 |
| Kamez | 0 |
| Kavaje | 17 |
| Kelcyre | 2 |
| Klos | 5 |
| Kolonje | 11 |
| Konispol | 0 |
| Korce | 1 |
| Kruje | 0 |
| Kucove | 0 |
| Kukes | 0 |
| Kurbin | 2 |
| Lezhe | Nuk ka të dhëna |
| Libohove | 2 |
| Librazhd | 1 |
| Lushnje | 1 |
| Malesi e Madhe | 0 |
| Maliq | 0 |
| Mallakaster | 0 |
| Mat | 1 |
| Memaliaj | 4 |
| Mirdite | 2 |
| Patos | 0 |
| Peqin | 0 |
| Permet | 1 |
| Pogradec | 2 |
| Polican | 0 |
| Prrenjas | 0 |
| Puke | 3 |
| Pustec | 0 |
| Roskovec | 0 |
| Rrogazhine | 0 |
| Sarande | 1 |
| Selenice | 3 |
| Shijak | 8 |
| Shkoder | 0 |
| Skrapar | 1 |
| Tepelene | 0 |
| Tirane | Nuk ka të dhëna |
| Tropoje | 1 |
| Ura Vajgurore | 1 |
| Vau i Dejes | 1 |
| Vlore | 1 |
| Vore | 0 |

Problemet dhe sfidat

- Numri i inspektorëve për kontrollin e problemeve akustike është i vogël në bashkitë e mëdha ku progremat janë edhe më të dukshme. Kjo shoqërohet me mungesën e njohurive dhe trajnimeve për kërkesat e parashikuara në Ligjin Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.
- Task forcat për zbatimin e vendimit mbi ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare nuk janë trajnuar për ti kryer funksionet e tyre siç duhet;
- Mungesa e pajisjeve që do të mundësojnë inspektorët të matin ndotjen akustike në dB (decibel) dhe të vendosin gjobë për subjektet që tejkalojnë normën e lejuar.

Objektivi specifik: Integrimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike në planet vendore në përputhje me përparësitë dhe objektivat kombëtare.


- 66% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar planin lokal të masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës në përputhje me përparësitë dhe objektivat kombëtare, ndërsa 25% e bashkive nuk e kishin hartuar ende planin lokal.

Qëllimi specifik: Rritja e aftësisë për t'u përshtatur me efektet sfiduese të ndryshimit të klimës në nivelin lokal

Bashkitë duhet të mbledhin dhe regjistrojnë të gjitha të dhëna mbi klimën si dhe duhet të hartojnë raporte mbi masat e planifikuara për të zbutur efektet dhe për t'u përshtatur me ndry-

shimin e klimës, duke zvogëluar emetimet e CO₂ dhe duke arritur objektivat e mësipërme në kuadër të zbatimit të planit kombëtar të veprimit të dokumentit strategjik për energjinë e rinovueshme dhe eficientë të energjisë, si dhe në kuadër të objektivave të Konventës për Ndryshimin e Klimës⁶⁵.

- Rreth 8% e bashkive kanë mbledhur dhe regjistruar të dhëna mbi klimën, ndërsa 75% e bashkive nuk kanë mbledhur të dhëna të tilla; rreth 16% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna.
- Lidhur me ngritjen e kapaciteteve të ekspertëve për ndryshimin e klimës në nivelin lokal, rreth 31% e bashkive raportuan se të paktën një staf lokal ishte trajnuar në vitin 2018; 61% e bashkive nuk morën pjesë në ndonjë trajnim; 8% e bashkive nuk kanë ofruar të dhëna në lidhje me këtë tregues.
- Të dhënat në lidhje me buxhetin vendor dhe fondet e tjera për projekte investimesh miqësore ndaj ambientit me fokus përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës dhe zvogëlimin e emetimeve të CO₂ në përputhje me planet lokale (d.m.th. bashkitë bregdetare) kanë qenë shumë të kufizuara duke e bërë të pamundur përgjithësimin e gjetjeve; vetëm 3 bashki akorduan buxhet me një vlerë mesatare rreth 5,000,000 lekë; 82% e bashkive nuk kanë ndarë asnjë buxhet lokal në vitin 2017 për projekte që fokusohen në përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës dhe uljen e emetimeve të CO₂, ndërsa 13% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna të sakta ose nuk kanë ofruar fare të dhëna.



4.11. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës

Bashkitë theksojnë se ekziston nevoja për të vendosur më shumë pajisje monitorimi dhe politika paralele për heqjen e automjeteve të vjetra që ndotin mjedisin. Masat e mbrojtjes së ajrit duhet të zbatohen fuqimisht, dhe bashkitë duhet të fillojnë vendosjen e

gjobjave të rënda për të gjithë ndotësit (jo vetëm makinat, por edhe bizneset, siç janë restorantet ose bizneset e prodhimeve të vogla që kontribuojnë në ndotjen e ajrit përmes emetimeve të shkaktuara nga tymrat e gatimit.)

Tabela 35

27.6.1. Integrimi i reziqeve të ndryshimeve të klimës në planet vendore në harmoni me prioritetet dhe objektivat kombëtarë

| | Plan vendor (PV) i hartuar/përditësuar nga Bashkitë më vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike që kanë integruar rreziqet e ndryshimeve të klimës dhe masat respektive | Buxheti i shpenzuar në nivel vendor për investime të projekteve (miqësore) që adresojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe uljen e shkarkimeve të CO2 në përputhje me planet vendore dhe në fushat prioritare për bashkitë më vulnerabël | |
|----------------|--|--|-----------------|
| Belsh | Jo | 0% | Jo |
| Berat | Po | Jo | Jo |
| Bulqize | Jo | 0 | Nuk ka të dhëna |
| Cerrik | Jo | 0 | Jo |
| Delvine | Po | 0 | Nuk ka të dhëna |
| Devoll | Po | 3 | Po |
| Diber | Jo | 5,000.00 € | Nuk ka të dhëna |
| Divjake | Jo | 0 | Jo |
| Dropull | Jo | 0 | Jo |
| Durres | Jo | 0 | Jo |
| Elbasan | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Fier | Jo | 0 | Jo |
| Finiq | Jo | 0 | Jo |
| Fushe Arrez | Ne process | 0 | Jo |
| Gjirokastr | Jo | 0 | Jo |
| Gramsh | Jo | 0 | Jo |
| Has | Jo | 0 | Jo |
| Himare | Po | 0.20% | Jo |
| Kamez | Jo | 0 | Jo |
| Kavaje | Jo | 0.00% | Jo |
| Kelcyre | Jo | 0 | Jo |
| Klos | Jo | 547200 | Jo |
| Kolonje | Jo | 0 | Jo |
| Konispol | Jo | 0 | Jo |
| Korce | Po | 0 | Jo |
| Kruje | Jo | Jo | Jo |
| Kucove | Jo | Jo | Po |
| Kukes | Jo | 0 | Jo |
| Kurbin | Jo | Jo | Jo |
| Lezhe | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Libohove | Jo | 0 | Jo |
| Librazhd | Jo | 0 | Jo |
| Lushnje | Jo | 0 | Jo |
| Malesi e Madhe | Jo | 0 | Jo |
| Maliq | Jo | 0 | Po |
| Mallakaster | Jo | 0 | Jo |
| Mat | Jo | 0 | Jo |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Mirdite | Jo | 0% | Jo |
| Patos | Jo | Jo | Jo |
| Peqin | Jo | 0 | Jo |
| Permet | Jo | 0 | Jo |
| Pogradec | Jo | 0 | Jo |
| Polican | Jo | Jo | Jo |
| Prrenjas | Jo | Jo | Jo |
| Puke | Jo | 0 | Jo |
| Pustec | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Roskovec | Jo | 0 | Jo |
| Rrogozhine | Jo | 0 | Jo |
| Sarande | Jo | 0 | Jo |
| Selenice | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Shijak | Jo | 0 | Jo |
| Shkoder | Po | 13815000 | Po |
| Skrapar | Jo | 0 | Jo |
| Tepelene | Jo | 0 | Jo |
| Tirane | Po | Nuk ka të dhëna | Po |
| Tropoje | Po | 0 | Jo |
| Ura Vajgurore | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Vau i Dejës | Jo | 0 | Jo |
| Vlore | Jo | Jo | Nuk ka të dhëna |
| Vore | Jo | 0 | Jo |

27.6.2. Rritja e aftësisë për t'u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike në nivel vendor

Grumbullimi dhe mbajtja e të dhënave mbi klimen së bashku me raportet për masat e marra apo të planifikuara për zbatimin dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike; Ulja e shkarkimeve të CO2 nëpërmjet arritjes së objektivave të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, të Eficientësisë së Energjisë dhe të NDC në kuadër të Konventës për ndryshimet klimatike, UNFCCC.

Objektivi specifik: Pyllëzimi i zonave të degraduara përmes riciklimit të destinacionit të burimeve pyjore dhe eliminimi i borxheve të subjekteve që veprojnë në fondin pyjor



Kuadri ligjor kombëtar⁶⁶ për administrimin e pyjeve dhe kullotave rregullon menaxhimin e fondit kombëtar (zonat e mbrojtura), fondin e qeverisjes vendore dhe fondin e subjekteve private në përputhje me kërkesat dhe standardet ligjore të përcaktuara me akte juridike. Ndërsa zonat e mbrojtura menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave të territorit të tyre bazuar në planin e funksionimit në nivelin lokal. 103 punonjës u transferuan në 58 bashki si rrjedhim i VKM (433/2016) për transferimin e këtij funksioni tek Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Rezultatet e një studimi në vitin 2018 për vlerë-

simin e performancës së funksioneve të transferuara rishtazi, përfshirë menaxhimin e pyjeve dhe kullotave⁶⁷, zbuluan se numri i punonjësve vendas të caktuar për këtë funksion është më i ulët se numri (standardi) i përcaktuar me ligj.

Objektivi specifik vlerësohet kundrejt tre treguesve:

- Kapaciteti i bashkisë për hartimin e planit lokal operacional: rreth 59% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar planin lokal operacional për administrimin e fondit pyjor dhe kullotave, sipas ligjit; në 33% të bashkive, plani operacional nuk ishte hartuar ende; 8% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna.
- Rreth 26% e bashkive kanë siguruar të dhëna të sakta për numrin e stafit vendor të caktuar për menaxhimin e fondeve pyjore dhe kullotave përkundrejt standardit të përcaktuar me ligj; ndërsa 74% e bashkive nuk kanë sig-



66 Ligji Nr. 49/2016 “Për fondin kombëtar të administrimit të pyjeve dhe kullotave”

67 Mbështetur nga Helvetas/dldp dhe MFE (2018)

4.11. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës

uruar të dhëna të sakta ose nuk kanë siguruar asnjë të dhënë.

- Mesatarisht, punësimi i bashkive për këtë funksion ishte në nivelin 65% në 2018.

Rreth 66% e bashkive kanë ngritur bazën e të dhënave për subjekte private me aktivitete të lidhura me menaxhimin e fondit pyjor dhe kullotave të bashkisë, ndërsa 25% e bashkive nuk kishin një databazë të tillë funksionale deri në fund të vitit 2018.

Tabela 36

27.7. Pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor

| | Plan Veprimi (PV) vendor për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor | Numri i specialistëve të administrimit të fondit pyjor në bashki ne raport me numrin e specialistëve sipas legjislacionit |
|----------------|--|---|
| Belsh | Po | 1 |
| Berat | Po | 3/5 |
| Bulqize | Jo | 6/26 |
| Cerrik | Jo | 2/3 |
| Delvine | Jo | 6 |
| Devoll | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| Diber | Po | 4/6 |
| Divjake | Po | 1 |
| Dropull | Po | 2 |
| Durrës | Jo | 3/8 |
| Elbasan | Po | 62.00% |
| Fier | Po | 2 |
| Finiq | Po | 4 |
| Fushe Arrez | Jo | 14/25 |
| Gjirokaster | Jo | 1 |
| Gramsh | Po | 60% |
| Has | Jo | 5 |
| Himare | Jo | 9/9 |
| Kamez | Jo | 0 |
| Kavajë | Po | 1 |
| Kelcyre | Jo | 3 |
| Klos | Po | 11 |
| Kolonjë | Po | 7 |
| KonisPol | Po | 1/2 |
| Korçë | Jo | 17/19 |
| Krujë | Po | 6/8 |
| Kuçovë | Jo | 2/3 |
| Kukës | Po | 25 |
| Kurbin | Po | 2/9 |
| Lezhë | Po | Nuk ka të dhëna |
| Libohovë | Po | 1 |
| Librazhd | Po | 9 |
| Lushnjë | Jo | 3 |
| Malesi e Madhe | Po | 14 |
| Maliq | Po | 24/10 |
| Mallakaster | Jo | 2 |
| Mat | Jo | 0 |
| Memaliaj | Nuk ka të dhëna | 1 |
| Mirditë | Jo | 17/35 |
| Patos | Jo | 2 |
| Peqin | Po | 4 |
| Permet | Po | 3 |
| Pogradec | Po | 14/13 |
| Polican | Po | 4/6 |
| Prrenjas | Po | 10/10 |
| Pukë | Po | 15 |
| Pustec | Nuk ka të dhëna | 2 |
| Roskovec | Jo | 0 |
| Rrogozhinë | Po | 1/2 |
| Sarandë | Po | 1 |
| Selenice | Po | 5 |
| Shijak | Po | 2 |
| Shkodër | Po | 56.00% |
| Skrapar | Jo | 23/23 |
| Tepelena | Nuk ka të dhëna | 2 |
| Tiranë | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna |
| TroPoje | Po | 0 |
| Ura Vajgurore | Po | 1/1 |
| Vau i Dejës | Po | 0.63 |
| Vlorë | Jo | 0 |
| Vorë | Po | 2 |

Problemet dhe sfidat

- Kapacitetet e kufizuara financiare dhe teknike për hartimin e planit lokal operacional për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullotave si dhe krijimin e bazës së të dhënave për operatorët privatë që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor të bashkisë.
- Rritja e burimeve njerëzore për administrimin dhe inspektimin e duhur të Fondit Pyjor dhe Kullosor të bashkisë kundrejt standardit siç përcaktohet me ligj.
- Burime të kufizuara financiare për ngritjen në mënyrë konstante të kapaciteteve të punonjësve vendorë që punojnë për fondin pyjor dhe menaxhimin e tij.
- Rekrutimi i specialistit të pyjeve duhet të bëhet sipas kërkesave ligjore.

PËRFUNDIME MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMIN E KLIMËS

Për sa i përket ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, në vitin 2018 janë trajnuar 107 persona nga stafet lokale; Rreth 20% e bashkive nuk kanë marrë pjesë në programe të ngritjes së kapaciteteve për çështje të mjedisit. 75% e bashkive kanë organizuar gjithsej 241 aktivitete për sensibilizimin dhe edukimin e brezave të rinj; rreth 25% e bashkive nuk kanë ofruar të dhëna të sakta ose asnjë të dhënë për veprimtari ndërgjegjësimi në mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës. Çështjet mjedisore duhet të përfshihen në kurrikulën e arsimit fillor. Ministria e Arsimit dhe Ministria e Mjedisit duhet të ndër marrin nisma të cilat përfshijnë tematikat për Mbrojtjen e Mjedisit në kurrikulën mësimore të shkollës njëilloj si me lëndët e tjera të edukatës qytetare, muzikës, etj. Edukimi dhe rritja e përpjekjeve të ndërgjegjësimit duhet të fillojnë që në moshën e hershme të fëmijërisë në mënyrë që të kenë më shumë efekt dhe të jenë më të qendrueshme.

Progress të ngadaltë ka patur për sa i përket hartimit të planit të veprimit për përmirësimin e

cilësisë së ajrit mjedisor në nivelin lokal, 25% e bashkive kanë miratuar Planin të Veprimit Lokal (PVL) për përmirësimin e cilësisë së ajrit, ndërsa 67% e bashkive nuk e kanë ende të zhvilluar PLV; 28% e bashkive kanë integruar masat lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit në dokumentin strategjik të bashkisë përfshirë PBA.

Progres është raportuar në përmirësimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, rreth 49% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar Planin e Menaxhimit të Mbetjeve i cili është pjesë e PBA (vlera e këtij treguesi është më e lartë krahasuar me vitin 2017), ndërsa 46% e bashkive nuk e kishin ende një PMIM të tillë; 64% e bashkive kanë menaxhuar grumbullimin dhe vend depozitimi i mbetjeve të ngurta në deponi sipas planit të tyre të menaxhimit lokal (kjo tregon përmirësim në krahasim me vitin 2017 - në nivelin 43%); rreth 85% e bashkive nuk i riciklojnë mbetjet e bashkisë, dhe rreth 95% e bashkive nuk ishin në gjendje të menaxhojnë mbetjet e bashkisë në dy rryma të veçanta; për vitin 2018 u raportuan nga bashkitë rreth 71 depozime të autorizuara, ose mesatarisht 1 për secilën bashki.

Asnjë përparim i veçantë nuk është arritur në drejtim të forcimit të zbatimit të vendimit të task forcës për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare. 44% e bashkive nuk e kanë krijuar ende task forcën për ndotjen akustike deri në fund të 2018; Në total, 88 inspektorë janë bërë pjesë e task forcës për ndotjen akustike në 2018 me një vlerë mesatare prej 3 inspektorësh për bashki (N = 30); rreth 44% e bashkive nuk kishin asnjë staf lokal në grupin e punës për ndotjen akustike; 7% e bashkive nuk kanë siguruar të dhëna.

Nevojiten më shumë përpjekje në lidhje me përfshirjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës në planet lokale në përputhje me prioritetet dhe objektivat kombëtare, 66% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar planin lokal të masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshi-

4.12. Kapitulli 32: Kontrolli financiar


meve klimatike në përputhje me përparësitë dhe objektivat kombëtare, por rreth 75% e bashkive nuk kanë mbledhur dhe regjistruar ende të dhëna për ndryshimin e klimës. 61% e bashkive nuk morën pjesë në ndonjë trajnim mbi këtë temë.

Progres të ngadaltë ka patur drejt forcimit të kapaciteteve lokale për menaxhimin efektiv të fondit pyjor dhe kullor dhe pyllëzimin e zonave të degraduara përmes riciklimit të destinacionit të burimeve pyjore. Rreth 33% e bashkive nuk kishin hartuar ndonjë plan operacional për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullorave. Mesatarisht, niveli i të punësuarve për këtë funksion në bashki në vitin 2018 ishte rreth 65% krahasuar me standardin për specialistët e pyjeve. Në lidhje me bazën e të dhënave për subjektet private me aktivitete të lidhura me menaxhimin e fondit pyjor dhe kullorave të bashkisë, rreth 25% e bashkive nuk kishin ende një databazë të tillë funksionale deri në fund të vitit 2018.

4.12. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Buxheti vjetor për vitin 2018 përfshirë të ardhurat vetjakee veta të qeverisë vendore, transferimet e pakushtëzuara, transferimet specifike) ishte 49.6 miliardë lekë, ose 10.4% e buxhetit të shtetit ose 3.1% e PBB-së. Buxheti vendor për vitin 2018 ishte 7% më i lartë se ai i vitit 2017. Fondi i transfertwsw pakushtwzuar u rrit në 23,4 miliardë lekë në vitin 2018. FRZH vazhdon të jetë burimi i vetëm më i rëndësishëm i financimit për projekte të mëdha infrastrukturore në nivelin lokal; 2% e arkëtimit nga tatimi mbi të ardhurat personale të vitit 2018 ishte në pritje; ndryshimet në kuadrin rregullator mbi taksën e pasurisë (një sistem i bazuar në vlerën e tregut të pronës) për taksën mbi ndërtesat janë të rëndësishme për të ardhurat e veta të bashkive, por ende nuk janë funksionale⁶⁸.

MFE ka zbatuar Mekanizmin e Planifikimit




Financiar, një instrument që ka sjellë harmonizimin e klasifikimit të shpenzimeve të bashkisë sipas programeve buxhetore, duke përfshirë tabelat e harmonizuara të raportimit, ndërsa sistemi i ndihmës online i vendosur në dispozicion për NJQV-të nga MFE dhe aktivitetet e trajnimit në menaxhimin e financave publike ka ndikuar në përmirësimin e kapaciteteve teknike të administratave vendore gjatë vitit 2018.

Të ardhurat e qeverisë vendore nga taksat dhe tarifatat lokale janë rritur me 19% në nivel kombëtar, në krahasim me vitin 2017, megjithëse ka pabarazi midis performancës individuale të bashkive. Rreth një e treta e bashkive ka mbledhur më pak të ardhura në vitin 2018 kundrejt vitit 2017, ndërsa 50% e bashkive kanë parë një ulje të të ardhurave

Taksat e përbashkëta: 1.3 miliardë lekë në vitin 2018 krahasuar me 1.2 miliardë lekë në vitin 2017.

Transferet e pakushtëzuara dhe specifike: 24.8 miliardë lekë në vitin 2018 krahasuar me 21.9 miliardë lekë në vitin 2017.


Të ardhurat për taksën e biznesit të vogël



rave në nivelin nga 15% në 60% më pak se në 2017 (bashkitë e vogla në madhësi dhe popullsi). Rreth 2/3 e bashkive kanë mbledhur më shumë të ardhura në vitin 2018 në krahasim me 2017 duke filluar nga 10% deri në 79%. Një pjesë e këtij ndryshimi në rritje dhe rënie vjen nga taksa e ndikimit të infras-

ishin në të njëjtin nivel në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 (në 0.3 miliardë lekë) - kjo taksë ka pësuar më shumë reforma sesa çdo taksë tjetër e pushtetit vendor.

Pas një periudhe rënie tre-vjeçare, 2009-



trukturë e cila është e lidhur me kërkesat për ndërtim në territorin e bashkisë⁶⁹.

Të ardhurat e vetëqeverisjes vendore ishin 23.8 miliardë lekë në 2018 krahasuar me 20.3 miliardë lekë në vitin 2017.

2012, shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur në terma të moderuara në 2012-2015. Pas zbatimit të RAT dhe transferimit të funksioneve të reja (2016), shpenzimet e qeverisë

lokale në vitin 2016 u rritën me 28%, e ndjekur nga një normë prej 7% në 2017 dhe 2018⁷⁰.

Shpenzimet e stafit ishin rreth 42% të shpenzimeve totale, gjë që pasqyron pagat e stafit të transferuar për pesë funksionet e reja: arsimin, ujitje dhe kullimin (bujqësi), rrugët rurale, menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, qendrat embrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri. Shpenzimet operacionale janë rritur pak në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 (në nivelin 29% të shpenzimeve të qeverisjes vendore). Shpenzimet për subvencione ose përdorime të tjera për të mbuluar funksione të tjera vendore të rëndësishme kanë pësuar disa ndryshime të vogla.

Shpenzimet kapitale arritën në 14.2 miliardë lekë ose 29% të shpenzimeve të qeverisjes vendore (ose 2 miliardë lekë më pak se në vitin 2017)⁷¹.

Problemet dhe sfidat

- Bashkitë duhet të planifikojnë për një periudhë afatgjatë bazuar në dokumentet e tyre strategjike të zhvillimit
- Fond i pamjaftueshëm për projekte të mëdha infrastrukturore
- Burime të kufizuara financiare për shlyerjen e borxheve të papaguara ndaj palëve të treta
- Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe profesionale për audite të brendshme të rregullta dhe kontrole nga KB.

Një nga problemet të hasura gjatë përgatitjes së këtij raporti ishte mospërputhja e lartë midis të dhënave të raportuara nga bashkitë dhe të dhënave të raportuara nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në financimin vjetor të qeverisë vendore. Kjo tregon sërish aftësi të dobëta të bashkive për të ruajtur dhe raportuar të dhënat, shoqëruar edhe me mungesën e përgjegjësisë nga departamentet bashkiake për t'i kushtuar vëmendje dhe për tu përfshirë në mënyrë aktive duke mbështetur dhe kolegët e njësisë të integritetit evropian gjatë procesit të raportimit. Seksioni i kontrollit financiar ishte edhe pjesa ku problemet e tilla u vunë re në mënyrë të vazhdueshme nga raportimet e bashkive.

PËRFUNDIME MBI KONTROLLIN FINANCIAR

Kapacitetet njerëzore dhe teknike të administratës vendore janë përmirësuar në menaxhimin e shpenzimeve publike, duke përfshirë kapacitetet e planifikimit të buxhetit dhe ekzekutimit e buxhetit. Në nivelin kombëtar, të ardhurat e qeverisë vendore nga taksat dhe tarifat vendore janë rritur me 19% në krahasim me vitin 2017, por ka paparazi midis performancës individuale të bashkive. Rreth një e treta e bashkive ka mbledhur më pak të ardhura në vitin 2018 kundrejt vitit 2017; dy të tretat e bashkive kanë mbledhur më shumë të ardhura në vitin 2018 në krahasim me 2017 duke filluar nga 10% në 79%. Shpenzimet e qeverisjes vendore në vitin 2018 u rritën me 7% krahasuar me vitin 2017.

70 Burimi: Raporti Vjetor i vitit 2018 mbi Financat Publike Vendore

71 Raporti Vjetor i vitit 2018 mbi Financat Publike Vendore

5 REKOMANDIME

Integrimi në BE është sfidues dhe kërkon shumë përpjekje nga administrata qendrore dhe vendore. Në këtë kuadër, raporti synon të japë disa rekomandime lidhur me gjetjet e raportit të vlerësimit të vitit 2018. Këto rekomandime do ta ndihmojnë pushtetin vendor dhe atë qendror që të përballen me sfidat që dalin nga procesi i integrimit evropian, si dhe donatorët në mënyrë që ata të përcaktojnë përparësitë e fushave të pranisë dhe ndihmës së tyre në Shqipëri. Është koha për të rritur vetëdijësimin e NJQV-ve për rëndësinë e pushtetit vendor në procesin e integrimit në BE në mënyrë që të plotësohen kriteret e anëtarësimit, për të cilat ka përgjegjësi pushteti vendor, në kuadër të funksioneve të përcaktuara në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

A. KRITERET POLITIKE

REKOMANDIME PËR DEMOKRACINË

Forcimi i kapaciteteve të pushtetit vendor - trajnimet:

- Realizmi i shpeshtë i Vlerësimit të Nevojave për Trajnim në mënyrë që të plotësohen nevojat dhe mungesat reale të administratës për trajnim.
- Hartimi i kurrikulave specifike të trajnimit dhe i programeve të trajnimit të përshtatura me nevojat e administratës në çdo nivel (niveli udhëheqës, drejtues dhe specialist). Trajnimet duhet të përfshijnë edhe anëtarët e Këshillave Bashkiakë, veçanërisht në fillim të mandatit të ri të Kryetarit të Bashkisë dhe të Këshillit Bashkiak.
- Trajnimet të mos jenë vetëm teorike, por të jenë edhe trajnime të drejtpërdrejta në punë.
- Zhvillimi i moduleve të trajnimit të mësimi elektronik si një instrument efikas për të përfshirë të gjithë administratën vendore.
- Bashkitë duhet të planifikojnë fonde përkatëse në Programin e tyre Buxhetor Afatmesëm për trajnimin e stafit në mënyrë që të rriten kapacitetet e tyre.
- Donatorët dhe strukturat e tjera përkatëse duhet të sigurojnë buxhet të

5. REKOMANDIME

mjaftueshëm për realizimin e këtyre trajnimeve.

- Forcimi i sistemit meritokratik në administratën vendore për mënyrën se si punon dhe si funksionon:
 - Forcimi i procedurave transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të performancës së punonjësve bazuar në indikatorë të caktuar.
 - Forcimi i menaxhimit të burimeve njerëzore për mënyrën se si trajnimeve dhe manualeve të mëtejshme, ndihmës së vazhdueshme për bashkitë që përballen me vështirësi në zbatimin e procedurave të burimeve njerëzore dhe për mënyrën se si ndihmës për bashkitë që ende nuk e kanë asimiluar akoma përdorimin e platformës së burimeve njerëzore.

Rritja e përgjegjshmërisë së pushtetit vendor - mekanizmat e kërkesave/ankesave

- Bashkitë dhe Njësitë Administrative duhet të mbështeten në konsolidimin e sistemit të Zyrës me një Ndalesë si një mekanizëm i rëndësishëm që regjistron çdo kërkesë/ankesë dhe monitoron të gjithë ecurinë e procedurës deri në momentin kur kërkesat e qytetarëve trajtohen siç duhet.
- Bashkitë duhet të sigurojnë gjithashtu

tu edhe mekanizmat e tjerë për qytetarët në mënyrë që ata të kenë formë të ndryshme aksesit/komunikimit për të trajtuar shqetësimet e tyre (kërkesa/ankesa). Këto mekanizma duhet të jenë të aksesueshëm në mënyrë të pakufizuar për çdo person që duhet të trajtojë një ankesë.

- Çdo mekanizëm i krijuar duhet të monitorohet në mënyrë që të përmbushë plotësisht pritshmëritë e qytetarëve në drejtim të trajtimit të ankesave të tyre.
- Është e rëndësishme gjithashtu që të forcohet vullneti politik, pasi ai është thelbësor për zbatimin e suksesshëm të mekanizmit të ankesave.
- Për të pasur një llogaridhënie më të madhe, bashkitë duhet të sigurojnë linjat e llogaridhënies. Llogaridhënia vertikale – nga lart poshtë midis institucioneve qendrore, llogaridhënia horizontale ndërmjet institucioneve të tjera të përfshira si gjykatat, avokati i popullit, agjencitë anti-korrupsion, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, etj., dhe llogaridhënia nga poshtë lart, duke siguruar përfshirjen e qytetarëve, mediave dhe organizatave qytetare.
- Gjithashtu bashkitë duhet të forcojnë mekanizmat e tyre të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të rrisin nivelin e llogaridhënies së tyre.

Rritja e transparencës së pushtetit vendor

- Bashkitë duhet të forcojnë aftësitë e tyre për të përdorur dëgjuesat publike dhe për të trajtuar mirë të gjitha rekomandimet përkatëse të qytetarëve kur marrin një vendim. Bashkia duhet të trajtojë tre çështje si më poshtë vijon:
 - Si të sigurohet pjesëmarrja e gjerë e të gjitha grupeve dhe palëve të interesuara në dëgjuesat publike?
 - Si të informohen pjesëmarrësit dhe komuniteti i gjerë për çështjet që do të diskutohen?

- Si të demonstrohet që rekomandimet e publikut trajtohen siç kërkohet?
- Bashkitë kanë nevojë për mbështetje për të gjetur mënyra të suksesshme për të përfshirë qytetarët në politik-bërje dhe në formësimin e komuniteteve. Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje duhet të jetë një proces me shpërndarje gjeografike në mënyrë që t'u jepet akses edhe qytetarëve që jetojnë në zona të largëta që edhe ata të ngrenë zërin e tyre.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet organizatave vendore të shoqërisë civile dhe bashkive me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe motivimin e tyre për të qenë pjesë e vendimeve vendore.
- Rekomandohet të forcohen mekanizmat e monitorimit, të fillë si Këshilli Bashkiak, strukturat e komunitetit dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet trajtimi i të gjitha rekomandimeve përkatëse gjatë dëgjësive publike.
- Dëgjësat publike duhet të kalojnë nëpër disa faza në mënyrë që të jenë të efektshme, sepse meqenëse ky është një mekanizëm i kërkuar me ligj shumica e bashkive e respektojnë atë zyrtarisht pa marrë parasysh kërkesat e komunitetit. Këto faza janë si më poshtë vijon:
 1. Identifikimi i grupeve të ndryshme të shënjestëruara dhe problemet/kërkesat e tyre;
 2. Vlerësimi i kërkesave të paraqitura, me qëllim harmonizimin e tyre me strategjitë afatmesme dhe vizionin zhvillimor të bashkive;
 3. Përzgjedhja e kërkesave/çështjeve që duhet të trajtohen në dokumentet e planifikimit të bashkisë;
 4. Përfshirja e kërkesave të tyre në planifikimin dhe dokumentet e zhvillimit;
 5. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve/kërkesave të komunitetit. Kjo fazë nënkupton krijimin e strukturave

monitoruese me përfaqësues të grupeve të interesit dhe të bashkive.

- Përveç dëgjësive publike, në kuadrin e transparencës dhe llogaridhënies, një nga instrumentet që mund të përdoren nga bashkitë është krijimi i një baze të dhënash të standardizuar dhe të unifikuar që mund të përfshijë statistika të ndryshme të rëndësishme për qytetarët dhe për të gjitha palët e interesuara dhe publikimi i tyre në mënyrë periodike.

Zyra me një ndalesë

- Duke pasur parasysh rëndësinë dhe përfitimet e zyrës me një ndalesë, rekomandohet mbështetje dhe rritje e vazhdueshme e kapaciteteve vendore në mënyrë që të sigurohen shërbime efikase dhe të ndërtohet besimi tek administrata dhe qytetarët, si dhe të konsolidohen procedurat e zyrës me një ndalesë si praktika të përditshme.
- Është e rëndësishme të konsolidohet zyra me një ndalesë si një strukturë brenda bashkive duke rishikuar strukturat e tyre organizative dhe hartimin e rregulloreve të brendshme duke përshtatur procedurat e zyrës me një ndalesë si praktika të brendshme.
- Rishikimi i shërbimeve administrative (veçanërisht faza e protokollit, e cila është një fazë vendimtare që do të lehtësonte dixhitalizimin e shërbimeve dhe do të sillte akses pa shkresa) me qëllim lehtësimin e tyre të mëtejshëm dhe rishikimin e bazës së tyre ligjore në mënyrë që të konsolidohet aplikimi i tyre në sistemin e zyrës me një ndalesë.
- Dhënia e ndihmës në infrastrukturën e pajisjeve për të rritur efikasitetin e sistemit të zyrës me një ndalesë, sepse ka mungesë të infrastrukturës në shumicën e NJQV-ve.
- Rekomandohet të sigurohet funksionimi i plotë i të gjitha Njësive Administrative si pika shërbimi të zyrës me një ndalesë dhe

të rriten kapacitetet e tyre në lidhje me asimilimin e sistemit dhe të procedurave të reja administrative për t'i shërbyer më mirë qytetarëve.

- Standardizimi dhe unifikimi i procedurave administrative për ofrimin e shërbimeve në nivel vendor. Ri-optimizimi i proceseve të punës me qëllim lehtësimin e tyre, reduktimi i burokracisë dhe rritja e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve.
- Rritja e kapaciteteve të administratës vendore në mënyrë që të kuptohen plotësisht funksionalitetet dhe operimi i zyrës me një ndalesë dhe të përdoret siç duhet:
 - Punonjësit e sporteve pritëse për qytetarët, si pika e parë e kontaktit, duhet të kenë një njohuri të gjerë për të gjitha shërbimet vendore. Ata duhet të përmirësojnë gjithashtu edhe etikën dhe të kenë një komunikim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me qytetarët për t'u përgjigjur më mirë kërkesave të tyre.
 - Punonjësit e zyrave mbështetëse në asimilimin e procedurave të reja administrative dhe në lehtësimin e përdorimit të sistemit.
- Pasi të zbatohet sistemi i zyrës me një ndalesë, duhet të ekzistojë mundësia për të integruar shërbimet në nivel vendor (modeli i Zyrës me një Ndalesë) dhe shërbimet në nivelin kombëtar (modeli ADISA) në një vend (zyrë) për t'u shërbyer më mirë qytetarëve. Të gjitha shërbimet do të jenë lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët, si dhe cilësia dhe standardi i tyre do të rriten.

Rritja e kapaciteteve të bashkisë për shqyrtimin e raporteve të Avokatit të Popullit

- Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me bashkitë dhe të krijohen mekanizma «detyrues» në mënyrë që bashkitë dhe

të gjitha institucionet e tjera publike t'i marrin parasysh këto rekomandime të rëndësishme. Bashkëpunimi efikas institucional lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve është një tregues i mirë i respektimit të parimeve të qeverisjes së mirë në nivel vendor.

- Rekomandohet që përveç nivelit të bashkëpunimit, Qeveria Shqiptare të forcojë rolin monitorues të Parlamentit Shqiptar për të monitoruar sistematikisht nivelin e zbatimit të rekomandimeve.
- Bashkitë duhet të rrisin kapacitetet e tyre për hartimin e përgjigjeve zyrtare në nivelin e kërkuar drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.
- Duhet të ngrihet një mekanizëm raportimi ose një sistem i unifikuar në internet për të siguruar mbledhjen e informacionit të saktë dhe të detajuar nga bashkitë.

Konsolidimi i shoqërisë civile në nivelin vendor

- Forcimi i shoqërisë civile në nivelin vendor në shumicën e bashkive për rritur rolin e tyre mbikëqyrës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të mbështetur, për të promovuar dhe për të trajtuar më mirë çështje të ndryshme vendore për grupe të ndryshme, veçanërisht në qytetet e vogla dhe të mesme ku OShC-të nuk janë të pranishme.
- Qeveria dhe donatorët duhet të inkurajojnë OShC-të vendore përmes projekteve të ndryshme dhe instrumenteve financiare në mënyrë që ato të jenë më aktivë për sa i takon luajtjes së rolit të tyre dhe të rrisin vetëdijësimin e shoqërisë civile për fuqinë dhe ndikimin që ajo ka në politikën vendore.
- Është e nevojshme të gjenden mekanizma gjithëpërfshirës, të rritet besimi i shoqërisë civile dhe aktivizimi i saj në vendimmarrjen vendore së bashku me rritjen e kapaciteteve të tyre në mënyrë që

t'u mundësohet atyre që të komunikojnë shqetësimet e tyre dhe shqetësimet e komunitetit në mënyrë efikase dhe të besueshme.

REKOMANDIME PËR SHPETIN E SË DREJTËS

- Hartimi i Planeve Vendore Kundër Korrupsionit për secilën bashki, si një objektiv i parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 me qëllim që të identifikohen zonat specifike që janë subjekt i korrupsionit në bashki, hartimi i kodit të sjelljes dhe raportimi i korrupsionit jo vetëm nga punonjësit e bashkisë, dhe sjellja e një vizioni për luftimin e korrupsionit brenda bashkisë. Është e rëndësishme të angazhohen bashkitë nëpërmjet alokimit të zërave të veçantë buxhetorë për zbatimin e këtyre planeve në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i tyre.
 - Rritja e kapaciteteve të bashkive për hartimin e planeve vendore kundër korrupsionit. Kapacitetet duhet të rriten përmes trajnimeve përkatëse nga Ministria e Drejtësisë.
 - Bashkitë duhet të ndërtojnë një sistem për të raportuar, ndjekur dhe zgjidhur rastet e korrupsionit. Ato duhet të hartojnë gjithashtu edhe disa rregulla të brendshme për të ndjekur rreziqet e korrupsionit në nivelin vendor, si dhe të vendosin disa sanksione për shkeljet administrative për të zvogëluar rastet e korrupsionit.
 - Rritja e kapaciteteve administrative vendore përmes trajnimeve/seminareve për çështjet anti-korrupsion dhe të legjislationit në fuqi.
 - OShC-të vendore duhet të rrisin rolin e tyre në luftën kundër korrupsionit, të rrisin njohuritë dhe të përmirësojnë kapacitetet e tyre në funksion të monitorimit dhe rritjes së vetëdijësimit të komunitetit dhe administratës vendore për çështjet anti-korrupsion.
- ### REKOMANDIME PËR TË DREJTAT E NJERIUT
- Shtimi i njohurive dhe rritja e vetëdijes për standardet e të drejtave të njeriut për zyrtarët vendorë përmes trajnimeve/seminareve të ndryshme.
 - Rritja e bashkëpunimit të bashkive dhe OShC-ve që kanë në fokus të drejtat e njeriut.
 - Ngritja e qendrave të banimit për raste urgjente dhe sigurimi i banesave sociale për individët në nevojë, duke siguruar të drejtën e strehimit për çdo person.
 - Për të mundësuar zgjidhjen e tyre institucionale duke reflektuar përgjegjësinë e rritur të qeverisë shqiptare duhet të trajtohen çështjet e mëposhtme:
 - Rritja e besimit të qytetarëve në sistemin e referimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sepse megjithëse ekziston një sistem i mirë dhe funksional, shpesh janë vërejtur përgjigje formale dhe shmangie nga kompetencat institucionale.
 - Ekziston një numër i madh çështjesh me interes publik që përfaqësohen para gjykatave vendase, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Strasburgut, në lidhje me sa më poshtë vijon: shkeljet e të drejtave të njeriut për ujë, për sigurimin e kujdesit të duhur shëndetësor, për një mjedis i pastër dhe të shëndetshëm, jo-diskriminimi dhe barazia, e drejta e votës, e drejta për të mos iu nënshtruar torturave, trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese, e drejta e kompensimit në raste të fatkeqësive natyrore, e drejta për informim, konsultime publike, etj.
 - Shkelje e parimit të transparencës dhe qeverisjes së hapur për shkak të nivelit të zbatimit të ligjit për njoftimin publik dhe konsultimin nga institucionet në nivel qendror dhe vendor, duke mos respektuar kërkesat për afatet dhe procedurat e konsultimit publik. Kjo do të thotë që institucionet publike kanë ende punë për të bërë për të zbatuar të gjitha kërkesat e ligjit.

B. KRITERET EKONOMIKE

REKOMANDIME PËR EKZISTENCËN E NJË EKONOMIE FUNKSIONALE TREGU

- Roli i bashkive në zhvillimin ekonomik duhet të mbështetet jo vetëm nga Planet e Përgjithshme Vendore, të cilat përqendrohen kryesisht tek planifikimi dhe rregullimi. Sigurimi i jetueshmërisë së një zone duke rregulluar se ku, kur dhe si mund të zhvillohen aktivitetet e biznesit; por edhe nga Planet Sektoriale Vendore, në mënyrë që të mbështesin zhvillimin e ekonomisë vendore dhe bazën e saj të biznesit përmes programeve dhe shërbimeve që ndihmojnë firmat të punojnë më mirë dhe lehtësojnë investimet në zonën vendore. Ekziston një nevojë e madhe për ndihmë në lidhje me hartimin e planeve të tilla që shkon përtej planifikimit të territorit, por që integron zhvillimin ekonomik me sektorë të tjerë, siç janë industria, ndërmarrjet, bujqësia dhe agro-përpunimi, turizmi, etj., brenda një territori.
- Bashkitë duhet të krijojnë një axhendë të zhvillimit të turizmit, pasi kjo industri është një nga disa strategjitë aktuale të mundshme për zhvillimin ekonomik, veçanërisht në zonat rurale. Turizmi mund të konsiderohet gjithashtu edhe si një mundësi për zhvillimin vendor të një zone, qoftë vetëm, qoftë si plotësues i aktiviteteve të tjera ekonomike.
- Të gjitha bashkitë duhet të hartojnë Planet e Zhvillimit të Turizmit me orientime dhe masa të qarta, të mbështetura nga veprime afatshkurtra dhe afatmesme, me qëllim trajtimin e sfidave të spikatura, si dhe të udhëzojnë dhe koordinojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit nisur nga këndvështrimi i planifikimit të përdorimit të tokës brenda një zone.
- Bashkitë duhet të gjejnë instrumente për të inkurajuar biznesit e reja të llojit start-up, nismat vendore dhe inkubatorët e biznesit. Bashkitë duhet të përdorin gjithashtu edhe fondin social për të integruar grupet në nevojë dhe për t'i përfshirë ato në nismat e zhvillimit vendor. Fondi social është një mekanizëm i ri financiar që siguron shërbimet sociale në secilën bashki.
- Bashkitë duhet të gjejnë mekanizma vendorë për të forcuar lidhjen e sektorit të biznesit vendor me këshillin bashkiak për çështje biznesi, si dhe me aktorët e tjerë krpoorë.
- Bashkitë duhet të krijojnë një mjedis biznesi më mbështetës dhe konkurrues përmes udhëheqjes dhe hartimit të politikave. Ato duhet të promovojnë gjithashtu edhe nisma të ndryshme pro-biznesit.
- Investimi në infrastrukturën bazë që do të ulë koston e biznesit dhe do të rrisë lehtësinë e të bërit biznes.
- Përmirësimi i shërbimeve vendore për komunitetin e biznesit duke lehtësuar procedurat administrative përmes sistemit të zyrës me një ndalesë.
- Bashkitë që kanë monumente dhe pika të trashëgimisë kulturore duhet të mbështeten për të realizuar vlerësimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet vlerësimit të situatës në secilin prej vendeve të trashëgimisë kulturore për sa i përket lehtësive që i shërbejnë nevojave dhe shërbime të turistëve në mënyrë që të thithin më shumë turistë dhe t'u mundësojnë atyre ofrimin e shërbimeve cilësore;

C. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Rekomandime të përgjithshme në lidhje me procesin e integritimit në BE:

- Mbështetja e NJQV-të për të rritur kapacitetet e tyre në mënyrë që ato të përfitojnë nga fondet e BE-së, veçanërisht bashkitë e mesme dhe të vogla, me anë të trajnimeve dhe mbështetjes gjatë gjithë ciklit të projekteve të financuara nga BE-ja.
- Vlerësimi i performancës së bashkive në kuadrin e procesit të integritimit evropian.
- Rritja e kapaciteteve të Njësive të reja të Integritimit Evropian dhe mbështetja e tyre për të realizuar në mënyrë efektive fushatën e shpërndarjes së informacionit për procesin e integritimit në BE në nivelin vendor (si për administratën vendore ashtu edhe për qytetarët) në mënyrë që të rrisin njohuritë dhe vetëdijësimin për përgjegjësitë në këtë proces.

REKOMANDIME PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

- Përshpejtimi i transferimit të të gjitha funksioneve dhe kompetencave nga ish Drejtoritë Bujqësore tek strukturat e krijuara për sektorin e bujqësisë në bashki, sipas ligjit të vetëqeverisjes vendore.
- Forcimi i strukturave të sektorit të bujqësisë në bashki dhe organizimi i tyre me specialistë të arsimit përkatës të kësaj fushe.
- Rritja e aksesit në informacionin që bashkia duhet të sigurojë në lidhje me sektorin bujqësor duke përdorur mjete informacioni për të gjitha kategoritë e popullsisë së angazhuar në këtë sektor.
- Përdorimi i një sistemi informimi për informacionin bujqësor dhe zyrat këshilluese bujqësore për fermerët. Krijimi i një baze të dhënash për sektorin bujqësor jo vetëm që do të ndihmonte bashkitë për monitorimin e sektorit, por do të pasqyronte gjithashtu edhe më qartë situatën duke mundësuar

parashikime dhe strategji të vlefshme për gjetjen dhe orientimin e tregjeve në favor të fermerëve dhe grupeve të interesit.

- Bashkitë fqinje duhet të koordinohen në funksion të zbatimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës bujqësore duke siguruar koherencë dhe përparësi të ndërhyrjeve në infrastrukturë sipas ndikimeve që ata do të kenë në territorin e dy ose më shumë bashkive.
- Rritja e kapaciteteve në lidhje me administrimin e skemave financiare të granteve përmes kryerjes së trajnimeve/seminareve për specialistët e sektorit të bujqësisë në bashki.
- Bashkitë duhet të informojnë rregullisht të gjithë fermerët dhe grupet e interesit për skemat e financimit të granteve, duke siguruar akses të barabartë për të gjithë palët e interesuara, së bashku me koordinimin me qeverinë qendrore në mënyrë që atyre t'u ofrohet ndihmë dhe mbështetje për të aplikuar me sukses në skemat e granteve.
- Vetëdijësimi i fermerëve, grupeve të interesit dhe shoqatave që punojnë në sektorin e bujqësisë me qëllim që të jenë më aktiv dhe të marrin pjesë në vendimmarrjen bashkiake.
- Hartimi i kriterëve për decentralizimin asimetric të çështjeve të ndryshme në interes të qeverisë qendrore në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural në mënyrë që ky funksion të realizohet më mirë.

REKOMANDIME PËR SIGURINË USHQIMORE, POLITIKAT VETERINARE DHE FITOSANITARE

- Bashkitë duhet të ndërmarrin fushata për të rritur vetëdijësimin dhe për t'i orientuar konsumatorët drejt tregjeve të monitoruara dhe të licencuara.
- Identifikimi i tregjeve joformale, forcimi i kontrolleve nga strukturat bashkiake dhe koordinimi me strukturat shtetërore përkatëse siç është policia e shtetit për këto tregje informale me qëllim përmirësimin e kushteve të tregtimit, promovimit të konkur-

rencës së ndershme dhe të kontributit në procesin e zhvillimit ekonomik vendor.

- Krijimi i sa më shumë mundësive për tregtarët, për shembull, krijimi i tregjeve të lëvizshme dhe të përkohshme ose ditore, ku tregtarët mund të shesin produktet e tyre sipas një kalendarit të caktuar dhe zonave të veçanta. Kjo do të jetë një mundësi më e madhe për tregtarët në mënyrë që ata të shesin produktet e tyre dhe një mundësi që blerësit të kenë më shumë akses në tregje. Kjo mund të kontribuojë gjithashtu edhe në uljen e evazionit tatimor dhe në rritjen e të ardhurave të bashkisë.
- Organizimi i trajnimeve/seminareve nga ekspertë të kësaj fushe me qëllim rritjen e njohurive të inspektorëve bashkiak për kontrollin e ushqimit.
- Bashkitë duhet të identifikojnë (përmes ndërmarrjes së një studimi të përshtatshëm) kapacitetet e prodhimit (bizneset) që vepron në territorin e tyre në mënyrë që të mbështesin iniciativën qendrore të qeverisë shqiptare për lehtësimin e import-eksportit. Bizneset shqiptare kanë dëshmuar domosdoshmërinë e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale me vendet e rajonit për unifikimin dypalësh të çertifikatave bujqësore për produkte të ndryshme. Sigurisht, kjo politikë duhet të ndërmerret nga institucionet qendrore, por do të reflektohet në forcimin e kompetencave të kontrollit të bashkive.
- Hartimi i kriterëve për decentralizimin asimetric të çështjeve të ndryshme në interes të qeverisë qendrore në lidhje me sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare në mënyrë që ky funksion të realizohet më mirë.

REKOMANDIME PËR POLITIKËN E TRANSPORTIT

- Përcaktimi i akteve rrugore me përparësi sipas përfitimeve që u sjellin qytetarëve dhe ndërhyrja në rehabilitimin ose ndërtimin e këtyre segmenteve rrugorë.
- Bashkitë duhet të promovojnë konkurrencën midis operatorëve të transportit, duke promovuar kështu arritjen e standardeve më të

larta të cilësisë së transportit publik.

- Zbatimi i ndëshkimeve të rrepta për shkeljet administrative që mund të kryhen nga operatorët e linjave të transportit.
- Është e rëndësishme që ministria përgjegjëse për transportin të ndërmarrë iniciativë për vendosjen e disa standardeve për përgatitjen e hartave të transportit urban në të njëjtin format në secilën bashki.
- Inkurajimi i bashkive që të publikojnë oraret e autobusëve në çdo stacion autobusi dhe hartën e transportit në mënyrë që të rrisin informimin e qytetarëve dhe të ndikojnë në cilësinë e shoqërive private të transportit urban.
- Ndërtimi i stacioneve multimodale siç parashikohet në Planet e Përgjithshme Vendore të aprovuara nga secila bashki.
- Hartimi i kriterëve të decentralizimit asimetric të politikave të transportit në interes të qeverisë qendrore për ta realizuar më mirë këtë funksion.

REKOMANDIME PËR ENERJINË

- Bashkitë duhet të ndërmarrin fushata informuese për qytetarët në lidhje me efikasitetin e energjisë duke rritur vetëdijësimin dhe duke inkurajuar miratimin e modeleve më efikase të konsumit të energjisë.
- Zbatimi i kredive të buta dhe skemave të tjera financiare për të ndihmuar qytetarët që të ndërhyjnë në shtëpitë e tyre në mënyrë që të rritet efikasiteti i energjisë.
- Zbatimi i politikave fiskale për subjektet private që marrin përsipër kostot e tyre të ndërhyrjes për të rritur efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative të energjisë.
- Hartimi i kriterëve të decentralizimit asimetric të çështjeve të ndryshme që lidhen me energjinë në interes të qeverisë qendrore.

REKOMANDIME PËR TAKSAT

- Identifikimi i dobësive të sistemit tatimor dhe identifikimi i mundësive për përmirësim.

- Forcimi, përmirësimi dhe qartësimi i administrimit dhe i politikave vendore për të ardhurat tatimore.
- Identifikimi i mekanizmave se si të promovohen sisteme dhe administrata tatimore të efektshme, efikase dhe legjitime të qeverisjes vendore.
- Rritja e autonomisë fiskale të qeverisjes vendore, që do të thotë më shumë autonomi për njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me mbledhjen e të ardhurave nga burimet e tyre. Aftësia e njërive të vetëqeverisjes vendore për të mbledhur të ardhura nga burimet e veta vendore përmes taksave siguron llogaridhënie të shtuar ndaj qytetarëve.
- Rritja e të ardhurave të NJQV-ve duhet të përqendrohet në katër taksat e fuqishme dhe efikase me bazë të gjerë:
 - Të ardhurat personale, të vlerësuara mbi një bazë më gjithëpërfshirëse;
 - Të ardhurat nga biznesi, të planifikuar për të mbështetur rritjen ekonomike;
 - Qiratë e burimeve natyrore dhe të tokës; dhe
 - Konsumi privat.
- Pushteti vendor duhet të jetë më transparent për të treguar nëse taksat vendore po përdoren apo jo për të financuar shpenzimet që i përgjigjen nevojave dhe preferencave të qytetarëve.
- Rishikimi dhe ri-përcaktimi i kuadrit ligjor për taksat dhe tarifatat vendore, veçanërisht për taksën e pasurisë, taksën e tokës urbane, taksën e bazuar në vlerën e ndërtesave, etj.
- Rritja graduale e përqindjes së PBB-së për transfertën e pakushtëzuar që i shpërndahet NJQV-të nga pushteti qendror si nevojë për të rritur financimin e pushtetit vendor.
- Rishikimi i alokimit të transfertës së kushtëzuar nga buxheti i shtetit për të rritur efikasitetin dhe financimin e projekteve strategjike vendore.
- Qeveria duhet të krijojë mjete më transparente për të trajtuar idetë e komunitetit në lidhje me sistemin e taksave duke

shtrirë faqet e internetit dhe duke zhvilluar më tej përdorimin e tij.

REKOMANDIME PËR POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMIN

Stafi dhe trajnimet

- Bashkitë duhet të sigurojnë një staf të mjaftueshëm sipas legjislacionit në fuqi për të përmbushur të gjitha nevojat e grupeve në nevojë dhe duhet të rrisin kapacitetet e tyre përmes trajnimeve të vazhdueshme për problemet e grupeve të ndryshme të shënjestëruara në mënyrë që të ofrojnë shërbime sociale me cilësi dhe efikasitet.
- Punonjësit e NJMF-ve (Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve) në secilën bashki duhet të jenë të specializuar dhe të kenë arsimim dhe përgatitje të mirë për trajtimin e fëmijëve dhe familjeve (punonjës social ose psikolog) dhe duhet të trajnohen për ndjekjen e rasteve specifike si dhe për sistemin e referimit.

Planet sociale

- Rishikimi i planeve të para sociale vendore me qëllim harmonizimin e planeve sociale me kuadrin ligjor dhe me strategjitë kombëtare të aprovuara.
- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave reale për secilin grup të marginalizuar dhe përfshirja e të gjithë këtyre grupeve në planet sociale me qëllim që ato të hartohen në mënyrë realiste. Bashkitë duhet të marrin parasysh edhe trajtimin e problemeve/nevojave të territoreve të tyre rurale në planet sociale.
- Rishikimi i planeve sociale gjatë fazave të zbatimit të tyre, pasi planet sociale që kanë objektiva afatgjata duhet të jenë të matshme dhe të arritshme, ndërkohë që ato duhet të zërthehen në aktivitete dhe programe dhe të përqendrohen në efikasitetin e shërbimeve.

Shërbimet sociale

- Bashkitë duhet t'i japin përparësi edhe mundësisë së forcimit të kompetencave so-

ciale të Njësive Administrative si njësi më e afërt me komunitetin. Gjithashtu, njësi administrative duhet të ketë një shpërndarje të shërbimeve sociale në të gjitha territoret, si në ato rurale ashtu edhe në ato urbane.

- Mbështetja e bashkive për krijimin e shërbimeve të drejtpërdrejta në mënyrë që grupet e ndryshme në nevojë të marrin shërbimet sociale të mira dhe cilësore. Gjithashtu, është e nevojshme të përcaktohen standardet e shërbimit dhe kostot për njësi.
- Krijimi i një baze të dhënash për indikatorë të ndryshëm në lidhje me shërbimet sociale për grupe të ndryshme vulnerabël, si dhe krijimi i një baze të dhënash për të gjitha rastet e referimit në mënyrë që të menaxhohen me efikasitet të dhënat vendore dhe të trajtohen politikat e duhura. Është e rëndësishme të vlerësohen treguesit përkatës për të qenë pjesë e bazës së të dhënave.
- Është gjithashtu e rëndësishme të rritet cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve sociale dhe të forcohet sistemi i referimit dhe i menaxhimit të rasteve.
- Ngritja e strehëzave për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, rasteve të abuzimit të fëmijëve ose viktimave të mundshme të trafikimit në secilën bashki.
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese si dhe ndërtimi i infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara që do të lehtësojë lëvizjen dhe kushtet e tyre të jetesës.
- Financimi dhe krijimi i qendrave komunitare për të gjitha grupet vulnerabël në secilën bashki me qëllimin e marrjes së shërbimeve.

Mbrojtja e fëmijëve

- Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe përmirësimi i shërbimeve publike, shërbimeve ligjore dhe psikologjike për mbrojtjen e fëmijëve.
- Krijimi i një qendre të specializuar për ofrimin e shërbimeve për fëmijët që kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike dhe seksuale, dhe fëmijëve që janë lënë pas

dore.

- Sigurimi i programeve dhe i politikave të reja për punësimin e prindërve, fëmijët e të cilëve kanë probleme të ndryshme (në mënyrë që ata të punojnë dhe të kujdesen për fëmijët e tyre).
- Ndërgjegjësimi dhe mobilizimi i institucioneve publike dhe jopublike në nivel qendror dhe vendor për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës.
- Rritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor në lidhje me zbatimin e legjisllacionit, procedurat e mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin proaktiv dhe bashkëpunimin ndër-sektorial.
- Sigurimi dhe ofrimi i shërbimit të ndërhyrjes dhe të pritjes për të ndihmuar fëmijët 24 orë në ditë nga të gjitha bashkitë në nivel kombëtar.
- Krijimi i grupeve ndër-sektoriale (shumë-disiplinore) për të ofruar shërbime për fëmijë në secilën bashki dhe njësi administrative.
- Krijimi i grupeve të punës (nga punonjësit e institucioneve ose të organizatave vendore) për të identifikuar fëmijët në situatë rruge në të gjithë vendin.
- Monitorimi dhe kontrolli i mediave që publikojnë raste që kanë të bëjnë me çështjet e fëmijëve (për të ruajtur parimin e konfidencialitetit dhe për të shmangur ri-viktimizimin e fëmijës).

Punësimi

- Pushteti qendror dhe ai vendor duhet të sigurojnë nxitjen e mundësive aktuale të punësimit përmes politikave të efektshme të tregut të punës.
- Rritja e kapaciteteve dhe përcaktimi i programeve të kualifikimit në institucionet e arsimit profesional sipas nevojave të tregut vendor të punës.
- Ndërtimi dhe forcimi i bashkëpunimit me bizneset për të mbështetur me ekspertizën e tyre njerëzit e papunë në mënyrë që ata të jenë më të kualifikuar dhe të krijojnë shanse punësimi si dhe të rrisin mundësinë e punësimit të grupeve në nev-

- ojë.
- Nxitja e ndërmarrjeve sociale si një mekanizëm që siguron mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël përmes ofrimit të mundësive për punësim dhe integrimin ekonomik dhe shoqëror të grupeve në nevojë duke promovuar frymën e përgjegjësisë, solidaritetit dhe të kohezionit në komunitet.
 - Përveç promovimit të këtyre ndërmarrjeve, bashkitë duhet të mbështesin dhe zbatojnë politikën e zhvillimit të ndërmarrjeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

REKOMANDIME PËR SISTEMIN GJYQËSOR DHE TË DREJTAT THEMELORE

- Të gjitha bashkitë duhet të sigurojnë një staf të trajnuar dhe kompetent në mënyrë që të kenë një njësi efektive të mbrojtjes së fëmijëve sipas parimit të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës.
- Koordinim më i mirë ndërmjet NJMF-së (Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës) dhe grupeve të shërbimeve psiko-sociale në shkollë (për të reduktuar bullizmin, diskriminimin, etj).
- Pavarësisht miratimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 - 2020, rekomandohet përafrimi i legjislacionit të brendshëm me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht në lidhje me zotësinë juridike për realizimin e veprimeve ligjore. Gjithashtu, Ofruesit e Shërbimit të Mediave Audiovizive (kombëtare dhe vendore) duhet të bëjnë progres për sa i përket garantimit të përdorimit të gjuhës së shenjave për personat me aftësi të kufizuara të dëgjimit në përputhje me detyrimin e parashikuar në Ligjin Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".
- Është e nevojshme të merret parasysh miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e minoriteteve i hartuar në përputhje me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve, ndërkohë që tani janë të nevojshme dhe masa konkrete dhe efektive në mënyrë të veçantë për anëtarët e komuniteteve rome dhe egjiptiane.
- Ekziston nevoja për iniciativë të mëtejshme në funksion të vetëdijësimit të publikut dhe të zbatimit të parimit të pavarësisë dhe konfidencialitetit në lidhje me të drejtat e personave lezbikë, homoseksual, biseksual, transgjiner dhe interseks ose "hermafroditë" (LGBTI) si dhe të drejtat e personave me HIV/AIDS, pasi stigmatizimi i këtij komuniteti është i lartë dhe pranimi i tyre në shoqëri vazhdon të mbetet në nivele të ulëta.
- Rritja e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje përmes funksionimit të mirë të sistemit të referimit. Është e rëndësishme të sigurohet pjesëmarrja e krerëve të institucioneve vendore në takimet bashkiake për politikën e menaxhimit të dhunës në familje.
- Bashkitë duhet të punojnë edhe me komunitetin, veçanërisht në zonat rurale duke rritur vetëdijësimin për rastet e dhunës në familje, pasi shumë raste të dhunës në zonat rurale në Njësitë Administrative nuk raportohen.
- Sigurimi i ndihmës për rastet e identifikuar të grave që janë viktime të dhunës në familje si e drejtë e tyre, sepse shumë bashki nuk e realizojnë këtë të drejtë.
- Rritja e numrit të bashkive që caktojnë buxhet të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe e bashkive që kanë një buxhet/PBA me ndjeshmëri gjinore.
- Përmirësimi i raportimit dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese (në zonat urbane dhe rurale) për mbrojtjen nga çdo formë diskriminimi, për çështje të barazisë gjinore, për mbrojtjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane, si dhe për njohjen e të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut.
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në

mënyrë që të lehtësohet aksesimi i PAK (Personat me Aftësi të Kufizuara), si dhe i infrastrukturës shkollore që përmbush standardet për fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Krijimi i shërbimeve fleksibile dhe lehtësisht të arritshme për komunitetet romë dhe egjiptiane për të ndërtuar një sistem besimi dhe sigurie për integrimin e tyre në shoqëri (të kenë akses pa pengesa në shërbimet sociale, në shërbimin shëndetësor, të nxitet arsimit i të rinjve romë dhe egjiptianë dhe të sigurohet dhe të mbështetet punësimi dhe promovimi i modeleve pozitive).

REKOMANDIME PËR DREJTËSINË, LIRINË DHE SIGURINË

- Rritja e kapaciteteve të Këshillave Vendore të Sigurisë Publike për të funksionuar mirë dhe për të pasur një ndikim real në sigurinë e bashkisë duke përfshirë përfaqësues të institucioneve vendore që merren direkt me çështje të sigurisë dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, komunitetet fetare, komuniteti i biznesit, shkollat, etj.
- Vendosja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis të gjithë aktorëve vendorë, përfshirë shoqërinë civile, policinë, shërbimet sociale, etj., për të identifikuar sfidat e komunitetit vendor për sa i përket sigurisë personale dhe për të rritur sigurinë publike.
- Rritja e nivelit të ekspertizës në këtë fushë brenda bashkisë.
- Identifikimi i faktorëve që mund të kenë një efekt ndikues në arritjet e pushtetit vendor në luftën kundër krimit.
- Bashkitë duhet të rrisin dhe forcojnë integritetin e administratës publike (transparenca dhe deklaratat e pasurive).
- Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i nismave ligjore për parandalimin dhe reduktimin e korrupsionit në të gjitha nivelet, si dhe rritja e vetëdijësimit se si të shmangen format e korrupsionit, dhe, nga ana tjetër, rritja e vetëdijësimit për shtimin e denoncimeve të

veprimeve korruptive nga të gjithë.

REKOMANDIME PËR ARSIMIN DHE KULTURËN

Arsimi:

- Përmirësimi i kopshteve dhe i aksesit në arsimin parashkollor në zonat rurale. Është e rëndësishme të sigurohet infrastruktura e nevojshme dhe aksesimi në zona të thella pa arsim parashkollor, në mënyrë që të përmirësohen mundësitë e arsimit të të gjithë fëmijëve brenda territorit të bashkisë.
- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave duke planifikuar dhe akorduar më shumë buxhet për këtë qëllim.
- Hartimi i politikave për barazimin e mundësive arsimore për fëmijët që janë pjesë e grupeve vulnerabël.
- Krijimi i një sistemi arsimor të sigurimit të cilësisë (standardet, vlerësimi i brendshëm, etj.).
- Bashkitë duhet të ndërmarrin nisma për të rritur vetëdijësimin shoqëror në lidhje me rëndësinë e arsimit të hershëm përmes mjeteve të ndryshme të shpërndarjes.
- Gjetja e mekanizmave vendorë për të ndërtuar me sukses kanale komunikimi ndërmjet prindërve, mësuesve dhe bashkisë në mënyrë që të rriten njohuritë dhe vetëdijësimi për arsimin, si dhe ngritja e zërit për shqetësime të ndryshme.
- Zhvillimi i një sistemi vendor (veprime konkrete) për përfshirjen sociale të fëmijëve të pafavorizuar.
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit për rastet e braktisjes së shkollës, pasi të dhënat zyrtare nuk korrespondojnë me situatën reale në shkolla.
- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave, pajisja me laboratorët e mësimdhënies, arritja e standardit për numrin e fëmijëve në klasë, krijimi i shkollave miqësore për fëmijë, prindër dhe komunitet.
- Krijimi i qendrave rinore për të rinjtë, të cilët nuk kanë pothuajse asnjë ambient argëtimi në qytetet e vogla.
- Ndërtimi i bibliotekave/ose bërja funksionale e atyre ekzistuese, ndërtimi i fush-

ave të sportit.

Kultura:

- Bashkitë duhet të hartojnë Strategjitë Kulturore Vendore që ofrojnë politika të nevojshme për mbështetjen dhe forcimin e strukturave përgjegjëse për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, me qëllim zhvillimin, promovimin dhe konservimin e burimeve të trashëgimisë kulturore në nivelin vendor.
- Këto dokumente strategjike duhet të parashikohen në programet buxhetore afatmesme në mënyrë që të zbatohen në mënyrë të efektshme.

REKOMANDIME PËR MJEDISIN DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

- Mbulimi i territorit bashkiak me stacione monitorimi të ujit, ajrit, tokës ose burimeve të tjera të ndotjes së mjedisit si akustikë, frekuenca telekomunikimi, radioaktivitet, etj.
- Interpretimi i indikatorëve nga ekspertë përkatës dhe publikimi i rregullt i të dhënave për informimin e qytetarëve për situatën mjedisore në territorin ku ata jetojnë.
- Bashkia duhet të botojë një raport vjetor me të dhëna të monitorimit të mjedisit që janë gjithëpërfshirëse dhe këshilluese për qytetarët.
- Përdorimi më i mirë i fondeve për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, pasi organet e vetëqeverisjes vendore vazhdojnë të përballen me fonde të pamjaftueshme dhe në disa raste janë identifikuar disa shkelje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të hapësirës publike, veçanërisht në shtretërit e lumenjve.
- Hartimi i kriterëve të decentralizimit asimetrik të çështjeve të ndryshme në interes

të qeverisë qendrore në lidhje me mjedisin dhe ndryshimin e klimës në mënyrë që ky funksion të realizohet më mirë.

- Forcimi i bashkëpunimit midis bashkisë dhe qytetarëve për t'i përfshirë ata në aksione për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në veprime që synojnë monitorimin dhe ndikimin e ndotjes së mjedisit nga operatorët ekonomikë, dhe ushtrimi i presionit mbi ta për të ndërmarrë masa për të shmangur ndotjen.

REKOMANDIME PËR KONTROLLIN FINANCIAR

- Rritja e kapaciteteve vendore për administrimin efikas të taksave dhe tarifave vendore.
- Vlerësimi i aftësisë së administratave vendore për të arritur potencialin e tyre duke identifikuar kufizimet kryesore të kapacitetit të mbledhjes së taksave të vetëqeverisjes vendore.
- Nxitja e mbledhjes më të madhe të të ardhurave duke rritur kapacitetin vendor për të mbledhur sa më shumë të ardhura vendore, për të analizuar potencialin e tyre dhe për të zbatuar një menaxhim të efektshëm të të ardhurave vendore. Kapaciteti për të mbledhur të ardhurat e mundshme ndikon drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve qytetare dhe në realizimin e investimeve.
- Hartimi dhe zbatimi i një sistemi të integruar të standardizuar në secilën bashki për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Sistemi i unifikuar jo vetëm që do të standardizojë mënyrën e mbajtjes së të dhënave për detyrimet vendore, por do të prodhojë të dhëna të sakta dhe në kohë reale, duke ndihmuar në këtë mënyrë në rritjen e performancës së mbledhjes së të ardhurave dhe duke kontribuar në kontrollin e brendshëm me qëllim menaxhimin efikas dhe modern të taksave vendore.

- Ky sistem do të ndihmojë gjithashtu edhe në rritjen e performancës së sistemit të zyrës me një ndalesë, pasi një nga karakteristikat kryesore të këtij sistemi është integrimi me sistemin e taksave vendore për të kontrolluar në kohë reale nëse aplikanti (qytetari/biznesi) ka paguar detyrimet e tij apo jo. Kjo do të rrisë gjithashtu edhe efikasitetin e ofrimit të shërbimit duke zvogëluar numrin e dokumenteve të paraqitura, pasi nuk do të jetë e nevojshme që aplikanti të kërkojë faturë për pagesat vendore dhe më pas ta paraqesë atë si një dokument gjatë aplikimit për një shërbim në sistemin e zyrës me një ndalesë. Ky verifikim i të dhënave brenda institucionit bashkiak mund të bëhet duke integruar sistemet.
- Përgatitja dhe përditësimi i planeve strategjike për të gjitha bashkitë e Shqipërisë dhe përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm bazuar në këto plane strategjike.
- Përgatitja e një dokumenti të mirë dhe informues të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) që bën të mundur që Këshilli Bashkiak dhe qytetarët të kuptojnë lehtësisht se ku investohet buxheti dhe çfarë do të prodhohet (realizohet) në secilin nga ciklet e Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Hartimi i raporteve të performancës bazuar në të dhëna jo-financiare (treguesit e performancës) që shpjegojnë shpenzimet buxhetore për 61 bashki si nevojë për të

analizuar performancën e bashkisë dhe përqindjen e realizimit të parashikimeve për periudhën e caktuar buxhetore.

- Realizimi i një formati të thjeshtë dhe unik për 61 bashkitë për hartimin dhe realizimin e buxhetit për të lehtësuar leximin dhe analizën e buxhetit nga komuniteti.
- Rritja e aftësive të pushtetit vendor për të përfituar nga fondet e donatorëve ose politikave të huamarrjes së brendshme për financimin e projekteve kapitale.

REKOMANDIME PËR POLITIKAT RAJONALE

- Rishikimi dhe përcaktimi në mënyrë të qartë i kompetencave vendore, rajonale dhe qendrore me qëllim që të shmanget mbivendosja e tyre dhe të ketë një harmonizim të strukturave në çdo nivel.
- Rritja e njohurive dhe e vetëdijësisë për bashkëpunimin ndërmjet bashkive lidhur me shërbime të ndryshme vendore dhe politika të investimeve përmes praktikave të mira, manualeve, broshurave, etj.
- Rritja e bashkëpunimit të Këshillit të Qarkut dhe institucioneve të tjera të pushtetit qendror dhe vendor për një zhvillim më të mirë rajonal.
- Forcimi i bashkëpunimit midis NJQV-ve në kuadrin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar për të rritur mundësitë për të përfituar nga fondet IPA.

